



RAPORTI VJETOR I PUNËS 2017

Prishtinë, 2018



RAPORTI VJETOR I PUNËS

2017

Prishtinë, 2018

PËRMBAJTJA

1. Përmbledhje ekzekutive	9
2. Korniza Ligjore	10
2.1. Baza ekzistuese ligjore.....	10
2.2. Zhvillimi i bazës ligjore në periudhën raportuese	11
2.3. Vështirësitë ligjore që ka hasur Akademia e Drejtësisë në përmbushjen e misionit.....	11
3. Përshkrimi i Akademisë së Drejtësisë	11
3.1. Misioni	11
3.2. Vizioni	11
3.3 Kompetencat e Akademisë së Drejtësisë sipas ligjit	12
4. Fushëveprimi i Akademisë	12
4.1 Organizimi, veprimtaritë, personeli dhe niveli i rrogave	13
4.2. Këshilli Drejtues.....	13
a. Përbërja dhe mandati.....	13
a. Kompetencat	14
b. Funksionalizimi	14
4.3 Këshilli Programor	15
4.4 Ekzekutivi	15
a. Drejtori	16
b. Menaxhmenti i mesëm.....	16
c. Mandati	17
4.5 Burimet Njerëzore	17
a. Numri i punëtorëve	17
b. Nevojat për punëtorë të rinj.....	18
c. Trajnimet e stafit	18
4.6 Asetet	19
a. Asetet e Akademisë	19
b. Planifikimi për asete të reja dhe ndërtesën e Akademisë	19
5. Aktivitetet e Akademisë gjatë vitit 2017	20
5.1 Krahasimi i punës së Akademisë në tri vitet e fundit	20
5.2 Plani i punës për vitin 2017.....	21
5.3 Veprimet që i ka ndërmarrë Akademia në ngritje të cilësisë së trajnimeve	23
5.4 Sfidat e vitit 2017 dhe planifikimi për vitin 2018.....	23
6. Trajnimet e Akademisë të realizuara gjatë vitit 2017	24
6.1. Programi për Trajnime të Vazhdueshme	26
6.1.1 Objektivat e PTV për vitin 2017.....	26
6.1.2 Fushat e trajnimit që mbulon PTV.....	27

6.1.3 Aktivitetet trajnuese në PTV	28
6.1.4 Pjesëmarrja në Programin e Trajnimit të Vazhdueshëm	29
6.1.5 Numri i trajnimeve në baza mujore	30
6.1.6 Trajnimet e vazhdueshme sipas kohëzgjatjes	36
6.1.7 Trajnimet e vazhdueshme sipas fushave	36
6.1.7.1 Trajnimet nga fusha penale (materiale dhe procedurale)	36
a. E drejta penale materiale	36
b. E drejta penale procedurale:	37
6.1.7.2 Programet e specializuara të trajnimit	38
a. Program i specializuar trajnimi për zhvillimin e kapaciteteve në luftën kundër korrupsionit...38	
b. Program i specializuar trajnimi për prokurimin publik	38
c. Program i specializuar trajnimi në forcimin e kapaciteteve profesionale në luftimin e shpëlarjes së parave	38
d. Program i specializuar trajnimi në forcimin e kapaciteteve profesionale në luftimin e krimit kibernetik	39
6.1.7.3 Trajnimet nga drejtësia për fëmijë – aspekti civil dhe penal	39
a. Drejtësia për Fëmijë – aspekti penal ka trajtuar tema si:	39
b. Drejtësia për Fëmijë – aspekti civil ka trajtuar tema si:	39
6.1.7.4 Trajnimet nga fusha civile (materiale dhe procedurale)	40
6.1.7.5 Trajnimet nga fusha ekonomike	41
6.1.7.6 Trajnimet nga fusha administrative	41
6.1.7.7 Trajnimet nga e drejta kushtetuese	42
6.1.7.8 Trajnime për Dhomën e Posaçme të Gjykatëse Supreme	42
6.1.7.9 Trajnimet nga fusha e kundërvajtjeve	43
6.1.7.11 Trajnimet për të Drejtën Ndërkombëtare dhe të Drejtën e BE-së	44
6.1.7.12 Aktivitetet për barazinë gjinore dhe mos diskriminimin	44
6.1.7.13 Trajnimet nga kompetenca ndërdisiplinare	44
6.1.8 Programi trajnues hyrës për gjyqtarët dhe prokurorët e shtetit nga komuniteti serb të integruar sipas Marrëveshjes për Drejtësi	44
6.2 Programi i Trajnimit Fillestar	45
6.2.1 Aktivitetet e realizuara në kuadër të PTF-së për vitin 2017	46
6.2.2 Trajnimi fillestar për prokurorët e sapoemëruar	46
6.2.2.1 Trajnimi teorik	47
6.2.2.2 Trajnimi praktik	48
6.2.2.3 Trajnim në institucionet jo gjyqësore	49
6.2.2.4 Hartimi dhe organizimi i testit përfundimtar për prokurorët e sapoemëruar	49
6.2.3 Trajnimi fillestar për gjyqtarët e sapoemëruar	50
6.2.3.1 Trajnimi teorik	50
6.2.3.2 Trajnimi praktik	51
6.2.3.3 Trajnimi në institucionet jo gjyqësore	51

6.2.3.4	Trajnimi i mentorëve në trajnimin fillestar për gjyqtarët e sapoemëruar	51
6.3	Programi për Hulumtime dhe Publikime (PHP)	52
6.3.1	Objektivat PHP-së	52
6.3.2	Aktivitetet në PHP	52
6.3.3	Veprimtaria kërkimore	53
6.3.4	Hulumtime dhe analiza për vlerësimin e nevojave për trajnime të gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe për zhvillimin e programeve trajnuese për vitin 2018	53
6.3.5	Veprimtaria botuese	53
6.3.6	Menaxhimi dhe përditësimi i koleksioneve të bibliotekës fizike dhe elektronike të Akademisë së Drejtësisë	55
6.3.7	Qasja në burime ligjore në data bazat ndërkombëtare	55
6.4	Mësimi në distancë	56
6.5	Trajnimet për Trajnues	57
6.6	Trajnimet për menaxhmentin, stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe për gjyqtarë porotë	57
6.6.1	Trajnimet për menaxhmentin e gjykatave dhe prokurorive	57
6.6.2	Trajnimi për gjyqtarë porotë	58
6.6.3	Trajnimi për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial	58
6.7	Punëtori, tryeza pune, konferenca dhe aktivitete tjera	59
6.7.1	Punëtori për hartimin e akteve normative të Akademisë	59
6.7.2	Punëtori me trajnuesit e Akademisë për hartimin programit të trajnimeve për vitin 2018	59
6.7.3	Punëtori me trajnuesit e Akademisë për hartimin e programit trajnues për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial	59
6.7.4	Punëtori për Hartimin e Planit të Punës për vitin 2018	60
6.7.5	Punëtori për zhvillimin e kapaciteteve të stafit të sistemit prokurorial të Kosovës	60
6.7.6	Punëtori “Dialogu institucional në mes të KGJK-së, KPK-së, dhe ADK-së për çështje të interesit të përbashkët”	60
6.7.7	Punëtorja “Nga Instituti Gjyqësor në Akademinë e Drejtësisë – Planifikimi strategjik për arsimin ligjor të gjyqësorit të Kosovës”	61
6.7.8	Punëtorja “Përgatitja dhe transformimi didaktik i lëndëve reale”	61
6.7.9	Punëtorja për zhvillimin e botimeve ligjore	61
6.7.10	Aktivitete tjera realizuara në bashkëpunim me Projektin e Binjakëzimit	61
6.8	Bashkëpunimi me donatorë	62
6.9	Bashkëpunimi ndërkombëtarë	65
6.9.1	Takimi i Komitetit Drejtues i projektit “Përforcimi i Ekspertizës Gjyqësore mbi Lirinë e Shprehjes dhe medias në Evropën Juglindore - JUFREX”	65
6.9.2	Takimi i dytë i Rrjetit të Institucioneve të Trajnimit Gjyqësor të Evropës Juglindore	66
6.9.3	Takimi i Institucioneve të Trajnimit Gjyqësor të vendeve të Ballkanit Perëndimor	66
6.9.4	Takim i Përbashkët i Grupit Punues për Drejtësinë dhe Institucionet e Trajnimit Gjyqësor të Ballkanit Perëndimor	66

6.9.5 Konferencë 20 Vjetori i Shkollës së Magjistraturës së Shqipërisë	66
6.9.6 Konferenca Rajonale “Liria e shprehjes dhe interneti”	67
6.9.7 Forumi i Katërt Rajonal mbi Shtetin e së Drejtës në Evropën Juglindore	67
6.9.8 Kongresi Ndërkombëtarë për Arsimimin Ligjor	68
6.9.9 Vizitë e delegacionit të Shkollës së Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë	68
6.9.10 Vizitë e Delegacionit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë së Shqipërisë në Akademinë e Drejtësisë	68
6.9.11 Vizita e juristëve gjerman në Akademinë e Drejtësisë	69
6.9.12 Vizita e studentëve nga Gjermania në Akademinë e Drejtësisë	69
6.9.13 Vizitë në institucionet shtetërore dhe ato të drejtësisë të Republikës së Kroacisë.....	69
6.9.14 Punëtorja “Bashkëpunimi mbi krimin kibernetik me fokus të ardhurat nga krimi përmes internetit”.....	70
6.9.15 Punëtorja “Standardet e BE-së për Trajnimin Fillestar për Gjyqtarë dhe Prokurorë”.....	70
6.9.16 Vizitë e Drejtorit të Akademisë së Drejtësisë së Branderburgut të Gjermanisë.....	70
6.9.17 Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet civile dhe komerciale në BE.....	71
6.9.18 Seminar mbi zbatimin e KEDNJ dhe garancionet ligjore për mbrojtjen kundër diskriminimit	71
6.9.19 Promovimi i modulit trajnues për luftëtarët e huaj terroristë	71
6.10 Programet e shkëmbimit.....	72
6.10.1 Program intershipi i kandidatëve nga Shkolla e Magjistraturës së Francës	72
6.10.2 Program internshipi në Gjykatën e Bres – Francë.....	72
6.10.3 Trajtimi Gjyqësor i Terrorizmit.....	72
6.11 Programi për praktikantë – studentë.....	73
7. Administrata dhe Financat.....	73
7.1 Buxheti dhe financat	73
7.1.1 Buxheti i Republikës së Kosovës.....	74
7.1.2 Mbështetja financiare nga donatorët.....	78
7.2 Shërbimet e përgjithshme	79
7.3 Auditimi nga Zyra Kombëtare e Auditimit.....	80
8. Sfidat dhe rekomandimet.....	82
9. Anekset.....	83
9.1. Aneksi 1 – Trajnimet e realizuara në PTV.....	83
9.2 Aneksi 2 – Aktivitetet e realizuara në PTF	90
9.3 Aneksi 3 – Aktivitetet e realizuara në PHP.....	94
9.4 Aneksi 4 – Aktivitetet e realizuara për menaxhmentin e administratës dhe stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive	95
9.5 Aneksi 5 – Trajnimet e realizuara për trajnues	96
9.6 Aneksi 6 Trajnimet e realizuara për gjyqtarët porotë	96
9.7 Aneksi 7 – Kurset trajnuese përmes platformës së mësimin në distancë.....	96
9.8 Aneksi 7 – Plani Vjetor i Trajnimit të Stafit të IGJK-së për periudhën janar – dhjetor 2017.....	97

AKRONIMET

ABEK	– Asociacioni i Bibliotekave Elektronike të Kosovës
AD	– Akademia e Drejtësisë
AQP	– Agjencia Qendrore e Prokurimit
DAF	– Departamenti i Administratës dhe Financave
EIFL	– Electronic Information for Libraries
ENM	– L'École Nationale de la Magistrature
GIZ	– Deutsche Gesellschaft fuer Internationale Zusammenarbeit
GJEDNJ	– Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
IGJK	– Instituti Gjyqësor i Kosovës
ILIAS	– Integriertes Lern – Informations – und Arbeitskooperations–System
KDM	– Kodi i Drejtësisë për të Mitur
KEDNJ	– Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KGJK	– Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPK	– Këshilli Prokurorial i Kosovës
KPMSHCK	– Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
KPPK	– Kodi i Procedurës Penale i Kosovës
LMD	– Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve
OSBE	– Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PHP	– Programi për Hulumtime dhe Publikime
PTF	– Programi i Trajnimit Fillestar
PTV	– Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm
SIMFK	– Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës
TAIEX	– Technical Assistance and Information Exchange Instrument
TI	– Teknologjia Informative
USAID	– The United States Agency for International Development
ZKA	– Zyra e Kombëtare e Auditimit

Fjala hyrëse

Përmes këtij raporti, kam kënaqësinë që të prezantoj aktivitetet dhe zhvillimet tjera të rëndësishme të Akademisë së Drejtësisë gjatë vitit 2017.

E veçantë e këtij viti ka qenë hyrja në fuqi e Ligjit për Akademinë e Drejtësisë me 24 shkurt 2017, me të cilin transformohet Instituti Gjyqësor i Kosovës në Akademi të Drejtësisë. Procesi i transformimit është përcjellë, me një sërë hapash qoftë me konstituimin e organeve të reja apo edhe me nxjerrjen e akteve normative siç është përcaktuar me Ligin për Akademinë e Drejtësisë, ashtu edhe me aktivitetet tjera që kanë të bëjnë me funksionalizimin e institucionit në përgjithësi.

Bazuar në mandatin që buron nga Ligji për Akademinë e Drejtësisë dhe akteve tjera nënligjore, programit të punës dhe programit trajnues për vitin 2017, të gjitha aktivitetet e Akademisë kanë qenë të orientuara në drejtim të zhvillimit të kapaciteteve të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ të gjykatave dhe prokurorive, përmes trajnimeve si dhe ofrimit të burimeve dhe materialeve tjera ligjore.

Në Programin e Trajnimeve të Vazhdueshme (PTV) janë realizuar trajnime si nga aspekti material ashtu edhe ai procedural, në të cilat kanë marrë gjyqtarë dhe prokurorë nga të gjitha departamentet. Edhe këtë vit është vazhduar me programe të specializuara në fushën e krimit të organizuar siç janë krimi kibernetik, shpëlarja e parave si dhe prokurimi publik. Gjithashtu, PTV vëmendje të veçantë i ka kushtuar edhe trajnimeve dedikuara stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial duke realizuar trajnime për këto kategori dhe duke zhvilluar procesin e vlerësimit të nevojave trajnuese për vitin 2018, duke qenë se trajnimet për këtë kategori tashmë janë mandat që buron nga Ligji për Akademinë e Drejtësisë.

Në Programin e Trajnimit Fillestar (PTF) janë realizuar trajnime teorike dhe praktike sipas kurrikulës së këtij programi, për prokurorët e sapo emëruar të gjeneratës së VI dhe njëkohësisht janë bërë përgatitjet, duke përfshirë hartimin dhe publikimin e programit për gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së VI, i cili ka filluar të zbatohet nga shtatori i këtij viti.

Në Programin për Hulumtime dhe Publikime (PHP) është realizuar hulumtimi i praktikës gjyqësore të Gjykatës së Apelit për lëndët të cilat kthehen në rigjykim veçanërisht në çështjet civile administrative dhe ekonomike në gjykatat e shkallës së parë. Biblioteka e Akademisë ka vazhduar të jetë në shërbim të gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë.

Raporti përmban edhe aktivitetet e realizuara me partnerët ndërkombëtar, të cilat në forma të ndryshme kanë qenë mbështetje për Akademinë edhe këtë vit, qoftë përmes programeve të ndryshme të trajnimit, ashtu edhe përmes ekspertizave dhe programeve të shkëmbimit.

Në këtë raport janë përfshirë edhe aktivitetet e shumta në kuadrin e Departamentit për Administratë dhe Financa, të cilat janë realizuar në mbështetje të realizimit të mandatit ligjor të Akademisë.

Në përfundim, dëshiroj të theksoj se, përkundër procesit të transformimit Akademia ka arritur të përmbush mandatin ligjor duke treguar përkushtim të lartë nga stafi i Akademisë, andaj, në emër të Këshillit Drejtues të AD-së, falënderoj të gjithë përfituesit, institucionet e sistemit gjyqësor dhe prokurorial, institucionet tjera vendore, organizatat ndërkombëtare, partner, donatorë dhe miq të AD-së, për mbështetjen dhe kontributin e dhënë në këtë drejtim, pa mbështetjen e të cilëve rezultatet e arritura gjatë këtij viti nuk do të ishin në nivelin siç janë prezantuar në këtë raport.

Sinqerisht,

Aleksandër Lumezi

Kryetar i Këshillit Drejtues

1. Përmbledhje ekzekutive

Me Ligjin Nr. 05/L -095 për Akademinë e Drejtësisë (AD), Akademia themelohet si institucion publik i pavarur, funksionet kryesore të të cilit janë, hartimi i programit trajnues dhe organizimi i trajnimit për gjyqtarë dhe prokurorë të shtetit, stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial, trajnimin për avokat shtetëror, avokatë dhe profesionet e tjera të lira, zhvillimin e procesit të vlerësimit të nevojave për trajnime, kryen analiza, hulumtime dhe bashkëpunon me institucionet shkencore, kryen veprimtari botuese në përmbushje të mandatit për nevojat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial dhe profesioneve të lira, si dhe kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj dhe me akte tjera të Akademisë.

Akademia organizon trajnime me standarde profesionale dhe me metoda efektive në ngritjen e kapaciteteve të sistemit gjyqësor e prokurorial të Kosovës duke përfshirë edhe fushën e publikimeve dhe hulumtimeve të cilat kanë në fokus mandatin ligjor dhe përfituesit siç është përcaktuar me ligj.

Aktualisht AD realizon funksionet ligjore në bazë të tri programeve kryesore të cilat operojnë në kuadër të Departamentit të Programit: Programi për Trajnime të Vazhdueshme, Programi për Trajnime Fillestare dhe Programi për Hulumtime dhe Publikime.

Akademia me përkushtim të plotë është përqendruar në zbatimin e planit të punës konform mandatit dhe kompetencave me qëllim të ngritjes së kompetencave profesionale dhe interdisiplinare të profesionistëve të sistemit gjyqësor dhe prokurorial, përmes programeve të ndryshme trajnuese në të cilat janë përfshirë, përveç gjyqtarëve dhe prokurorëve edhe prokurorët e dhe gjyqtarët e sapo emëruar si dhe stafi administrativ gjyqësor dhe prokurorial.

Në raport përfshihen trajnimet e vazhdueshme për gjyqtarë dhe prokurorë nga të gjitha lëmit e së drejtës, veçanërisht; penale, civile, drejtësisë për fëmijë (aspekti civil dhe penal), administrative, kushtetuese, tregtare, ndërkombëtare, të drejtën e Bashkimit Evropian, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, tema e module trajnuese të karakterit interdisiplinar si: etika profesionale, arsyetimi ligjor, menaxhimi dhe trajnime tjera të cilat në raport janë paraqitur në mënyrë të detajuar.

Gjatë vitit 2017 është zbatuar kurrikula trajnuese, për trajnimet fillestare, së pari për prokurorët e sapo emëruar, e më pas nga shtatori i këtij viti edhe për gjyqtarët e. Në periudhën raportuese 16 prokurorë të sapo emëruar kanë përfunduar Programin e Trajnimit Fillestar, ndërsa 49 gjyqtarë të sapo emëruar janë duke e ndjekur trajnimin fillestar sipas kurrikulës trajnuese të paraparë për gjyqtarët e sapo emëruar edhe gjatë vitit 2018.

Gjatë periudhës raportuese AD ka organizuar trajnime për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive duke përfshirë bashkëpunëtorë profesional, zyrtarë ligjor, administrator dhe profile tjera të rëndësishme brenda sistemit gjyqësor dhe prokurorial..

Gjatë vitit 2017 është punuar intensivisht edhe në fushën e analizave dhe hulumtimeve të cilat i kanë kontribuar hartimit të kurrikulës trajnuese për vitin 2018 ashtu edhe në identifikimin e nevojave për hulumtime profesionale për nevojat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial. Gjithashtu është punuar në ofrimin e burimeve ligjore për gjyqtarë dhe prokurorë përmes bibliotekës ligjore që përbëhet nga materiale në kopje fizike dhe elektronike përfshirë edhe qasje në data baza ligjore ndërkombëtare përmes Asociacionit të Bibliotekave Elektronike të Kosovës.

Akademia, ka organizuar edhe programe shkëmbimi dhe programe praktike jashtë vendit për gjyqtarë dhe prokurorë.

Në raport përfshihen edhe aktivitetet e ndryshme në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtarë, ku Akademia ka marrë pjesë në mënyrë aktive në konferenca e takime regjionale e ndërkombëtare, që kishin në fokus trajnimin për gjyqtarë dhe prokurorë, si dhe ka mundësuar pjesëmarrjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve në aktivitete të cilat për qëllim kishin zhvillimin profesional të tyre. Po ashtu, janë të përfshira edhe aktivitetet me donatorë dhe partner zbatues të programeve të ndryshme të trajnimit, ku disa prej projekteve kanë qenë afatmesme dhe janë në vazhdimësi edhe në vitet

Në periudhën raportuese, pavarësisht mungesave në staf, Akademia është angazhuar me të gjithë potencialin në zbatimin e mandatit ligjor dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara në mbështetje të ndërtimit të një sistemi gjyqësor të pavarur, të paanshëm dhe profesional.

2. Korniza Ligjore

Në shkurt të vitit 2017 hynë në fuqi Ligji Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji është shfuqizuar Ligji nr. 02/L-25 për Themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës, dhe Akademia e Drejtësisë është përcaktuar si trashëgues juridik i Institutit Gjyqësor të Kosovës.

2.1. Baza ekzistuese ligjore

Akademia për ushtrimin e veprimtarisë sipas mandatit ligjor, ka nxjerrë akte nënligjore të përcaktuara me Ligjin për Akademinë e Drejtësisë, si në vijim:

- Rregullore Nr. 01/2017, për Procedurën e Emërimit dhe Shkarkimit të Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullore Nr. 02/2017, për Punën e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullore Nr. 03/2017, për Trajnimin Fillestar;
- Rregullore Nr. 04/2017, për Punën e Këshillit Programor të Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullore Nr. 05/2017, për Tarifat e Trajnimeve për Avokat Shtetëror, Avokatë dhe Profesionet e Tjera të Lira;
- Rregullore Nr. 06/2017, për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullore Nr. 07/2017, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 03/2017 për Trajnimin Fillestar;
- Rregullorja Nr. 08/2017, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 06/2017 për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë;

Përveç këtyre akteve normative, në fuqi kanë qenë dhe janë zbatuar edhe më tutje gjatë vitit 2017 edhe aktet normative të miratuara para transformimit të IGJK-së në Akademi, , si në vijim:

- Statuti;
- Rregullore Nr.03/2015 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në IGJK;
- Rregullore Nr. 02/2013 për Programin e Trajnimit të Vazhdueshëm;
- Rregullore Nr. 01/2014 për Kërkime dhe Publikime në Institutin Gjyqësor të Kosovës;
- Rregullorja për Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve në Programe të Praktikës dhe Shkëmbimit Jashtë Vendit;
- Rregullorja për Bibliotekën e IGJK-së;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2011 për Mënyrën dhe Format e Komunikimit Zyrtar;
- Udhëzim Administrativ Nr. 02/2011 për Koordinim me Donatorët e IGJK-së;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2012 për Vlerësimin e Pasurisë të Institutit Gjyqësor të Kosovës.

2.2. Zhvillimi i bazës ligjore në periudhën raportuese

Hyrja në fuqi e Ligjit për Akademinë e Drejtësisë, ka ndikuar drejtpërdrejtë në nxjerrjen e akteve nënligjore të parapara me këtë ligj.

Në periudhën raportuese AD ka nxjerrë Rregulloren Nr. 01/2017, për Procedurën e Emërimit dhe Shkarkimit të Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë, Rregulloren Nr. 02/2017, për punën e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, Rregulloren Nr. 03/2017, për Trajnimin Fillestar, Rregulloren Nr. 04/2017, për Punën e Këshillit Programor të Akademisë së Drejtësisë, Rregulloren Nr. 05/2017, për Tarifat e Trajnimeve për Avokat Shtetëror, Avokatë dhe Profesionet e Tjera të Lira, Rregulloren Nr. 06/2017, për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë, Rregulloren Nr. 07/2017, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullore Nr. 03/2017 për Trajnimin Fillestar si dhe Rregulloren Nr. 08/2017, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullore Nr. 06/2017 për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë.

2.3. Vështirësitë ligjore që ka hasur Akademia e Drejtësisë në përmbushjen e misionit

Për shkak se gjatë vitit 2017 Akademia është transformuar me ligj, zbatimi i të cilit po ashtu ka kërkuar miratimin e disa akteve tjera nënligjore, ka bërë që sfida kryesore të jetë zbatimi në mënyrë të plotë i këtij legjislacioni. Përveç kësaj edhe harmonizimi i akteve normative, vendimeve, programit të trajnimeve dhe planit të punës së Akademisë me Ligjin për Gjykatën, Ligjin për Prokurorin e Shtetit, Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës, si dhe aktet nënligjore të miratuara nga KGJK dhe KPK, ka shfaqur disa vështirësi të cilat janë tejkaluar fal bashkëpunimit ndërinstitucional.

3. Përshkrimi i Akademisë së Drejtësisë

Si institucion publik i pavarur, Akademia realizon mandatin e saj ligjor në mbështetje të gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë me qëllim të ushtrimit të funksioni të tyre në mënyrë profesionale, të pavarur, efikase dhe që e gëzojnë besimin e publikut. Këtë mandat Akademia e realizon nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të programeve të trajnimit në përputhje me nevojat reale për trajnime të cilat identifikohen nga një proces i gjerë i vlerësimit të nevojave në të cilin përfshihen të gjithë përfutuesit, institucionet relevante si dhe mekanizma tjerë të nevojshëm.

3.1. Misioni

Misioni i Akademisë është të ofrojë trajnime cilësore, veprimtari kërkimore dhe botuese për nevojat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial dhe profesioneve të lira, si institucion modern i trajnimit dhe kontribues në ngritjen profesionalizmit, pavarësisë, paanshmërisë, efikasitetit dhe besimit të publikut.

3.2. Vizioni

Vizioni i Akademisë është, të avancohet më tej si një institucion profesional në ofrimin e programeve trajnuese dhe formave tjera të mbështetjes për sistemin gjyqësor dhe prokurorial profesional të pavarur dhe të paanshëm.

3.3 Kompetencat e Akademisë së Drejtësisë sipas ligjit

Bazuar në kompetencat që përcakton Ligji për Akademinë, Akademia kryen funksionet e parapara si në vijim:


- a. harton programet e trajnimit dhe organizon trajnimet për gjyqtarë dhe prokurorë të shtetit në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- b. zhvillon procesin e vlerësimit të nevojave për trajnime përmes mekanizmave të përcaktuar nga Akademia, dhe në bazë të kërkesave të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (më tej: KGJK), Këshillit Prokurorial të Kosovës (më tej: KPK).
- c. organizon trajnime për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial, pas koordinimit paraprak të nevojave për trajnime me KGJK-në dhe KPK-në, në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- d. mund të organizojë trajnime të vazhdueshme profesionale për avokat shtetëror, avokat, noter, përmbarues privat, ndërmjetësues, administratorët falimentues, si dhe profesione tjera në bazë të vlerësimeve të Akademisë, sipas kërkesave të institucioneve kompetente;
- e. zhvillon dhe realizon programet e trajnimeve në bashkëpunim me KGJK-në dhe KPK-në, Odat e profesioneve të lira apo institucionet përkatëse;
- f. mban të dhëna për trajnime dhe programe që realizohen në Akademi në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- g. vendos dhe mban bashkëpunim me institucionet vendore dhe institucionet e huaja të ngjashme lidhur me punët të cilat i kryen, duke përfshirë praktikat profesionale dhe programet e shkëmbimit;
- h. kryen analiza, hulumtime dhe bashkëpunon me institucionet shkencore;
- i. kryen veprimtari botuese në përmbushje të mandatit për nevojat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial dhe profesioneve të lira;
- j. kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj dhe me akte tjera të Akademisë.

4. Fushëveprimi i Akademisë

Akademia e Drejtësisë është institucion i cili merret me trajnimin e gjyqtarëve, prokurorëve, gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapoemëruar, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe sipas kërkesave dhe mundësive edhe për avokat, avokat shtetëror dhe profesione tjera të lira.

Po ashtu, Akademia kryen edhe analiza, hulumtime si dhe kryen veprimtari botuese për nevojat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesioneve tjera të lira.

4.1 Organizimi, veprimtaritë, personeli dhe niveli i rrogave



Grafikoni nr. 1

4.2. Këshilli Drejtues

a. Përbërja dhe mandati

Këshilli Drejtues i Akademisë përbëhet nga nëntë (9) anëtarë, nga të cilët dy (2) janë anëtarë ex officio, ndërsa shtatë (7) anëtarë nga institucionet e mëposhtme:

Anëtarë ex officio janë Kryetari i Gjykatës Supreme dhe Kryeprokurori i Shtetit.

Anëtarët tjerë janë:

- 3 (tre) anëtar të emëruar nga KGJK dhe atë, një (1) gjyqtar nga Gjykata Themelore, një (1) nga Gjykata e Apelit dhe një (1) nga Sekretariati i KGJK-së;
- 3 (tre) anëtar të emëruar nga KPK dhe atë, një (1) prokuror nga Prokuroria Themelore, një (1) nga Prokuroria e Apelit dhe një (1) nga Sekretariati i KPK-së;
- 1 (një) anëtarë i emëruar nga Ministria e Drejtësisë;

Anëtarët e Këshillit Drejtues emërohen në kohëzgjatje prej katër (4) vite, pa mundësi rizgjedhje edhe për një mandat.

a. Kompetencat

Sipas ligjit, Këshilli Drejtues i Akademisë, ka kompetencë për:

- a. Miratimin e akteve nënligjore të përcaktuara me këtë ligj;
- b. Miratimin e projektbuxhetit të Akademisë;
- c. Miratimin e strategjisë zhvillimore, planit të punës së Akademisë dhe programit të trajnimeve;
- d. Miratimin e listës së trajnerëve dhe mentorëve;
- e. Mbikëqyrjen e punës së Akademisë;
- f. Përcaktimin e prioriteteve në ofrimin e trajnimeve në bashkëpunim me KGJK-në dhe KPK-në;
- g. Zgjedhjen dhe shkarkimin e Drejtorit Ekzekutiv;
- h. Emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Programor;
- i. Kryerjen e punëve tjera të përcaktuara me ligj dhe akte nënligjore;

b. Funkcionalizimi

Gjatë vitit 2017, Këshilli Drejtues ka mbajtur tetë (8) takime të rregullta në të cilat ka debatuar dhe vendosur për çështje të ndryshme që ndërlidhen me punën dhe aktivitetet e AD-së.

Në mbledhjet e rregullta gjatë vitit 2017, Këshilli Drejtues ka marrë vendime dhe ka miratuar aktet si më poshtë:

1. Miratimi Programit për Trajnimin Fillestar për gjyqtarët e sapoemëruar
2. Zgjedhja e Kryetarit dhe zëvendës Kryetarit të Këshillit Drejtues të Akademisë;
3. Miratimi i Raportit Vjetor të Punës së IGJK-së për vitin 2016;
4. Formimi i Komisionit për Çështje Normative i Akademisë;
5. Miratimi i procedurës për dizajnimin e logos së Akademisë dhe miratimi i logos;
6. Miratimi i Rregullores për Zgjedhjen e Drejtorit të Akademisë;
7. Formimi i Komisionit për Zgjedhjen e Drejtorit të Akademisë;
8. Miratimi i Rregullores për Punën e Këshillit Drejtues të Akademisë;
9. Miratimi i Rregullores për Trajnimin Fillestar;
10. Miratimi i projekt buxhetit të Akademisë së Drejtësisë për vitin 2018;
11. Formimi i Komisionit për Zgjedhjen e Drejtorit të Akademisë;
12. Miratimi i Rregullores për punën e Këshillit Programor të Akademisë;
13. Miratimi i Rregullores për Tarifat e Trajnimeve për Avokat Shtetëror, Avokatë dhe profesionet e tjera të lira;
14. Miratimi i Rregullores për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë;
15. Emërimi i anëtarëve të Këshillit Programor;
16. Formimi i Komisionit për Ankesa për rezultatet e testimit në Trajnimin Fillestar;

17. Miratimi i listës së Mentorëve për gjyqtarët e sapo emëruar-propozim i KGJK-së;
18. Zgjedhja e Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë;
19. Miratimi i Programit të Trajnimeve për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive;
20. Miratimi i Programit Trajnues për vitin 2018;

4.3 Këshilli Programor

Këshilli Programor është organ ndihmës profesional i cili angazhohet për të siguruar cilësi për trajnimet e afuara nga Akademia. Funkzionet kryesore të Këshillit Programorë janë:

- Hartimi i propozim programit të trajnimeve të Akademisë në bashkëpunim me KGJK-në dhe KPK-në;
- Përcjellja e realizimit të programeve dhe sukseseve të tyre;
- Të jep orientime për avancimin e metodave dhe teknikave trajnuese, pavarësisht dhe në bashkëpunim me trajnuesit dhe mentorët;
- Të jep mendim për listën e trajnuesve dhe mentorëve;
- Të jep këshilla propozime dhe sugjerime, organeve të Akademisë për përmirësimin e kualitetit të trajnimeve;
- Kryejnë edhe punë tjera të përcaktuara me këtë ligj dhe akte nënligjore të Akademisë.

Këshilli Programor përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve, të cilët i emëron Këshilli Drejtues, nga radhët e gjyqtarëve, prokurorëve të shtetit dhe ekspertëve tjerë. Mandati i anëtarëve të Këshillit Programor, me përjashtim të Drejtorit Ekzekutiv, është katër (4) vite me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat. Kryesuesi i Këshillit Programor është ex officio Drejtori Ekzekutiv i Akademisë.

Gjatë vitit 2017, Këshilli Programor ka mbajtur një (1) takim ku është shqyrtuar dhe vlerësuar draft Programi i Trajnimit Fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar 2017/2018 të cilët kanë qenë në proces të rekrutimit nga ana e KGJK-së në të cilën ka rekomanduar që programi ti propozohet Këshillit Drejtues për miratim.

4.4 Ekzekutivi

Bazuar në aktin për organizimin e brendshëm, Akademia funksionon me këtë strukturë:

- Zyra e Drejtorit;
- Departamenti i Programit; dhe
- Departamenti për Administratë dhe Financa;

a. Drejtori

Drejtori i Akademisë bën pjesë në kategorinë e Zyrtarëve të Lartë Drejtues dhe sipas Ligjit për Akademinë e Drejtësisë është përgjegjës për:

- a. Përfaqësimin e Akademisë para institucioneve vendore dhe ndërkombëtare;
- b. Menaxhimin, administrimin e përgjithshëm dhe ligjshmërinë e punës së Akademisë;
- c. Zbatimin e vendimeve të Këshillit Drejtues;
- d. Propozimin e projekt buxhetit vjetor të Akademisë;
- e. Propozimin e Programit të Punës së Akademisë;
- f. Propozimin e Strategjisë, Planin e Punës dhe Programin e Trajnimeve;
- g. Propozimin e listës së trajnuesve për miratim nga Këshilli Drejtues
- h. Menaxhimin me mjetet financiare dhe pronën e Akademisë;
- i. Propozimin e projekt Rregulloreve dhe akteve tjera nënligjore;
- j. Përgatitjen e raporteve të rregullta vjetore dhe raporteve tjera sipas kërkesave të Këshillit Drejtues.

b. Menaxhmenti i mesëm

Akademia aktivitetet funksionon bazuar në punën e dy departamenteve, Departamentit të Programit dhe Departamentit të Administratës dhe Financave.

Departamentin e Programit e udhëheq Koordinatorin e Programit i cili bën pjesë në kategorinë e nivelit drejtues. Ky departament është përgjegjës ndër të tjera për:

- Zhvillimin dhe zbatimin e metodave për vlerësim të nevojave trajnuese dhe metodologjisë së trajnimeve;
- Përgatitjen e politikave dhe strategjive trajnuese;
- Organizimin e trajnimeve për gjyqtarë dhe prokurorë, si dhe trajnimeve për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial;
- Zhvillimin e hulumtimeve, publikimeve dhe ofrimin e qasjes në burime ligjore në avancim të trajnimeve gjyqësore;

Në kuadër të Departamentit të Programit funksionojnë, Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm, Programi i Trajnimit Fillestar dhe Programi për Hulumtime dhe Publikime. Në kuadër të secilit program ka edhe nënkategori tjera të aktiviteteve të cilat janë në përshtatshmëri me funksionet themelore të secilit nga këto programe. Për funksionimin e programeve trajnuese janë përgjegjës Udhëheqësit e Programeve të cilët po ashtu bëjnë pjesë në kategorinë e nivelit drejtues.

Departamenti i Administratës dhe Financave udhëhiqet nga Drejtori për Administratë dhe Financa, i cili po ashtu është nivel drejtues dhe përfshinë sektorë të cilët janë përgjegjës për sigurimin e shërbimeve të përgjithshme si financiare, të prokurimit, teknologjisë informative, personelit dhe logjistikes, në funksion të realizimit të objektivave programore të Akademisë.

c. Mandati

Të gjithë të punësuarit (25) në Akademi janë shërbyes civil dhe i nënshtrohen ligjeve dhe rregullave për shërbimin civil në Kosovë. Në pajtim me këto rregulla të punësuarit në Akademi janë në marrëdhënie pune me akt emërimi prej kur ka filluar të zbatohet ky sistem.

4.5 Burimet Njerëzore

Burimet njerëzore në kuadër të Akademisë së Drejtësisë kanë qenë të përkushtuara në zbatimin e plotë të funksionit ligjor të Akademisë për ngritjen e kapaciteteve dhe shkathtësive profesionale të gjyqtarëve, prokurorëve, si dhe profesionistëve tjerë të sistemit gjyqësor e prokurorial të Kosovës.

Ato janë resursi më i rëndësishëm dhe përfshinë stafin që lidhet drejtpërdrejt me zbatimin e programeve trajnuese, si dhe stafin administrativ që merret me shërbime tjera të përgjithshme.

Për shkak të lëvizjeve të personelit të Akademisë, gjatë këtij viti janë zhvilluar procedura të rekrutimit për këto pozita si më poshtë:

1. Drejtorit të Akademisë,
2. Udhëheqësit të PTV-së,
3. Zyrtarit për statistika si dhe
4. Zyrtarit për prokurim.

Dy pozitat e para janë plotësuar. Ndërsa për dy pozitat tjera, të cilat janë zëvendësime të punëtorëve që gjenden në pushimin e lehonisë, janë anuluar procedurat e rekrutimit për shkak të mos përbushjes së kërkesave ligjore sipas legjislacionit në fuqi për Shërbimin Ccivil në Kosovë.

Gjatë vitit 2017, janë organizuar disa trajnime dhe punëtori për stafin brenda dhe jashtë Akademisë, është përgatitur plani i trajnimeve, plani individual i punës nga të gjithë nëpunësit si dhe vlerësimi vjetor për arritjen e objektivave të punës.

a. Numri i punëtorëve

Sipas Ligjit të Buxhetit për vitin 2017 numri i përgjithshëm i pozitave të miratuara në ish IGJK, tashmë Akademia e Drejtësisë ka qenë 25 pozita të karrierës. Numri i përgjithshëm i të punësuarve në periudha të caktuara brenda vitit ka lëvizur për arsye të rekrutimit të disa nga stafit në institucione tjera si dhe për shkak të pushimit të lehonisë.

Nga numri total i stafit, bazuar në muajin e fundit të vitit mbi 83.33% e tyre janë me studime post-diplomike dhe diplomike, ndërsa 58.33% të të punësuarve janë femra, kurse 41.67% meshkuj.

b. Nevojat për punëtorë të rinj

Me qëllim të zbatimit të mandatit ligjor të Akademisë dhe zbatimit të legjislacionit në fuqi, gjatë planifikimit buxhetor për vitin 2017 janë kërkuar është bërë kërkesë për plotësimin e pozitave të nevojshme si më poshtë.

Shtatë (7) pozitat e kërkuara për vitin 2018 janë:

- Një (1) Udhëheqës për trajnime të stafit administrativ - Programi për trajnimin e stafit administrativ të gjykatave dhe prokurorive është nevojë e shprehur e sistemit gjyqësor dhe prokurorial dhe obligim i përcaktuar me ligj. Duke marr parasysh numrin e madh të stafit administrativ të sistemit gjyqësor dhe prokurorial Akademia e ka të pamundur zbatimin e këtij programi për gjithë stafin administrativ pa nëpunës përgjegjës për këtë program.
- dy (2) Zyrtar të trajnimeve – AD ka disa programe trajnuese që ju dedikohen përfituesve të ndryshëm dhe këto programe kanë nevojë për personel shtesë profesional, për identifikim të nevojave dhe hartim të programeve adekuate.
- një (1) Zyrtar për publikime dhe hulumtime - në kuadër të funksioneve ligjore të Akademisë është edhe Programi për Hulumtime dhe Publikime i cili për dallim nga programet tjera ende nuk ka arritur plotësisht objektivat e caktuara në veçanti në pjesën e hulumtimeve. Mbështetja edhe me një zyrtarë do të kishte ndikim të drejtpërdrejtë në ofrimin e burimeve ligjore dhe hulumtimeve për zhvillim të kapaciteteve të gjyqësisë dhe prokurorisë në Kosovë.
- një (1) Certifikues të Shpenzimeve – mungesa e zyrtarit certifikues vështirëson punën në kryerjen e shërbimeve financiare. Kjo pozitë është e paraparë edhe me ligj e nevojshme për sigurimin e kontrollit dhe menaxhimin e financave të Akademisë.
- një (1) zyrtar për mësim në distancë (e-learning) – me qëllim të mbështetjes së realizimit të trajnimeve nga distanca (e-mësimi) si një ndër format më të reja të trajnimeve të zhvilluara nga Akademia, nevojitet staf me njohuri në teknologji informative dhe njohuri në fushën juridike.
- një (1) zyrtar ligjor – Akademia e Drejtësisë nuk ka asnjë zyrtar ligjor dhe për pasojë shumë çështje ligjore me të cilat ballafaqohet Akademia nuk kush t'i trajtojë gjë e cila mund të shpi edhe te marrja e situatat kur mund të vihet në pikëpyetje zbatimi i drejtë i legjislacionit në fuqi.

c. Trajnimet e stafit

Akademia është e përkushtuar në zhvillimin dhe avancimin e kapaciteteve profesionale të stafit. Në këtë drejtim ka qenë bashkëpunuese me e IKAP-in dhe varësisht nga nevojat përkatëse për temat e ofruara nga ky institucion ka përcaktuar stafin përfitues të cilët kanë marrë pjesë në këto trajnime. Gjithashtu Akademia ka përfshirë stafin edhe në trajnimet e organizuara në bashkëpunim me donatorë.

Në mënyrë tabelare janë paraqitur trajnimet dhe numri i tyre, në të cilat pjesëmarrës kanë qenë stafi i Akademisë. Duke u mbështetur në kërkesat e drejtpërdrejta të nëpunësve dhe vlerësimit vjetor të punës së tyre është bërë plani i trajnimit për vitin 2018, i cili është i bashkangjitur si aneks i këtij raporti. Realizimi i planit vjetor të trajnimit kryesisht varet nga programet trajnuese të IKAP-it dhe mundësive buxhetore të Akademisë për të siguruar pjesëmarrjen e stafit në trajnime sipas kërkesave për trajnim.

Trajnimet e stafit të Akademisë në vitin 2017

Lloji i trajnimit	Numri i trajnimit
Shkathësitë e Trajnimit	1
Komunikimi Qeveritar me Publikun	1
Menaxhimi i Performancës në Sektorin Publik	1
Ankimimi dhe Çështjet e Disiplinës	1
Microsoft Visio & Microsoft Publisher	1
Windows Server dhe SQL Server	1
Sistemi Informativ dhe Menaxhues i Burimeve Njerëzore –SIMBNJ	1
Marrëveshja e Stabilizim Asociimit mes Kosovës dhe Bashkimit Evropian	1
Trajnimi fillestar i bazuar në lëndë - Elaborimi i Doracakut për trajnim të bazuar në lëndë	1
Menaxhimi i Gjykatave dhe Prokurorive - Sfidat Praktike dhe Zhvillimi i Kurrikulës 6	6
Punëtorja Standardet e BE-së për Trajnimin Fillestar për Gjyqtarët dhe Prokurorët	3

Tabela nr. 1. Trajnimet e stafit 2017

4.6 Asetet

Akademia mban në mënyrë të rregullt regjistrat për regjistrimin e pasurisë. Regjistrimi i aseteve/pasurisë jo financiare përveç në sistemin E-pasuri dhe SIMFK-së, bëhet edhe në bazën e brendshme të të dhënave të AD-së varësisht nga blerjet e aseteve brenda vitit.

a. Asetet e Akademisë

Në kuadër të regjistratit të aseteve përfshihen pasuritë mbi 1,000 euro dhe pasuritë nën 1,000 euro. Në kuadër të regjistratit të pasurive mbi 1,000 euro janë të regjistruara automjetet, fotokopjet, pajisjet e teknologjisë informative dhe pajisjet e zërimit në vlerën neto prej 9,064.33 Euro.

Ndërsa, pasuritë nën vlerën 1,000 euro kanë të bëjnë me pasuritë që kanë jetëgjatësi më shumë se një vit dhe përfshijnë kryesisht disa pajisje të teknologjisë informative, mobilie etj.

Pasuritë jo financiare të Akademisë janë të gjitha pasuritë jo kapitale të regjistruara në E-pasuri dhe bazën e të dhënave të AD-së. Në vlerën totale të pajisjeve përfshihet vlera e pajisjeve që disponon Akademia me 31 dhjetor 2017, duke përfshirë edhe vlerën e pajisjeve të blera gjatë vitit 2017, vlera neto e aseteve nën 1,000 euro është 13,022.12 euro.

b. Planifikimi për asete të reja dhe ndërtesën e Akademisë

Në Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, është miratuar kërkesa e Akademisë për projektin kapital për blerje të kompjuterëve për stafin në vlerë prej 13,000 euro.

Një ndër kërkesat më me rëndësi për këtë vit është edhe ndërtesa e Akademisë. Akademia që

nga dhjetori i vitit 2006 është e vendosur në një ndërtesë për të cilin është detyruar të paguaj qira, në mënyrë që të vazhdoj realizimin e funksioneve ligjore.

Hapësirat e ndërtesës së Akademisë, ku është tani janë rreth **1,224.84 m²**. Zbatimit i të gjitha programeve trajnuese, nevojat në rritje për trajnime të specializuara, nevojat për gjithë përfshirje në trajnime, trajnimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve fillestar, trajnimi i profesionistëve tjerë të përcaktuar me ligj, krijimi i njësive për hulumtime dhe bibliotekës, organizimi i konferencave dhe aktiviteteve tjera të ndryshme ka ndikuar që nevoja për hapësira të rritet.

Ndërtimi i ndërtesës së Akademisë, sipas projektimit planifikohet të ketë një hapësirë rreth 4000 m².

5. Aktivitetet e Akademisë gjatë vitit 2017

Akademia e Drejtësisë është institucion i cili merret me trajnimin e gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe sipas mundësive edhe për avokat, avokat shtetëror dhe profesione tjera të lira.

Po ashtu, Akademia kryen edhe analiza, hulumtime si dhe kryen veprimtari botuese për nevojat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesioneve tjera të lira.

5.1 Krahasimi i punës së Akademisë në tri vitet e fundit

Dinamika e zhvillimeve në gjyqësor, veçanërisht reformat e zbatuara në sistemin gjyqësor me fokus në ndryshimet legjislative, kanë ndikuar edhe në planet dhe programet e trajnimit të Akademisë të cilat kanë përcjellë këto zhvillime.

Lidhur me zhvillimet e Akademisë në raport me vitet paraprake më poshtë janë të prezantuara disa të dhëna në formë tabelare.

Krahasimi i punës së Akademisë me tri vitet e fundit;

Përshkrimi i aktivitetit	2015	2016	2017
Trajnime për gjyqtarë e prokurorë	115	131	123
Trajnime për/ gjyqtarë dhe prokurorë të sapoemëruar ¹	85 ditë të fazës së trajnimit praktik	4 ditë trajnim teorik +11 ditë trajnim praktik	Për prokurorë 99 ditë trajnimi teorik dhe 144 ditë të trajnimit praktik Për gjyqtarë e sapo emëruar 27 ditë trajnim teorik dhe 37 ditë trajnimi praktik
Aktivite tje ²	84	64	60
Numri i pjesëmarrësve gjyqtarë dhe prokurorë në trajnime	1555	1421	1508
Numri i pjesëmarrësve gjyqtarë dhe prokurorë të sapo emëruar	28	17	65
Numri i personelit	25	25	25
Buxheti	532,256	445,140	603,196.94

Tabela nr. 2. Krahasimi i punës së Akademisë në tri vitet e fundit

5.2 Plani i punës për vitin 2017

Akademia e Drejtësisë ka punuar mbi bazën e planeve të punës. Në vitin 2016, Këshilli Drejtues i IGJK-së, ka miratuar Planin e Punës dhe Programin Trajnues për vitin 2017.

Plani i Punës së Akademisë, ka përmbajtur aktivitetet që janë realizuar gjatë vitit 2017, me fokus në ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe interdisciplinare të sistemit gjyqësor dhe prokurorial, përmes programeve të ndryshme trajnuese në të cilat janë përfshirë përveç gjyqtarëve dhe prokurorëve të shtetit, prokurorëve të shtetit të sapoemëruar dhe gjyqtarëve të sapo emëruar si dhe stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial.

Plani i Punës ka përcaktuar strukturën e trajnimeve për vitin 2017 si më poshtë:

- Kompetencat profesionale
- Kompetencat ndërdisiplinore
- Kompetencat lidhur me personalitetin (sjelljen)

¹ Përcaktuese për numrin e ditëve të trajnimit është koha kur ka filluar trajnimi, pasi që ky trajnim zgjatë 12 muaj, në disa raste pjesa më e madhe e trajnimit është zbatuar gjatë një viti, ndërsa pjesa tjetër më e vogël në vitin vijues. Me ndryshimet legjislative kandidatët e PTF-së tashmë janë gjyqtarë dhe prokuror të sapoemëruar.

² Aktivitetet tjera nënkuptojnë, tryeza pune, konferenca, takime pune me trajnues dhe Kryetarë të Gjykatave e Kryeprokurorë të Prokurorive, Trajnime për Trajnues, trajnime për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial, trajnime për gjyqtarë porotë, vizita të ndërsjella në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtarë, punëtori të ndryshme, takime koordinuese etj.

Komponentët kryesore të Planit të Punës janë:

- Trajnimet e Vazhdueshme
- Trajnimet Fillestare
- Trajnimet për Avancim
- Hulumtimet dhe Publikimet
- Trajnimet për Trajnues
- Trajnime për administrimin e gjykatave dhe prokurorive
- Trajnimet për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive si dhe profesionistë tjerë nga fusha e gjyqësisë
- Trajnimet nga distanca

Programi trajnues për vitin 2017 ka qenë një përmbledhjeje e strukturuar e fushave kryesore të punës së gjyqtarëve, prokurorëve, dhe profesionistëve të tjerë në kuadër të sistemit gjyqësor, në bazë të cilit është orientuar hartimi i kurrikulave dhe organizimi i trajnimeve.

Programi trajnues në të gjitha programet trajnuese, për vitin 2017 ka këtë përmbajtje;

- Drejtësia penale
- Drejtësia civile
- Drejtësia për fëmijë
- Krimet e rënda
- Ngritja e shkathtësive profesionale dhe ndër personale kundër korrupsionit
- Krimi ekonomik dhe financiar
- Bashkëpunimi Juridik Ndërkombëtarë në çështjet civile, penale dhe komerciale
- Konfiskimi, sekuestrimi, ngrirja dhe administrimi i aseteve të fituara me vepër penale
- Mbrojtja e mjedisit
- Kundërvajtjet
- E drejta tregtare
- E drejta financiare
- Pronësia intelektuale
- Drejtësia administrative
- E drejta e punës
- Të drejtat dhe liritë e njeriut
- Aktet dhe standardet ndërkombëtare me fokus në të drejtën e BE-së
- Menaxhimi i gjykatës dhe prokurorisë
- Menaxhimi i rasteve
- Hartimi dhe arsyetimi i vendimeve gjyqësore
- Ekspertiza mjekoligjore dhe forenzike
- Etika profesionale dhe deontologjia
- Teknologjia informative

- Komunikimi
- Anglishtja ligjore
- Menaxhimi i kohës dhe stresit
- Programe orientuese të trajnimeve
- Trajnime fillestare për gjyqtarët dhe prokurorët e sapoemëruar
- Trajnime për Trajnues
- Trajnimet nga distanca

5.3 Veprimet që i ka ndërmarrë Akademia në ngritje të cilësisë së trajnimeve

Akademia, në të gjitha fazat e procesit të identifikimit të nevojave trajnuese, në hartimin e programit adekuat me nevojat e shprehura, si dhe me rastin e zbatimit të tij ka bashkëpunuar ngushtë me akterët kryesor të sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

Si rezultat i këtij bashkëpunimi dhe koordinimi është hartuar Programi Trajnues i cili ka përcaktuar fushat me prioritet të trajnimeve dhe është zbatuar në bazë të planeve 6 mujore. Kjo metodologji ka mundësuar krijimin e fleksibilitetit dhe përcaktimit të temave që janë në përputhje me nevojat gjyqësore.

Përveç bashkëpunimit dhe koordinimit me akterët kryesor të sistemit gjyqësor dhe prokurorial Akademia ka pasur në fokus aplikimin e metodave bashkëkohore për trajnimin e të rriturve, duke sjellë praktikatat e vendeve me përvojë në këtë fushë. Vëmendje të veçantë i është kushtuar edhe rritjes së efikasitetit të punës, avancimit të sistemit të pjesëmarrjes në trajnime, zbatimit të mësimin nga distanca, zhvillimit të burimeve juridike për gjyqtarët, prokurorët dhe profesionistët tjerë, zhvillimit të sistemit të programeve praktike jashtë vendit për përfituesit e Akademisë, etj.

5.4 Sfidat e vitit 2017 dhe planifikimi për vitin 2018

Ndër sfidat më të mëdha me të cilat është përballur Akademia gjatë vitit 2017 janë:

- Transformimi i IGJK-së në Akademi të Drejtësisë;
- Buxheti i pamjaftueshëm sipas planifikimeve të përcaktuara në programet trajnuese;
- Hartimi dhe zbatimi i programeve trajnuese sipas nevojave reale të përfituesve;
- Mungesa e ndërtesës së Akademisë;
- Koordinimi i pjesëmarrjes së gjyqtarëve dhe prokurorëve në trajnimin e vazhdueshëm;
- Koordinimi i programeve të ndryshme me donatorë;
- Organizimi i programeve të shkëmbimit;
- Avancimi i metodologjisë trajnuese;
- Zhvillimi i kurseve trajnuese përmes platformës së mësimin në distancë (e-learning);
- Pasurimi i koleksioneve të bibliotekës së Akademisë;
- Organizimi i trajnimeve dhe sigurimi i përkthimit adekuat gjatë trajnimeve dhe materialeve të trajnimit për gjyqtarët dhe prokurorët e integruar sipas Marrëveshjes për Drejtësi;
- Largimi i stafit profesional në kërkim të një statusi më të mirë profesional dhe material;

Pavarësisht sfidave të lartpërmendura, me përkushtim maksimal të organeve drejtuese si dhe stafit të Akademisë, dhe me mbështetjen e shumë partnerëve vendorë dhe ndërkombëtarë, Akademia ka arritur të menaxhojë këto sfida.

Planifikimet për vitin 2018, janë përcaktuar në Planin Vjetor të Punës dhe Programin Vjetor të Trajnimeve, i cili përmban aktivitetet e Akademisë që do të realizohen gjatë vitit 2018. Fokusi i këtyre aktiviteteve është i orientuar në ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe interdisiplinare të sistemit gjyqësor dhe prokurorial, përmes programeve të ndryshme trajnuese në të cilat përfshihen përveç gjyqtarëve dhe prokurorëve, edhe stafi administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesionistë tjerë të identifikuar nga Akademia siç është përcaktuar me ligj.


6. Trajnimet e Akademisë të realizuara gjatë vitit 2017

Aktivitetet e Akademisë janë realizuar sipas strukturës së programeve të trajnimit.


Aktivitetet e Akademisë të realizuara gjatë vitit 2017 në këtë raport do të prezantohen sipas këtij rendi:

- Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm;
- Programi i Trajnimit Fillestar;
- Trajnimet orientuese;
- Programi për Hulumtime dhe Publikime;
- Mësimi në distancë;
- Trajnimet për menaxhmentin dhe stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive;
- Trajnime për Trajnues;
- Punëtori, tryeza pune, konferenca dhe aktivitete tjera;
- Bashkëpunimi me donatorë;
- Bashkëpunimi ndërkombëtarë;
- Programi për praktikant-student;
- Administrata dhe Financa.


Në grafikonet e mëposhtme janë paraqitur trajnimet dhe aktivitetet tjera të realizuara nga Akademia gjatë vitit 2017, duke përfshirë trajnimet e realizuara në të gjitha programet trajnuese,, punëtoritë, programet e internshipit si dhe aktivitetet ndërkombëtare.



Grafikoni nr. 2. Trajnimet e realizuara gjatë vitit 2017



Grafikoni nr. 3. Punëtoritë dhe programet e internshipit në vitin 2017



Grafikoni nr. 4. Aktivitetet e bashkëpunimit ndërkombëtarë gjatë vitit 2017

6.1. Programi për Trajnime të Vazhdueshme

Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV) zhvillon aktivitetet trajnuese përmes të cilave siguron standarde të larta të cilësisë së trajnimit gjyqësor. Trajnimet që realizohen në kuadër të PTV, iu ofrohen të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial, me qëllim të zhvillimit të vazhdueshëm dhe avancimit të shkathëtisë profesionale dhe atyre interdisiplinare.

Aktivitetet e realizuara në PTV përmbajnë tema të karakterit profesional/ligjor nga fushat e drejtës penale, civile, drejtësia penale për fëmijë, drejtësia civile për fëmijë, e drejta ekonomike, e drejta administrative, e drejta kushtetuese, e drejta ndërkombëtare dhe e BE, të drejtat e njeriut, barazia gjinore dhe mos-diskriminim, aspekte materiale dhe procedurale nga lëmia e kundërvajtjeve, si dhe tema të karakterit interdisiplinar.

Gjatë vitit 2017, aktivitetet trajnuese në kuadër të PTV-së janë realizuar në forma të ndryshme duke përfshirë trajnime, seminare, tryeza të diskutimeve, tryeza pune, trajnime për trajnues, programe internishiipi, vizita studimore etj. Falë zhvillimit dhe ruajtjes së partneritetit efektiv dhe të qëndrueshëm, disa aktivitete në PTV-së janë realizuar me mbështetje të partnerëve ndërkombëtarë të cilët kanë ndihmuar Akademinë e Drejtësisë në zbatimin e disa programeve të veçanta.

6.1.1 Objektivat e PTV për vitin 2017

Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm për vitin 2017, në fokus kishte arritjen e objektivave si më poshtë:

- Zhvillimin e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve rreth kompetencës profesionale dhe asaj ndër personale në funksion të zbatimit të drejtë të legjislacionit;
- Unifikimin e praktikës gjyqësore;
- Zhvillimin e shkathtësive të gjyqtarëve dhe prokurorëve për pozitën menaxhuese, planifikimin strategjik dhe për menaxhim të mirë të rasteve;
- Nxitjen e shkëmbimit të njohurive, metodave dhe praktikave të mira profesionale;
- Avancimin e njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve rreth të drejtës Evropiane, të drejtave të njeriut dhe të drejtës ndërkombëtare;
- Ngritjen e kapaciteteve profesionale të stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial dhe profesionistëve tjerë;
- Ofrimin e një qasje multidisiplinore për temat apo çështjet e adresuara nga nevojat për trajnim të gjyqtarëve dhe prokurorëve;

6.1.2 Fushat e trajnimit që mbulon PTV

Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm, në përmbajtjen e tij përfshinë tema të karakterit profesional dhe ndër personal nga fushat si:


- E drejta penale (materiale dhe procedurale);
- E drejta civile (materiale dhe procedurale);
- Drejtësia për fëmijë - lëmia penale dhe civile;
- E drejta ekonomike;
- E drejta administrative;
- E drejta kushtetuese;
- Trajnimet për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme;
- Lëmia e kundërvajtjeve;
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- E drejta ndërkombëtare dhe e drejta e BE-së;
- Barazia gjinore dhe mos-diskriminimi;
- Kompetenca ndërdisiplinore;

6.1.3 Aktivitetet trajnuese në PTV


Gjatë periudhës raportuese në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme janë realizuar 123 aktivitete trajnuese sipas fushave si më poshtë:

Nr.	Fusha e trajnimeve	Numri i trajnimeve
1	Fusha penale - materiale dhe procedurale	50
2	Fusha civile - materiale dhe procedurale	26
3	Drejtesia për fëmijë – aspekti penal	9
4	Drejtesia për fëmijë – aspekti civil	3
5	Fusha Administrative	4
6	Fusha Ekonomike	6
7	Fusha Kushtetuese	1
8	Fusha Kundërvajtje	5
9	Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme	5
10	KEDNJ	4
11	E drejta ndërkombëtare dhe e BE-së	2
12	Kompetenca interdisiplinare	5
13	Barazia gjinore dhe mos-diskriminimi	3

Tabela nr.3 Numri i aktiviteteve trajnuese sipas fushave




Grafikoni nr. 4: Numri i trajnimeve të realizuar në PTV sipas fushave



Grafikoni nr. 5: Numri i trajnimeve të realizuar në PTV sipas lëmive i shprehur në përqindje

6.1.4 Pjesëmarrja në Programin e Trajnimit të Vazhdueshëm


Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve në trajnime të vazhdueshme gjatë vitit 2017 ishte 1901. Nga numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve 1168 ishin gjyqtarë, 340 prokurorë dhe 393 ishin pjesëmarrës tjerë, ku përfshihen bashkëpunëtorë profesional, stafi administrativ gjyqësor dhe prokurorial, avokatë, zyrtarë nga Policia e Kosovës, Shërbimi Sprovues, Dogana, Administrata Tatimore, MPMS – Qendra për Punë Sociale etj. Nga këta pjesëmarrës, 1657 ishin shqiptarë, 244 minoritete, ndërsa në baza gjinore, 1172 pjesëmarrës ishin meshkuj dhe 729 femra.



Grafikoni nr. 6: Numri i pjesëmarrësve në trajnimet e realizuara në PTV


6.1.5 Numri i trajnimeve në baza mujore

Grafikoni i mëposhtëm paraqet të dhënat e detajuara për aktivitetet e realizuara në PTV në baza mujore.




Grafikoni nr. 7: Numri i trajnimeve të realizuar në PTV në baza mujore

Gjatë muajit janar janë realizuar pesë (5) trajnime, prej tyre dy (2) nga fusha penale, një (1) nga fusha civile, një (1) në kundërvajtje dhe një (1) nga fusha e të drejtave dhe lirive të njeriut.




Grafikoni nr. 8: Numri i trajnimeve të realizuara në PTV sipas fushave, gjatë muajit janar

Muaji shkurt përfshinë **nëntë (9) trajnime**, nga fusha penale janë realizuar katër (4) trajnime, dy (2) nga fusha civile, një (1) nga drejtësia për fëmijë – aspekti civil, një (1) nga fusha ekonomike dhe një (1) trajnim për kundër diskriminimit.




Grafikoni nr. 9: Numri i trajnimeve të realizuar në PTV sipas fushave, gjatë muajit shkurt

Gjatë muajit mars në PTV janë realizuar dymbëdhjetë (12) trajnime, katër (4) trajnime nga fusha penale, dy (2) në civile, një (1) nga drejtësia për fëmijë – aspekti penal, një (1) në ekonomike, një (1) në administrative, një (1) trajnim për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, një (1) nga KEDNJ, dhe një (1) nga e drejta ndërkombëtare dhe e BE-së.




Grafikoni nr. 10: Numri i trajnimeve të realizuar në PTV sipas lëmive, gjatë muajit mars

Aktivitetet e realizuara gjatë muajit prill kanë qenë gjithsej njëmbëdhjetë (11), tre (3) nga lëmia penale, pesë (5) nga ajo civile, një (1) nga drejtësia për fëmijë – aspekti penal, një (1) nga fusha administrative, një (1) në kompetenca interdisiplinare.




Grafikoni nr. 11: Numri i trajnimeve të realizuar në PTV sipas fushave, gjatë muajit prill

Gjatë muajit maj janë realizuar trembëdhjetë (13) trajnime, gjashtë (6) nga fusha penale, tri (3) nga fusha civile, një (1) nga drejtësia për fëmijë – aspekti penal, një (1) nga fusha e kundërvajtjes, një (1) në kushtetuese dhe një (1) në kompetenca interdisiplinare.




Grafikoni nr. 12: Numri i trajnimeve të realizuar në PTV sipas fushave, gjatë muajit maj

Aktivitete trajnuese të realizuara në PTV gjatë qershorit ishin gjithsej njëmbëdhjetë (11), katër (4) nga fusha penale, dy (2) nga fusha civile, një (1) nga drejtësia për fëmijë – aspekti penal, dy (2) për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, një (1) nga kompetenca interdisiplinare dhe një (1) për barazi gjinore.




Grafikoni nr. 13 Numri i trajnimeve të realizuar në PTV sipas fushave, gjatë muajit qershor

Gjatë korrikut në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme janë realizuar tri (3) trajnime, dy (2) nga fusha penale dhe një (1) nga fusha civile.




Grafikoni nr. 14: nr. i trajnimeve të realizuar në PTV sipas fushave gjatë muajit korrik

Katërbëdhjetë (14) trajnime janë realizuar në PTV gjatë muajit shtator, pesë (5) nga fusha penale, dy (2) nga fusha civile, dy (2) nga drejtësia për fëmijë – aspekti penal, një (1) nga fusha ekonomike, një (1) administrative, një (1) kundërvajtje, një (1) KEDNJ dhe një (1) nga kompetenca interdisiplinare.




Grafikoni nr. 15: nr. i trajnimeve të realizuar në PTV sipas fushave gjatë muajit shtator

Muaji tetor në PTV shënon muajin me numrin më të madh të **aktiviteteve trajnuese** gjatë vitit 2017. Janë realizuar gjithsej njëzet (20) trajnime, prej tyre tetë (8) nga fusha penale, dy (2) nga fusha civile, një (1) nga drejtësia për fëmijë – aspekti penal, një (1) nga drejtësia për fëmijë – aspekti civil, dy (2) nga fusha ekonomike, një (1) kundërvajtje, dy (2) trajnime për Dhomen e Posaçme të Gjykatës Supreme, një (1) për KEDNJ, një (1) nga e drejta ndërkombëtare dhe e BE-së dhe një (1) për barazinë gjinore.




Grafikoni nr. 16: Numri i trajnimeve të realizuar në PTV sipas fushave, gjatë muajit tetor

Gjatë nëntorit janë realizuar gjashtëmbëdhjetë (16) trajnime, prej tyre gjashtë (6) nga fusha penale, tri (3) nga fusha civile, dy (2) nga drejtësia për fëmijë – aspekti penal, një (1) nga drejtësia për fëmijë – aspekti civil, një (1) nga fusha ekonomike, një (1) administrative, një (1) nga fusha e kundërvajtjes dhe një (1) nga kompetenca interdisiplinare.



Grafikoni nr. 17: Numri i trajnimeve të realizuar në PTV sipas fushave, gjatë muajit nëntor


Fokusi i aktiviteteve trajnuese gjatë muajit dhjetor ka qenë në fushën civile dhe atë penale. Janë realizuar gjithsej nëntë (9) trajnime, shtatë (7) penale dhe dy (2) civile.



Grafikoni nr. 18: Numri i trajnimeve të realizuar në PTV sipas fushave, gjatë muajit dhjetor

6.1.6 Trajnimet e vazhdueshme sipas kohëzgjatjes

Në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme, gjatë vitit 2017 janë realizuar 103 trajnime një (1) ditore, gjashtëmbëdhjetë (16) trajnime dy (2) ditore, tri (3) trajnime tre (3) ditore dhe një (1) trajnim katër (4) ditorë.



Grafikoni nr. 19: Numri i trajnimeve të realizuara në PTV sipas kohëzgjatjes

6.1.7 Trajnimet e vazhdueshme sipas fushave

6.1.7.1 Trajnimet nga fusha penale (materiale dhe procedurale)

Gjatë vitit 2017, në kuadër të PTV nga fusha penale janë realizuar 50 aktivitete trajnuese. Në kuadër të këtyre aktiviteteve, janë trajtuar çështje nga e drejta penale materiale dhe e drejta procedurale.

a. E drejta penale materiale

Nga e drejta penale materiale janë realizuar trajnimet si: krimi i organizuar, terrorizmi, trafikimi me qenie njerëzore dhe kontrabandimi me migrant, veprat penale kundër detyrës zyrtare, krimet e luftës vepra penale kundër ekonomisë, vepra penale kundër jetës dhe trupit, vepra penale sipas Kodit Doganor, matja e dënimit, bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale, përgjegjësia penale e personave juridik.

Trajtimi i këtyre temave kishte për qëllim:

- Ngritjen e shkathtësitë profesionale për hetimin e veprave penale dhe gjykimin e rasteve të krimit të organizuar;
- Avancimin e njohurive lidhur me terrorizmin dhe përgatitjen profesionale për luftimin e kësaj dukurie;

- Avancimin e njohurive për parandalimin e trafikimit me njerëz dhe kontrabandimit me migrant;
- Zbatimin e instrumenteve të përshtatshme për trajtimin gjyqësor të rasteve të terrorizmit;
- Njohjen e legjislacionit vendor dhe ndërkombëtarë që trajton krimet e luftës;
- Zhvillimin e njohurive për zbatimin e legjislacionit lidhur me veprat penale kundër detyrës zyrtare, veprave penale kundër trupit dhe jetës, dhe veprave penale kundër ekonomisë;
- Zbatimin e një sistem unik të matjes së dënimit dhe individualizimit të dënimit;
- Analizimin e rasteve kur ka të beje me shtytjen dhe ndihmën në kryerjen e veprës penale;
- Zbatimin e drejtë të institutit të përgjegjësisë penale të personave juridik, etj;

b. E drejta penale procedurale:

Temat që janë trajtuar nga e drejta procedurës penale janë: ngritja e përkohshme aseteve, sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë, zbatimi i masave të fshehta hetimore, masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurën penale, shqyrtimi fillestar, shqyrtimi i dytë dhe shqyrtimi gjyqësor, mbrojtja e të dëmtuarve dhe dëshmitarëve, bashkëpunimi juridik ndërkombëtarë në çështjet penale, fillimi i hetimit dhe procedura penale, dëshmitarët në procedurë penale, hetimi i krimeve financiare, urdhër kontrolli, aktakuza, të drejtat e të pandehurit nga ndalimi i parë deri në përfundim të procedurës penale, cilësia dhe vlerësimi i provave në procedurë penale, procedura penale ku përfshihen kryerësit me çrregullime mendore, mjetet e rregullta juridike dhe bazat e ankesës.

Objektivi kryesor i trajnimeve nga fusha penale procedurale ishte, ngritja e shkathtësive të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me:

- Zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore në lidhje me sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë;
- Vlerësimin dhe zbatimin e kushteve ligjore për lëshimin e masave të fshehta dhe teknike të hetimit dhe vëzhgimit;
- Vlerësimin e drejtë të elementeve për caktimin e masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë;
- Interpretimin dhe zbatimin e drejtë të dispozitave që kanë të bëjnë me shqyrtimin fillestar, të dytë dhe shqyrtimin gjyqësor;
- Tejkalimin e sfidave në procedurën penale kur përfshihen kryerësit me çrregullime mendore, masat e trajtimit të detyrueshëm dhe paraburgimi;
- Udhëheqjen e suksesshme në hetimin e krimeve financiare;
- Zbatimin drejtë të dispozitave lidhur me mbrojtja e të dëmtuarve dhe dëshmitarëve;
- Vlerësimin drejtë të elementeve që duhet të përmbajë aktakuza;
- Analizimin e procedurës para fillimit të urdhër kontrollit;
- Zbatimin drejtë të kornizës ligjore për të drejtat e të pandehurit në procedurë penale;
- Vlerësimin e bazës për ushtrimin e mjeteve juridike, etj;

6.1.7.2 Programet e specializuara të trajnimit

Në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, krahas trajnimeve tjera, janë realizuar edhe katër (4) programe të specializuara trajnimi në fushën penale, si më poshtë.

a. Program i specializuar trajnimi për zhvillimin e kapaciteteve në luftën kundër korrupsionit

Qëllimi i realizimit të këtyre sesioneve trajnuese ishte zhvillimi profesional i gjyqtarëve dhe prokurorëve që merren me luftimin e veprave penale të korrupsionit, dhe trajtimi i sfidave rreth zbatimit të legjislacionit vendor, në luftimin efikas të korrupsionit, duke u fokusuar në aspekte specifike që paraqiten si problematike në praktikë.

Programi është realizuar në tri (3) sesione trajnuese, me nga dy (2) ditë trajnimi, dhe në fokus kishte identifikimin dhe vlerësimin e korrupsionit të mundshëm zyrtar, planet hetuese, analizat forenzike, intervistat dhe përgatitja për gjykim, dhe zgjidhjen e rasteve të korrupsionit zyrtar.

b. Program i specializuar trajnimi për prokurimin publik

Sesionet trajnuese të prokurimit publik kishin për qëllim avancimin e njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve rreth legjislacionit pozitiv, procedurave dhe fazave të prokurimit publik, si dhe identifikimin e indikatorëve të korrupsionit që lidhen me prokurimin publik. Në fokus të këtij programi ishte edhe faza e zbatimit të kontratës dhe po ashtu hetimi dhe gjykimi i veprave penale të kësaj natyre.

Programi u realizua në dy (2) sesione trajnuese, me nga dy (2) ditë trajnimi, dhe vëmendje ju kushtua rreziqeve indikativë të korrupsionit në fazën e zbatimit të kontratave të prokurimit publik, skemat korruptive dhe problemet e ndërlidhura me mashtrim si dhe planifikimi i hetimit dhe ndjekja e kryesve.

c. Program i specializuar trajnimi në forcimin e kapaciteteve profesionale në luftimin e shpëlarjes së parave

Synimi kryesor i trajnimeve për luftimin e shpëlarjes së parave, ishte avancimi i njohurive profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve në identifikimin dhe klasifikimin e veprave penale të shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, në njohjen dhe analizimin e punës së institucioneve financiare dhe obligimet që i kanë këto institucione në drejtim të forcimit të kapaciteteve për luftimin e dukurive të kësaj natyre.

Programi u realizua në tri (3) sesione trajnuese, me nga dy (2) ditë trajnimi, dhe në vete trajtoj veprat penale të shpëlarjes së parave, financimin e terrorizmit dhe sanksionet, dobësitë e institucioneve financiare tek pastrimi i parave, luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në praktikë, kompetencat e Njësisë për Inteligjencë Financiare, teknikat e ekzaminimit të mashtrimeve tek pastrimi i parave, mbledhjen e informatave dhe përgatitjen e profilit personal, gjurmimin e fondeve nga ana e marrësit dhe nga ana e paguesit, bashkëpunimin ndërkufitar dhe ndërkombëtar për luftimin e pastrimit të parave, paraqitjen e rastit në gjykatë, zgjidhjet e mundshme

alternative si dhe masat për parandalimin e pastrimit të parave.

d. Program i specializuar trajnimi në forcimin e kapaciteteve profesionale në luftimin e krimit kibernetik

Edhe ky sesion trajnimi kishte për qëllim që të kontribuoj në thellimin e njohurive në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtarë dhe mundësisë së ndjekjes së suksesshme të krimit kibernetikë, për provat elektronike, rëndësinë dhe veçoritë e tyre, si dhe të identifikojnë dhe vlerësojnë provat elektronike në përcaktimin e veprës penale.

Programi u realizua në tri (3) sesione trajnuese, me nga dy (2) ditë trajnimi dhe trajtoi krimin e kryer përmes teknologjisë, sfidat e krimit kibernetik, vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut, luftimin e rreziqeve të sigurisë virtuale, roli i forenzikes në zbulimin e krimit kibernetik, provat elektronike – procedura dhe praktika, bashkëpunimi ndërkufitar dhe ndërkombëtarë në luftën kundër krimit kibernetikë.

6.1.7.3 Trajnimet nga drejtësia për fëmijë – aspekti civil dhe penal

Akademia e Drejtësisë, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme edhe gjatë vitit 2017, ka realizuar nëntë (9) trajnime nga aspekti penal i Drejtësisë për Fëmijë, dhe tri (3) trajnime nga aspekti civil i Drejtësisë për Fëmijë.

a. Drejtësia për Fëmijë – aspekti penal ka trajtuar tema si:

Masat e diversitetit, dënimet që u shqiptohen të miturve, ekzekutimi i masave dhe dënimeve ndaj të miturve, gjykimi i të miturve dhe madhorëve në një proces gjyqësor, masat edukative ndaj të miturve, masat për sigurimin e pranisë së të miturit në procedurë, shqyrtimi gjyqësor në procedurë ndaj të miturve si dhe veprat penale kundër integritetit seksual.

Qëllimi i trajnimeve nga drejtësia për fëmijë - aspekti penal ishte avancimi i njohurive dhe shkathtësive të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me:

- Zbatimin e drejtë të dispozitave të KDM për shqiptimin e masave të diversitetit;
- Identifikimin e kushteve ligjore për shqiptimin e dënimeve për të mitur;
- Zgjerimin e njohurive rreth procedurës penale ku i mituri kryen veprë penale me të rriturin, si dhe identifikimi i përparësive dhe mangësitë të procedurës së bashkuar;
- Vlerësimin drejtë të kohëzgjatjes së masave që privojnë nga liria;
- Zgjerimin e njohurive lidhur me rrjedhën e shqyrtimit gjyqësor në procedurën ndaj të miturve.

b. Drejtësia për Fëmijë – aspekti civil ka trajtuar tema si:

Nga moduli trajnues drejtësia për fëmijë - aspekti civil, janë trajtuar temat si: mbrojtja e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror, mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në kontestet martesore – familjare dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në rastet e ndryshimit të statusit të tyre.

Fokusi kryesor i këtyre trajnimeve ishte ngritja e aftësive dhe shkathtësive të gjyqtarëve lidhur me:

- Ngritjen e kapaciteteve praktike dhe profesionale të gjyqtarëve në interpretimin e drejtë të dispozitave ligjore lidhur me rolin e gjykatës dhe organit të kujdestarisë në procedurën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror;
- Kuptimin e drejtë të rolit aktiv të gjykatës dhe organit të kujdestarisë si dhe hetimit me kompetencë të të gjitha rrethanave në bazë të cilave duhet të jepet vlerësimi dhe vendimi profesional në funksion të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në kontestet martesore;
- Thellimin e njohurive teorike dhe praktike të gjyqtarëve, lidhur me interpretimin dhe zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me procedurën e kundërshtimit dhe procedurën e njohjes së atësisë dhe amësisë, si dhe rolin e gjykatës dhe organit të kujdestarisë në lëshimin e urdhër mbrojtjeve përkatëse, në drejtim të mbrojtjes së interesit më të mirë të fëmijës në rastet e ndërrimit të statusit të tyre.

6.1.7.4 Trajnimet nga fusha civile (materiale dhe procedurale)

Akademia e Drejtësisë në kuadër të PTV, gjatë vitit 2017, në fushën civile ka realizuar 26 trajnime duke përfshirë tema nga pjesa materiale dhe procedurale.

Ndër temat kryesore të cilat u trajtuan në kuadër të këtyre trajnimeve janë:

Aktgjykimi dhe llojet e tij sipas LPK-së, kontrata për ndërtim dhe përgjegjësia e kontraktuesve, palët dhe përfaqësimi i tyre në procedurë, renta, llojet dhe caktimi i saj, seanca përgatitore, shqyrtimi kryesor dhe marrja e provës, shqyrtimi paraprak i padisë dhe përgatitja e shqyrtimit kryesor, lejimi i përmbarrimit dhe vendosja sipas prapësimit, mbrojtja gjyqësore e të drejtës së pronësisë, pasuria e përbashkët e bashkëshortëve dhe pjesëtimi i saj, pjesa e domosdoshme e trashëgimisë dhe cenimi i saj, shpronësimi dhe kompensimi i pronës së shpronësuar, sigurimi i kërkesëpadisë, mbrojtja gjyqësore në rastet e dhunës në familje, mbrojtja gjyqësore në rastet e fyerjes dhe shpifjes, procedura gjyqësore për zgjidhjen e martesës, anulimi i kontratave, bashkëndërgjyqësia dhe ndërhyrësit në procedurë, kompensimi i dëmit jo material, përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga sendi dhe veprimtaria e rrezikshme, procedura e vendosjes sipas mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme dhe dhuna në familje.

Nëpërmjet temave të trajtuara nga fusha civile është synuar ngritja e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve në:

- Vlerësimin dhe analizimin e aktgjykimit si formë të vendosjes meritore;
- Vlerësimin e kushteve të nevojshme për lidhjen e kontratës së ndërtimit;
- Identifikimin se kush mund ta ketë cilësinë e palës në procedurë;
- Vlerësimin e kushteve të nevojshme për caktimin e rentës si dhe identifikimin e përfituesve të saj;
- Zhvillimin e shqyrtimit kryesor dhe udhëheqjen dhe drejtimin e suksesshëm të procedurës dhe administrimin e provave;
- Vlerësimin e rasteve kur përmbarrimin e zbaton përmbarruesi privat e kur gjykata;
- Njohjen dhe analizimin e të drejtës së pronësisë, autorizimet, kufizimet si dhe mbrojtjen e saj;

- Vlerësimin dhe identifikimin e trashëgimtarëve të domosdoshëm dhe llogaritjen e drejtë të pjesës së tyre;
- Analizimin e procedurës së vlerësimit të pasurisë dhe caktimit të kompensimit;
- Njohjen dhe dallimin e llojeve të masave të sigurimit të kërkesëpadisë;
- Njohjen e procedurave standarde të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje;
- Zbatimin e standardeve dhe kërkesat që dalin nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, me rastin e vendosjes së kërkesëpadive tek fyerja dhe shpifja;
- Zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore lidhur me procedurën e zgjidhjes së martesës me anulim dhe shkurorëzim;
- Vlerësimin e efekteve të veprimeve procedurale të bashkndërgjyqësve, si dhe identifikimin e personave të tretë në konteste civile dhe ndërhyrësit;
- Njohjen dhe vlerësimin e kriterëve për caktimin e dëmit jomaterial si dhe zbatimin e dispozitave për lartësinë e shpërblimit të dëmit jo material;
- Zbatimin e drejtë të dispozitave lidhur me përgjegjësinë për dëmin nga sendi dhe veprimtaria e rrezikshme;
- Analizimin e mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme;

6.1.7.5 Trajnimet nga fusha ekonomike

Vend të rëndësishëm në programin trajnues për vitin 2017 kanë zënë edhe trajnimet për gjyqtarët që trajtojnë lëndët nga fusha ekonomike.

Në kuadër të këtij programi, Akademia ka realizuar gjashtë (6) trajnime, ku janë trajtuar çështjet si: të drejtat e pronësisë intelektuale – të drejtat e autorit, kontratat në ekonomi, shoqëritë tregtare, risitë e Ligjit për Falimentimin, markat tregtare dhe zgjidhja alternative e kontesteve.

Trajnimet nga lëmia ekonomike synuan ngritjen e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve në:

- Zgjerimin e njohurive për legjislacionin vendor dhe atë ndërkombëtarë në fushën e falimentimit, dhe vlerësimin e kriterëve për fillimin e procedurës së falimentimit;
- Njohjen e dokumenteve që e përcjellin qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve si dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale në interpretimin e drejtë të dispozitave të LMD-së mbi qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve;
- Njohjen e legjislacionit të zbatueshëm në fushën e të drejtave të autorit;
- Analizimin e procedurave ligjore në mbrojtjen e të drejtave të palëve afariste, në kontestet që rrjedhin nga mos përmbushja e kontratave në ekonomi.

6.1.7.6 Trajnimet nga fusha administrative

Në përmbajtjen e Programit Trajnues 2017, nuk kanë mbetur anash edhe trajnimet për gjyqtarët e Departamentit për Çështje Administrative. Nga kjo lëmi, janë realizuar katër (4) trajnime për gjyqtarët e këtij departamenti.

Në këto trajnime janë trajtuar çështjet si: Regjistrat e gjendjes civile, regjistrimi i mëvonshëm dhe ri-regjistrimi sipas Ligjit për Regjistrimin Civil, procedura në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil në Kosovë, dhe mbrojtja gjyqësore në kontestet e punës në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, lëvizja dhe qëndrimi i të huajve si dhe procedurat ligjore ndaj tyre në Republikën e Kosovës, si dhe trajtimi i dilemave aktuale në Ligjin për Konfliktet Administrative.

Përmes këtyre trajnimeve është synuar ngritja e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve në:

- Analizimin e procedurave që zhvillohen në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës si dhe njohjen e procedurës së inicimit të konfliktit administrativ në gjykatën kompetente ndaj vendimit të KPM;
- Avancimin e njohurive lidhur me Ligjin për Gjendjen Civile;
- Njohjen e procedurave ligjore lidhur me qëndrimin e paligjshëm, kthimin dhe dëbimin e të huajve;
- Analizimin e dilemave që ndërlidhen me zbatimin e dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative;

6.1.7.7 Trajnimet nga e drejta kushtetuese

Akademia e Drejtësisë, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme, ka realizuar një (1) trajnim nga lëmia e së drejtës kushtetuese me temë Referimi paragjykimor (incidental) dhe procedurat sipas nenit 113 par. 8 i Kushtetutës së Kosovës.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me referimin kushtetues, analizën teorike dhe normative të tij, duke u përqendruar në dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, Rregulloren e Punës së Gjykatës Kushtetuese si dhe të praktikës së Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe të gjykatave tjera kushtetuese në rajon dhe me gjerë.

6.1.7.8 Trajnime për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme

Pjesë e Programit Trajnues të Akademisë gjatë vitit 2017, kanë qenë edhe trajnimet për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme. Në kuadër të trajnimeve për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme janë realizuar pesë (5) trajnime, ku janë trajtuar çështjet si: Kompetencat e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, procedura gjyqësore në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, pranueshmëria e kërkesës/ankesës në Dhomën e Posaçme, shqyrtimi i kërkesave kreditore dhe pronësore në procesin e likuidimit, dhe procedura për privatizimin e subjekteve nga AKP.

Qëllimi i realizimit të këtyre trajnimeve ishte ngritja e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve lidhur me:

- Vlerësimin e kompetencave të DHPGJS-së;
- Analizimin e kriterëve të pranueshmërisë sipas shtojcës së Ligjit të DHPGJS-së;
- Njohjen e procedurës së paraqitjes së kërkesë në Komisionin e Likuidimit për realizimin e

kërkesave pronësore dhe kreditore;

- Avancimin e njohurive rreth rolit të Agjencisë në procesin e privatizimit në Kosovë si dhe të kuptuarit e drejtë të rrjedhës së procedurave për privatizimin e subjekteve;

6.1.7.9 Trajnimet nga fusha e kundërvajtjeve

Nga fusha e kundërvajtjeve në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme, janë realizuar pesë (5) trajnime për gjyqtarët e divizionit për kundërvajtje në të cilat janë trajtuar: Administrimi i provave - parimet udhëheqëse, aktvendimi dhe arsyetimi ligjor, personat juridik dhe procedura kundërvajtëse, kundërvajtjet nga lëmi i rendit dhe qetësisë publike - neni 4, 5 dhe 16 të Ligjit për Rendin dhe Qetësinë Publike, si dhe kundërvajtjet dhe sanksionet kundërvajtëse sipas ligjit të ri për kundërvajtje.

Temat e trajtuara kanë synuar ngritjen e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve që të:

- Kuptojnë drejtë provën dhe faktin, si dhe të dallojnë provat e pranueshme nga ato të papranueshme në procedurën kundërvajtje;
- Analizojnë dhe hartojnë drejtë aktvendimet në procedurën për kundërvajtje;
- Zhvillojnë drejt dhe në mënyrë ligjore procedurën për kundërvajtje ndaj personave juridik dhe personave përgjegjës të personit juridik;
- Dallojë veprën kundërvajtësenga vepra penale;
- Njohin se si zhvillohet procedura kundërvajtjes sipas ligjit të ri për kundërvajtje.

6.1.7.10 Trajnimet për Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Për të njohur rëndësinë e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe efektet e saj në sistemin juridik të Republikës së Kosovës, Akademia e Drejtësisë gjatë vitit 2017 ka realizuar katër (4) trajnime, ku janë trajtuar tema si: Zbatimi i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në sistemin kushtetues të Kosovë, neni 6 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut si dhe zbatimi i tij, neni 10 i KEDNJ si dhe nenet 2-7 të KEDNJ.

Fokusi kryesor i këtyre trajnimeve ishte në ngritjen e aftësive dhe shkathtësive profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve në:

- Analizimin e efektit të KEDNJ në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe sistemin e saj kushtetues;
- Thellimin e njohurive lidhur me zbatimin e nenit 2, 3, 4, 5, 6, dhe 7 të Konventës dhe të përvojës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut lidhur me këto nene;
- Zbatimin e praktikës gjyqësore të GJEDNJ lidhur me nenin 6 të KEDNJ;
- Analizojnë drejtë dispozitat mbi të drejtën e lirisë së shprehjes, dhe zbatimi i praktikës së GJEDNJ-së lidhur me nenin 10 të Konventës;

6.1.7.11 Trajnimet për të Drejtën Ndërkombëtare dhe të Drejtën e BE-së

Në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme, janë përfshirë trajnimet edhe për të drejtën e BE-së dhe të drejtën ndërkombëtare në përgjithësi si: zbatimi i së drejtës evropiane nga ana e gjykatave të Republikës së Kosovës, zbatimi gjyqësor i Konventës së Aarhusit - e drejta në informacion, pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje dhe qasja në drejtësinë mjedisore.

Këto tema kishin për qëllim ngritjen e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me:

- Vlerësimin e të drejtave për qasje në informacionet mjedisore dhe analizimin e përgjegjësisë penale për ndotjen e mjedisit;
- Interpretimin drejtë të Marrëveshjes për Stabilizim – Asociim si dhe njohjen e efektit dhe ndikimit të së drejtës evropiane në gjyqësorin e Kosovës.

6.1.7.12 Aktivitetet për barazinë gjinore dhe mos diskriminimin

Duke dashur ti adresoj sfidat në zbatimin e legjislacionit për barazi gjinore si dhe ti përgjigjet rekomandimeve të BE-së, Akademia e Drejtësisë në kuadër të PTV ka realizuar tri (3) aktivitete trajnuese lidhur me barazinë gjinore dhe mos diskriminimin. Temat e trajtuara nga kjo lëmi ishin: Mbrojtja dhe promovimi i diversitetit, tolerancës dhe barazisë në kontekst të legjislacionit mbi mos diskriminimin dhe barazia gjinore në procedurë. Qëllimi i këtyre aktiviteteve ishte mbrojtja, promovimi i diversitetit, dhe tolerancës si dhe shkëmbimi i përvojave të gjyqtarëve dhe prokurorëve, për tejkalimin e sfidave të legjislacionit dhe praktikës gjyqësore në fushat ku barazia gjinore është më prezente.

6.1.7.13 Trajnimet nga kompetenca ndërdisiplinare

Programi Trajnues i Akademisë së Drejtësisë ka ofruar tema jo vetëm nga fushat e së drejtës, por edhe tema të karakterit ndërdisiplinore. Në kuadër të kësaj kompetence janë realizuar trajnime si: ndryshimet dhe risitë e Kodit të Etikës Profesionale dhe Rregullorja për sjellje të pahijshme të gjyqtarëve, hartimi dhe arsyetimi i vendimeve gjyqësore në fushën penale, arsyetimi i vendimeve gjyqësore në fushën civile, menaxhimi i rasteve dhe menaxhimi i stresit.

Këto trajnime kishin për qëllim ngritjen e kapaciteteve ndërdisiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me integritetin, avancimin e shkathtësive në shkrimin dhe arsyetimin e vendimeve gjyqësore, ngritjen e shkathtësive praktike të menaxhimit të rasteve në gjykatë dhe prokurori, si dhe përdorimin e metodave dhe teknikave për tejkalimin e situatave stresuese që shfaqen në punë dhe gjatë punës.

6.1.8 Programi trajnues hyrës për gjyqtarët dhe prokurorët e shtetit nga komuniteti serb të integruar sipas Marrëveshjes për Drejtësi


Akademia e Drejtësisë ka zbatuar Programin Trajnues Hyrës nga fusha e drejtësisë penale, civile dhe kompetencës interdisiplinore për gjyqtarët dhe prokurorët e shtetit të integruar dhe

dekretuar së fundmi në sistemin gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës, sipas Marrëveshjes për Drejtësi e arritur në Bruksel.

Programi trajnues kishte për qëllim ofrimin e trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve, në kryerjen me sukses të punës dhe marrjen në mënyrë të drejtë të vendimeve gjyqësore. Programi ka pasur karakter orientues me qëllim që gjyqtarët dhe prokurorët e integruar të njoftohen me parimet bazë të legjislacionit të Kosovës dhe institutet e reja juridike që përmban legjislacioni i Kosovës, e të cilat duhet të zbatohen nga gjyqtarët dhe prokurorët e integruar.

Programin trajnues hyrës për gjyqtarët dhe prokurorët e shtetit në vete ka përfshirë 14 ditë trajnimi nga të cilat janë realizuar 11 ditë, ndërsa trajnimi i fundit 3 ditë do të organizohet gjatë vitit 2018.

Përfitues të këtij programi trajnues hyrës kanë qenë: 40 gjyqtarë, 13 prokurorë dhe 2 bashkëpunëtorë profesional.



Grafikoni nr. 20: Numri i pjesëmarrjes në Programin Trajnues Hyrës për gjyqtarët dhe prokurorët e shtetit të integruar

6.2 Programi i Trajnimit Fillestar

Bazuar në Ligjin për Akademinë e Drejtësisë¹, Akademia organizon trajnimin fillestar për aftësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të shtetit të sapo emëruar. Qëllimi kryesor i Programit të Trajnimit Fillestar (PTF), është përgatitja profesionale e interdisiplinare dhe zhvillimi i shkathtësive praktike të gjyqtarëve dhe prokurorëve të shtetit të sapoemëruar.


¹ Neni 19 Ligjit Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë

Trajnimi fillestar zgjatë dymbëdhjetë (12) muaj dhe organizohet i ndarë në dy pjesë. Pjesa teorike realizohet nëpërmjet diskutimeve të kombinuara me shqyrtime të rasteve nga praktika gjyqësore, simulime të gjykimeve dhe forma tjera, ndërsa pjesa praktike realizohet në gjykata dhe prokurori ku ata janë të emëruar nën mbikëqyrjen e mentorit gjyqtarë apo prokurorë. Në kuadër të pjesës praktike përfituesit e këtij programi realizojnë edhe trajnime dhe vizita në institucione jo gjyqësore që lidhen me punën e gjykatave dhe prokurorie të shtetit.

Programi i trajnimit fillestar për gjyqtarët/prokurorët e shtetit të sapoemëruar miratohet nga Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë.

6.2.1 Aktivitetet e realizuara në kuadër të PTF-së për vitin 2017

Gjatë viti 2017 në Akademinë e Drejtësisë, trajnimin fillestar e kanë ndjekur gjenerata e gjashtë e gjyqtarëve dhe prokurorëve të shtetit të sapo emëruar. Trajnimi është realizuar ndaras për gjyqtarët dhe prokurorët e shtetit. Përfitues të këtij trajnimi ishin gjashtëmbëdhjetë (16) prokurorë të shtetit prej tyre pesë (5) femra dhe njëmbëdhjetë (11) meshkuj dhe dyzet e nëntë (49) gjyqtarë të sapo emëruar, prej tyre janë njëmbëdhjetë (11) femra dhe tridhjetë e tetë (38) meshkuj.



6.2.2 Trajnimi fillestar për prokurorët e sapoemëruar

Trajnimi fillestar për prokurorët e sapoemëruar në gjeneratën e gjashtë (6) ka filluar me datë 09 dhjetor të vitit 2016. Ky program është fokusuar në zhvillimin e kompetencave profesionale, vlerave etike dhe ndër personale të prokurorëve të shtetit të sapo emëruar, me theks **të veçantë në: ngritjen e kapaciteteve profesionale për legjislacionin vendor dhe ndërkombëtarë, hartimin e vendimeve gjyqësore bazuar në analizë të fakteve, aplikimin e rregullave etike, zhvillimin e shkathtësive gjyqësore dhe sociale, shkëmbimin e praktikave në institucionet e ndërlidhura me punën e gjykatave dhe prokurorive, zhvillimin e kapaciteteve hulumtuese, organizative dhe menaxhuese si dhe zhvillimin e shkathtësive inerdisciplinare.**

6.2.2.1 Trajnimi teorik

Sipas programit trajnues gjatë trajnimit teorik prokurorët e shtetit të sapoemëruar kanë ndjekur 6 module trajnuese (të cilat përbëhen nga gjithsejtë 45 nën module)²:

- Kodi Penal i Republikës së Kosovës;
- Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës;
- Rendi juridik kombëtarë dhe ndërkombëtarë;
- Shkathtësitë personale dhe ndër-personale;
- Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese; si dhe
- Mësimi në Distançë;

Gjatë viti 2017 në programin e trajnimit fillestar për prokurorët e sapo emëruar janë realizuar në total 243 ditë trajnimi³. Në kuadër të trajnimit teorik janë realizuar 99 ditë trajnimi, respektivisht 163 sesione trajnuese apo 504 orë trajnimi.

Kodi Penal i Republikës së Kosovës – në kuadër të këtij moduli janë realizuar 19 sesione trajnuese apo 78 orë trajnimi duke trajtuar në veçanti pjesën e përgjithshme dhe pjesën e veçantë, veprat penale të korrupsionit zyrtar dhe detyrës zyrtare, krimet e rënda dhe parashkrimi.

Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës – nga ky modul janë realizuar 91 sesione trajnuese apo 273 orë trajnimi. Në këtë modul janë trajtuar: masat e fshehta të hetimit dhe vëzhgimit, ekspertiza dhe analizat, vendi i ngjarjes dhe forenzika, kontrolli dhe konfiskimi, masat për sigurimin e të pandehurit në procedurë, i pandehuri në procedurën penale, dëshmitarët dhe të dëmtuarit, procesverbalet, negocimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë, shmangia nga ndjekja penale, administrimi i procedurës penale, shqyrtimi fillestar i dytë dhe shqyrtimi gjyqësor, marrja dhe komunikimi i vendimeve dhe dërgimi i shkresave, shpenzimet e procedurës penale dhe kërkesa pasurore juridike, ushtrimi i mjeteve juridike, procedurat e veçanta sipas KPPK, fillimi i hetimeve formale, kallëzimi penal, roli i prokurorit në shqyrtimin gjyqësor, aktakuza, procedura e shqyrtimit, provat në procedurën penale dhe vija ndarëse në mes veprave penale dhe kundërvajtjeve.

Rendi juridik kombëtarë dhe ndërkombëtarë – në kuadër të këtij moduli janë realizuar 19 sesione apo 57 orë trajnimi. Në këtë modul janë trajtuar: e drejta kushtetuese, organizimi i sistemit gjyqësor dhe prokurorial, bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështje penale, e drejta e Bashkimit Evropian dhe legjislacioni për të drejtat e njeriut.

Shkathtësitë personale dhe ndër-personale – nga ky modul janë realizuara njëzet e gjashtë (26) sesione apo 78 orë trajnim dhe në kuadër të tyre janë trajtuar: rregullat e komunikimit, etika profesionale, menaxhimi i rasteve, ngritja dhe shkathtësive sociale të prokurorëve, arsyetimi i vendimeve (akteve akuzuese/ankesave), dhe menaxhimi i stresit.

Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese – nga ky modul janë realizuar gjashtë (6) sesione apo 18 orë trajnimi. Në kuadër të këtij moduli janë trajtuar: Kodi i Drejtësisë për të Mitur, ndërmjetësimi dhe hetimi i krimeve ndërkufitare. Po ashtu janë realizuar dhjetë (10) ditë trajnimi praktik nga lidhur me

² Programi i Trajnimit Fillestar për prokurorët e sapo emëruar 2016-2017

³ Trajnim Fillestar për prokurorët e sapoemëruar ka përfunduar me dt. 05 janar 2018

modulin “Zhvillimi i shkathtësive gjyqësore”, qëllimi i të cilit qëndron në ngritjen e shkathtësive gjyqësore për fjalën hyrëse, marrjen e drejtpërdrejtë dhe të tërthorët në pyetje, vënien në dyshim, rehabilitimin dhe fjalën përfundimtare. Në kuadër të këtij moduli prokurorët e sapo emëruar kanë realizuar edhe një simulim gjykimi me qëllim të ngritjes së aftësive dhe shkathtësive në të shprehur, rritjen e vetëbesimit, zhvillimi i mendimit kritik si dhe aftësia për të punuar në ekip.

Trajnimi teorik është realizuar dy ditë të javës dhe metodologjia e trajnimeve ka qenë e ndryshme, duke përfshirë prezantimet e trajnuesve, diskutime interaktive, ushtrime praktike, studim i rasteve, punë në grupe, përdorim i videove të shkurtra etj.

Në realizimin e pjesës teorike të programit fillestar për prokurorët e sapoemëruar janë angazhuar tridhjetë e tetë (38) trajnues.

Mësimin në distancë - në programin e trajnimit përveç moduleve të rregullta, kanë qenë të planifikuara të zhvillohen edhe trajnimet në platformën e mësimin në distancë (e- learning).


Gjatë vitit 2017 janë realizuar tre (3) module në këtë platformë:

- Teknologjia informative,
- Gjuha angleze dhe
- Menaxhimi i stresit.

Prokurorët e sapo emëruar janë njoftuar me mënyrën e qasjes në kurset trajnuese, orientimi në platformë për kurse përkatëse, komunikimi përmes forumit dhe mundësi të tjera që ofron kjo platformë.

6.2.2.2 Trajnimi praktik

Trajnimi praktikë është zhvilluar në prokurori nën mbikëqyrjen e mentorit (prokuror i shtetit), i cili është mbikëqyrës për zbatimin e programit trajnues si dhe vlerësimin e performances gjatë kësaj pjese të trajnimit. Në viti 2017 në programin e trajnimit fillestar për prokurorët shtetit, në kuadër të trajnimit praktikë janë realizuar 126 ditë trajnimi⁴. Në realizimin e pjesës praktike të programit fillestar për prokurorët e sapo emëruar janë angazhuar pesëmbëdhjetë (15) mentorë.



Grafikoni nr.22

⁴ Trajnimi fillestar për prokurorët e sapo emëruar ka përfunduar me dt. 5 janar 2018 dhe tri ditë të trajnimit praktikë janë realizuar në vitin 2018

6.2.2.3 Trajnim në institucionet jo gjyqësore

Krahas trajnimit praktikë nëpër prokurori, prokurorët e shtetit kanë ndjekur edhe trajnime në institucione të ndryshme të sistemit të drejtësisë dhe jashtë tij, puna e të cilave është ndërlidhur me punën e gjykatave dhe prokurorive. Gjatë vitit 2017, prokurorët e shtetit kanë realizuar 18 trajnime në institucionet si në vijim:

- Gjykata Kushtetuese
- Oda e Avokatëve
- Avokati i Popullit
- Policia e Kosovës
- Shërbimi Korrektues
- Shërbimi Sporvues
- Qendra për Punë Sociale
- Agjencia Kundër Korrupsionit
- Dogana e Kosovës
- Komisioni i Ndërmjetësimit
- Agjencia Kosovare e Privatizimit
- Agjencia Kadastrale e Kosovës
- Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
- Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil
- Zyra e Auditorit Gjeneral;
- Administrata Tatimore e Kosovës;
- Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale; dhe
- Instituti i Mjekësisë Ligjore;

Në këto institucione prokurorët e sapoemëruar janë njoftuar lidhur me rolin, strukturën organizative, kompetencat, legjislacionin, bashkëpunimin me institucione tjera dinamikën e punës, sfidat me të cilat ballafaqohen si dhe fushat e interesit të përbashkët, në veçanti.

6.2.2.4 Hartimi dhe organizimi i testit përfundimtar për prokurorët e sapoemëruar

Akademia e Drejtësisë ka realizuar një (1) punëtori për hartimin e testit përfundimtar, për prokurorët e sapoemëruar. Punimet në kuadër të kësaj punëtorie u fokusuan në hartimin e pyetjeve dhe rasteve praktike për testin përfundimtar, duke u bazuar në strukturën e testit, të cilën e përcakton Rregullorja për Trajnimin Fillestar. Grupi punues për hartim të testit përfundimtar, është përbërë nga trajnues të Akademisë, të cilët kanë qenë të përfshirë në realizimin e moduleve respektive.

Ndërsa me dt. 20-22 dhjetor 2017, është organizuar testi përfundimtar për prokurorët e sapoemëruar, gjenerata e gjashtë e PTF-së si dhe vlerësimi i testit është bërë brenda afatit të përcaktuar me Rregullore për Trajnimin Fillestar.

6.2.3 Trajnimi fillestar për gjyqtarët e sapoemëruar

Më 29 shtator 2017, Akademia e Drejtësisë, zyrtarisht ka filluar Programin e Trajnimit Fillestar, për gjyqtarët e sapoemëruar, duke realizuar takimin e parë me gjyqtarët e sapoemëruar. Fillimisht, gjyqtarët e sapoemëruar, u njoftuan me rolin dhe rëndësinë që ka trajnimi fillestar, për ngritjen e shkathtësive profesionale dhe praktike me qëllim të përgatitjes së tyre adekuate për të ushtruar funksionin e gjyqtarit. Po ashtu në këtë takim u elaborua struktura e PTF-së, mënyra e organizimit dhe realizimit të tij, si të pjesës teorike, po ashtu edhe pjesës praktike, si dhe çështje tjera që ndërlidhen me këtë program.

6.2.3.1 Trajnimi teorik

Trajnimi teorik zhvillohet në mënyrë teorike i kombinuar me raste praktike nga praktika gjyqësore, bazuar në module trajnuese, ku përfshihen trajnime nga të gjitha degët e së drejtës dhe ligjeve pozitive, Konventa Evropiane për të Drejta të Njeriut dhe akteve të tjera ndërkombëtare.

Gjyqtarët e sapo emëruar gjatë programit kanë ndjekur shtatë (7) module trajnuese të përbëra nga 50 nën module, dhe trajnimi është realizuar në dy ditë të javës sipas moduleve trajnuese si në vijim:

- Kodi Penal i Republikës së Kosovës;
- Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës;
- E drejta civile, administrative dhe ekonomike;
- Rendi juridikë kombëtar dhe ndërkombëtar;
- Shkathtësitë personale dhe ndër-personale;
- Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese; si dhe
- Mësimi në distancë;


Gjatë viti 2017, gjyqtarët e sapo emëruar kanë ndjekur 13 nën module në 27 ditë trajnimi apo 54 sesione trajnuese dhe 162 orë trajnimi. Në periudhën raportuese janë realizuar këto nën - module:

- Kodi Penal i Kosovës- pjesa e përgjithshme dhe e veçantë,
- Veprat penale të korrupsionit zyrtar dhe kundër detyrës zyrtare,
- Negocimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë,
- I pandehuri në procedurën penale,
- Dëshmitarët dhe të dëmtuarit në procedurën penale,
- Masat për sigurimin e të pandehurit në procedurën penale,
- Masat e fshehta të hetimit dhe vëzhgimit,
- Ekspertiza dhe analizat; dhe
- Kontrolli dhe konfiskimi;

Në realizimin e këtyre nën moduleve në periudhën raportuese janë angazhuar dymbëdhjetë (12) trajnues.

6.2.3.2 Trajnimi praktik

Në vitin 2017, në kuadër të trajnimit praktik janë realizuar 33 ditë trajnimi. Trajnimi praktikë është zhvilluar në gjykata dhe është realizuar nën mbikëqyrjen e mentorit (gjyqtarë), i cili ka qenë mbikëqyrës për zbatimin e programit trajnues si dhe vlerësimin e performances gjatë kësaj pjese të trajnimit. Në periudhën raportuese në realizimin e pjesës praktike të trajnimit kanë qenë të angazhuar njëzet e tre (23) mentorë.



Grafikoni nr.23

6.2.3.3 Trajnimi në institucionet jo gjyqësore

Trajnimet praktike në institucionet jo gjyqësore⁵, kanë për qëllim t’iu ofrojnë gjyqtarëve të sapoemëruar njohuri lidhur me legjislacionin dhe praktikat që zbatohen në institucionet gjatë punës së tyre, gjithashtu t’iu ofrojnë njohuri për punën dhe aktivitete që kryejnë këto institucione, funksionet e të cilëve janë të ndërlidhura me punën e gjyqtarit.

Nga gjithsej 18 institucione sa janë paraparë me programin trajnues, gjyqtarët e sapoemëruar gjatë vitit 2017 kanë realizuar 4 ditë trajnimi. Institucionet në të cilat gjyqtarët e sapo emëruar kanë realizuar janë: Policia e Kosovës, Dogana e Kosovës, Gjykata Kushtetuese dhe Institucioni i Avokatit të Popullit. Në këto institucione gjyqtarët janë informuar për rolin, strukturën organizative, dinamikën e punës dhe sfidat me të cilat ballafaqohen.

6.2.3.4 Trajnimi i mentorëve në trajnimin fillestar për gjyqtarët e sapoemëruar

Akademia e Drejtësisë, para fillimit të trajnimit për gjyqtarët e sapo emëruar në bashkëpunim me Projektin e Binjakëzimit “Mbështetje e mëtejme reformës për arsimim ligjor”, i financuar nga

⁵ Program trajnim në institucionet jo gjyqësore – Programi i Trajnimit Fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar 2017 -2018

BE ka realizuar një (1) trajnim për mentorët, e fushës penale, të cilët janë përcaktuar si mentorë për gjyqtarët e sapoemëruar. Trajnimi kishte për qëllim që mentorët të familjarizohen me metodat dhe teknikat e mentorimit, rolin dhe detyrat e tyre si mentorë, si dhe format adekuate të qasjes së tyre në raport me gjyqtarët e sapoemëruar.

6.3 Programi për Hulumtime dhe Publikime (PHP)

Komponentë e rëndësishme për zhvillimin profesional të profesionistëve të sistemit gjyqësor dhe prokurorial është veprimtaria kërkimore dhe botuese⁶ e Akademisë në fushën juridike e cila realizohet përmes Programit për Hulumtime dhe Publikime.

Ky program ka për qëllim që përfituesve të Akademisë t'u ofrojë mbështetje praktike dhe teknike për hulumtime, analiza, publikime dhe qasje në burime të ndryshme ligjore.

6.3.1 Objektivat PHP-së

Objektivë e përgjithshme e PHP-së është që të mbështesë përfituesit e Akademisë nëpërmjet burimeve ligjore, punës hulumtuese si dhe pasurimin e cilësisë së mendimit juridik përmes:

- Identifikimit të nevojave për hulumtime profesionale në zhvillim të gjyqësisë;
- Zhvillimit të veprimtarisë kërkimore dhe publikimit në revistat e Akademisë dhe në forma tjera;
- Krijimit të raporteve strategjike me subjektet kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare që ndajnë funksionet, qëllimet dhe objektivat e përbashkëta;
- Përfshirjes së ekspertëve, veçanërisht gjyqtarëve dhe prokurorëve në hulumtime ligjore varësisht prej nevojave të sistemit gjyqësor dhe prokurorial;
- Përmbledhjes dhe publikimit të dokumenteve të rëndësishme të cilat pasqyrojnë punën e Akademisë;
- Ofrimit të burimeve ligjore përmes bibliotekës fizike dhe elektronike për përfituesit e Akademisë;

6.3.2 Aktivitetet në PHP

Gjatë vitit 2017 në kuadër të PHP-së janë zhvilluar aktivitete që kryesisht kanë qenë të orientuara në drejtim të:

- Veprimtarive kërkimore dhe botuese për nevojat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial;
- Hulumtimeve dhe analizave për vlerësimin e nevojave të gjyqtarëve dhe prokurorëve për trajnime si dhe për zhvillimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve trajnuese për vitin 2018;
- Veprimtarisë botuese;
- Menaxhimit dhe përditësimit të koleksioneve të bibliotekës;
- Abonimit në data baza ligjore elektronike;

⁶ Ligji Nr.05/L për Akademinë e Drejtësisë, neni 6, par. 1.7 dhe 1.8

6.3.3 Veprimtaria kërkimore

Gjatë vitit 2017, Akademia e Drejtësisë ka realizuar hulumtimin lidhur me praktikën e Gjykatës së Apelit. Ky hulumtim është realizuar për shkak të numrit të madh të lëndëve të cilat kthehen në rigjykim në gjykatat e shkallës së parë, konkretisht të departamentit të Përgjithshëm - divizionit civil, Departamentit për Çështje Ekonomike si dhe Departamentit për Çështje Administrative.

Hulumtimi është fokusuar në identifikimin e shkaqeve dhe problemeve më të shpeshta në praktikë, të cilat po i përcjellin gjykatat e shkallës së parë. Në këtë proces janë angazhuar një grup i gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit, të cilët përveç punës individuale të hulumtimit të praktikës së Gjykatës së Apelit të secilit nga këta gjyqtarë, janë diskutuar në hollësi të gjeturat nga hulumtimi në dy tryeza të realizuara nga Akademia e Drejtësisë në mbështetje të UNDP-së. Rezultatet nga hulumtimit me udhëzimet adekuate se si duhet vepruar për t'iu shmangur trendit të lëndëve që kthehen në rigjykim, do të publikohen në vitin 2018 në një përmbledhje e cila do të shërbejë si udhërrëfyes për gjyqtarët e shkallës së parë për të zvogëluar trendin e lëndëve që kthehen në rigjykim.

6.3.4 Hulumtime dhe analiza për vlerësimin e nevojave për trajnime të gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe për zhvillimin e programeve trajnuese për vitin 2018

Në kuadër të PHP-së në dobi të zhvillimit dhe hartimit të Programit të Trajnimeve të Vazhdueshme për vitin 2018, janë bërë analiza dhe hulumtime gjatë procesit të vlerësimit të nevojave trajnuese.

Në këtë drejtim janë shqyrtuar dhe analizuar dokumente të ndryshme si formularët pas çdo sesioni trajnues gjatë vitit 2017, pyetësorët e plotësuar nga ana e gjyqtarëve dhe prokurorëve, raportet e punës së gjykatave dhe prokurorive, raportet e KGJK-së dhe KPK-së, raportet e institucioneve ndërkombëtare për sistemin gjyqësor, dokumentet strategjike që kanë të bëjnë me sistemin e drejtësisë duke përfshirë edhe analiza dhe hulumtime të programeve të institucioneve trajnuese regjionale dhe ndërkombëtare. Në këtë proces është përfshirë edhe monitorimi i mediave të shkruara dhe elektronike.

Të gjeturat së bashku me rekomandimet e dala si rezultat i analizës së këtyre burimeve i kanë shërbyer hartimit të kurrikulës trajnuese për vitin 2018.

6.3.5 Veprimtaria botuese


Në drejtim të përmbushjes së mandatit të Akademisë në fushën e botimeve, PHP është angazhuar drejtpërdrejtë në procesin e nxjerrjes së publikimeve, si dhe në procesin e shpërndarjes së tyre, duke përgatitur plane të shpërndarjes për secilin publikim, si dhe duke e monitoruar këtë proces. Kontributi i PHP-së në këto publikime ka qenë edhe në përcaktimin e dizajnit, kontrollimit të përmbajtjes si dhe monitorimit të procesit të shtypjes. Kjo komponentë veçanërisht publikimet që kanë karakter udhëzues për gjyqtarët dhe prokurorët është mbështetur edhe nga donatorë si GIZ dhe Programi për fuqizimin e Sektorit të Drejtësisë në Kosovë (JSSP) të USAID-it.

Gjatë vitit 2017, Akademia e Drejtësisë ka realizuar publikimet si më poshtë:

- Format e shkresave në procedurën penale;
- Doracaku për shkrimin dhe arsyetimin ligjor;
- Modulet trajnuese për trajnimin fillestar:
 - Kodi Penal i Kosovës,
 - Kodi i Procedurës Penale,
 - Legjislacioni dhe Shkathtësitë plotësuese,
 - Rendi Juridik Kombëtar dhe Ndërkombëtar,
 - Shkathtësitë personale dhe ndër personale si dhe
 - E drejta civile, administrative dhe ekonomike
- Ribotimi i përmbledhjes Marrëveshjet dhe instrumentet ligjore ndërkombëtare
- Buletini mujor;
- Programi Trajnues për vitin 2018;

Disa nga publikimet si “Justicia” për prokurorët e sapo emëruar si dhe “Praktika e Gjykatës së Apelit e fokusuar në lëndët që kthehen në rigjykim” të cilat janë zhvilluar gjatë vitit 2017, do të publikohen në vitin në vijim duke qenë se procesi për zhvillimin e tyre ka marrë kohë të gjatë për shkak të rrethanave dhe vëllimit të punës për këto botime.

Në vijim grafikoni që pasqyron publikimet e Akademisë së Drejtësisë për vitin 2017:



Grafikoni nr.24 Publikimet e Akademisë gjatë vitit 2017


6.3.6 Menaxhimi dhe përditësimi i koleksioneve të bibliotekës fizike dhe elektronike të Akademisë së Drejtësisë

Biblioteka e Akademisë, shërben si një burim kryesor i materialit hulumtues ligjor në mbështetje të gjyqësorit të Kosovës. Në funksion të kësaj, është vazhduar me përditësimin e koleksioneve të bibliotekës ligjore dhe ofrimit të titujve me interes sipas kërkesave të përfituesve të Akademisë.

Shfrytëzues të bibliotekës fizike janë gjyqtarët, prokurorët, stafi administrativ gjyqësor dhe prokurorial, profesionist tjerë, trajneus dhe stafi i Akademisë. Bazuar në evidencat e regjistrimit kryesisht më të shpeshtë janë gjyqtarët dhe prokurorët e sapo emëruar të cilët ndjekin Programin e Trajnimit Fillestar, ndërkaq më të kërkuara dhe të shfrytëzuara janë librat akademikë si të autorëve vendor ashtu edhe atyre ndërkombëtarë. Sipas të dhënave numri i shfrytëzuesve të bibliotekës elektronike është më i madhe se sa i asaj fizike, trend ky që e ka përfshirë edhe këtë komunitet.

Në kuadrin e aktiviteteve të bibliotekës është vazhduar me katalogimin e materialeve të reja ligjore në dy platformat përmes të cilave operon biblioteka e Akademisë. Materialet e reja ligjore përfshirë doracakë, materiale të kurseve trajnuese si dhe burime tjera juridike janë regjistruar sipas fushave dhe standardeve të klasifikimit dhe katalogimit.

Nga viti në vit numri i shfrytëzuesve të bibliotekës elektronike të Akademisë është duke u rritur. Sipas veglës Google Analytics që mund të gjeneroj të dhënat në vitin 2016 kanë qenë 1870 shfrytëzues ndërkaq në vitin 2017 është 6767. Për më shumë detaje gjenden në grafikoni në vijim i cili pasqyron numrin e sesioneve, numrin e përdoruesve, faqeve të vizituara, kohëzgjatjen e frekuentimit, përqindjen e sesioneve të reja, vizitorët e rinj si dhe vizitorët e kthyer.



Grafikoni nr.25. Të dhënat rreth qasjes në bibliotekën elektronike

6.3.7 Qasja në burime ligjore në data bazat ndërkombëtare

Nga Projekti “Mbështetje e Mëtejme në Reformën e Edukimit Ligjor në Kosovë” financuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, Akademia e Drejtësisë ka përfituar abonim në data baza ligjore shumë të rëndësishme ndërkombëtare siç janë: Hein Online, Autoritetet shkencore të Oxfordit për të drejtën ndërkombëtare si dhe Enciklopedia e Max Planck për të Drejtën Publike Ndërkombëtare, të cilat kanë vazhduar edhe këtë vit. Këto data baza kanë qenë të qasshme për përfituesit e Akademisë duke iu ofruar një mundësi më shumë për burime ligjore.

Përveç këtyre data bazave ligjore, Akademia e Drejtësisë përmes vazhdimit të anëtarësimit në ABEK (Asociacioni i Bibliotekave Elektronike të Kosovës) ka siguruar qasje edhe në data baza tjera që konzorciumi i EIFL-s i siguron për vendet në tranzicion. Qasja në këto data baza ndryshon nga viti në vit. Prandaj gjatë këtij viti kemi qenë të abonuar në këto data baza:


- Publikimet Edward Elgar
- Revistat online të Cambridge
- Fjalori i Oksfordit për Gjuhë Angleze Online
- Oxford Reference Online
- E Biblioteka e Fondit Monetar Ndërkombëtar

6.4 Mësimi në distancë

Akademia e Drejtësisë tashmë ka në funksion platformën e mësimi në distancë (e-learning), e cila përmes moduleve të zhvilluara përmbushë kërkesat dhe nevojat për trajnime për gjyqtarë, prokurorë dhe për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2017, pjesëmarrësit kanë ndjekur trajnimet online në kurset trajnuese si më poshtë:

- Drejtësia për fëmijë (aspekti civil dhe penal) për gjyqtarë dhe prokurorë;
- Ndërmjetësimi aspekti civil dhe penal;
- Anglishtja ligjore për prokurorët e sapoemëruar;
- Teknologjia Informative për prokurorët e sapoemëruar;
- Menaxhimi i stresit për prokurorët e sapoemëruar;
- Teknologjia Informative për personelin administrativ gjyqësor dhe prokurorial;




Grafikoni nr. 26: Numri i kurseve trajnuese dhe pjesëmarrjes në platformën e mësimi në distancë

6.5 Trajnimet për Trajnues

Akademia e Drejtësisë në kuadër të punës së saj, organizon edhe Trajnimet për Trajnues. Realizimi i këtyre trajnimeve kishte për synim avancimin e metodologjisë trajnuese për realizimin e programit të trajnimeve duke zbatuar metodologjinë bashkëkohore të trajnimeve gjyqësore.

Gjatë vitit 2017 janë realizuar këto trajnime për trajnues:

- Didaktika gjyqësore;
- Neni 10 i KEDNJ - liria e shprehjes;
- Avancimi i metodologjisë së trajnimit;



Grafikoni nr. 27: Numri i Trajnimeve për Trajnues të realizuar gjatë 2017

6.6 Trajnimet për menaxhmentin, stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe për gjyqtarë porotë

6.6.1 Trajnimet për menaxhmentin e gjykatave dhe prokurorive

Pjesë e Programit të Trajnimeve të Akademisë së Drejtësisë janë edhe trajnimet për menaxhmentin e gjykatave dhe prokurorive.

Gjatë periudhës raportuese, Akademia e Drejtësisë ka realizuar një (1) trajnim për kryetarët e gjykatave dhe kryeprokurorët e prokurorive me temë: Menaxhimi i gjykatave dhe prokurorive - Sfidat praktike dhe zhvillimi i kurrikulës.

Synimi i këtij trajnimi ishte ofrimi i mundësisë së kryetarëve të gjykatave dhe kryeprokurorëve të, të sapoemëruar si dhe atyre të ri-emëruar të diskutojnë çështjet e menaxhimit të gjykatave dhe prokurorive nga pikëpamja e praktikuesve të ligjit.

6.6.2 Trajnimi për gjyqtarë porotë

Akademia e Drejtësisë ka organizuar trajnime edhe për gjyqtarë porotë. Gjatë vitit 2017 është organizuar një (1) trajnim me temë: Roli dhe detyrat e gjyqtarit porotë në procedurë gjyqësore.


Qëllimi kryesor i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve porotë lidhur me procedurën gjyqësore ndaj të miturve, procedurën në çështjet statusore si dhe për çështjet etike të gjyqtarëve porotë.

6.6.3 Trajnimi për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial

Akademia e Drejtësisë, në mandatin e saj ka edhe organizimin e trajnimeve për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial.

Gjatë vitit 2017, Akademia e Drejtësisë për këtë kategori përfituese, ka realizuar njëmbëdhjetë (11) aktivitete trajnuese që kanë të bëjnë me: zhvillimin e kapaciteteve të stafit të sistemit prokurorial të Kosovës, shkrimin dhe arsyetimin ligjor, avancimin e performancës në administrimin e sistemit prokurorial, kursi hyrës – moduli 1, kursi hyrës – moduli 2, menaxhimin e administratës së gjykatave dhe prokurorive, tryezë pune për hartimin e programit trajnues për stafin administrativ, menaxhimin e rrjedhës së rasteve, menaxhimin e kohës dhe stresit, etikën dhe sjelljen profesionale, hartimin ligjor për zyrtarët ligjor dhe bashkëpunëtorët profesional.

Synimi kryesor i këtyre trajnimeve ishte ngritja e njohurive dhe aftësive profesionale dhe praktike të stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial, në përmirësimin e organizimit të brendshëm dhe funksionimin e gjykatave dhe prokurorive, rritja e cilësisë së punës përmes hartimit dhe arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si dhe rritjen e aftësive dhe kapaciteteve profesionale të kategorive të ndryshme të stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial në nxitjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara nga kjo kategori.



Grafikoni nr. 28: Numri i aktiviteteve të realizuara për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial

6.7 Punëtori, tryeza pune, konferenca dhe aktivitete tjera

6.7.1 Punëtori për hartimin e akteve normative të Akademisë

Gjatë vitit 2017 Akademia e Drejtësisë ka realizuar tri (3) punëtori për hartimin e akteve normative që dalin si rezultat i hyrjes në fuqi të Ligjit për Akademinë e Drejtësisë. Me rastin e këtyre punëtorive Komisioni për Çështje Normative i themeluar nga Këshilli Drejtues i Akademisë, së bashku me grupin punues nga stafi i Akademisë kanë finalizuar aktet si në vijim:

- Rregulloren për Punën e Këshillit Drejtues të Akademisë;
- Rregullore për procedurën e Emërimit dhe Shkarkimit të Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullore për Punën e Këshillit Programor të Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullore për Tarifat e Trajnimeve për Avokat Shtetëror, Avokatë dhe Profesionet e Tjera të Lira;
- Rregullore për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullore për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 03/2017 për Trajnimin Fillestar;
- Rregullore për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 06/2017 për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullore për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Akademinë e Drejtësisë.

6.7.2 Punëtori me trajnuesit e Akademisë për hartimin programit të trajnimeve për vitin 2018

Gjatë vitit 2017 është realizuar një punëtori për hartimin e Programit Trajnues për vitin 2018.

Në këtë punëtori, e cila është realizuar në mbështetje të GIZ-it, është bërë përcaktimi i temave që mund të jenë pjesë e programit trajnues të Akademisë së për vitin 2018, duke u bazuar në procesin e vlerësimit të nevojave për trajnime.

Në punëtori janë përzgjedhur temat që do të jenë pjesë e Programit Trajnues për vitin 2018 si dhe është hartuar koncepti i trajnimit për secilën temë të propozuar si dhe është hartuar draft Programi Trajnues. Gjatë punëtorisë trajnuesit fillimisht kanë analizuar propozimet e dala nga zhvillimi i mekanizmave për vlerësimin e nevojave trajnuese, më tej, janë përcaktuar temat me prioritet që duhet të trajtohen gjatë vitit 2018.

6.7.3 Punëtori me trajnuesit e Akademisë për hartimin e programit trajnues për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial

Akademia e Drejtësisë gjatë vitit 2017 në bashkëpunim me GIZ realizoi një punëtori për hartimin e programit trajnues për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive. Kontribut të veçantë në këtë punëtori kishte edhe bashkëpunimi i ndërsjellë i Akademisë me Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial. Qëllimi i kësaj punëtorie ishte përcaktimi i strukturës së moduleve të propozuara që të jenë pjesë e programit trajnues për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial

gjatë vitit 2018, si dhe hartimi i koncept dokumenteve të këtyre moduleve trajnuese, të cilat kanë dal si rezultat i procesit të vlerësimit të nevojave, i realizuar nga Projekti i Binjakëzimit i cili mbështet Akademinë e Drejtësisë.

Bazuar në strukturën e përcaktuar për programin trajnues është hartuar koncepti i secilit modul dhe nën modul, ku përfshihen: qëllimi i trajnimit, evidentohen dilemat dhe përshkruhet qasja në adresimin e këtyre dilemave gjatë trajnimit, gjithashtu koncepti përmban edhe objektivat e trajnimit, përmbajtjen, metodologjinë për realizimin e trajnimit, përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit.

6.7.4 Punëtori për Hartimin e Planit të Punës për vitin 2018

Gjatë vitit 2017, Akademia ka realizuar një punëtori për hartimin e Planit të Punës për vitin 2018. Në fokus të kësaj punëtorie ishte hartimi i Planit Vjetor të Punës për vitin 2018, diskutimi i nevojave të Akademisë për një Plan Strategjik si dhe për Rregulloren për Trajnime me fokus te trajnimet e detyrueshme të miratuar nga KGJK. Pas analizimit dhe diskutimeve të shumta, grupi punues ka përcaktuar strukturën dhe objektivat e secilit program trajnues, prioritetet për periudhën një (1) vjeçare dhe ka përgatitur planin e punës.

6.7.5 Punëtori për zhvillimin e kapaciteteve të stafit të sistemit prokurorial të Kosovës

Akademia e Drejtësisë gjatë vitit 2017 ka realizuar punëtorinë me temë “Zhvillimi i kapaciteteve të stafit të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës”, me qëllim që pjesëmarrësit ti avancojnë njohuritë rreth zhvillimit të resurseve për komunikim me publikun, hartimit të akteve të ndryshme ligjore dhe sigurimit të qasjes dhe standardeve të unifikuara për hartimin e të gjitha llojeve të akteve si dhe identifikimi i nevojave për përfitimin e projekteve nga fondet e IPA-së 2018-2020.

Në këtë punëtori u trajtuan tema të rëndësishme për funksionimin e sistemit prokurorial të Kosovës si: roli i Sekretariatit të KPK-së në efikasitetin e sistemit prokurorial, planifikimi i detyrave të punës për vitin 2017 në frymën e planeve të KPK-së, Rregullores së SKPK-së dhe detyrave të punës, transparenca, dizajni dhe përmbajtja e faqes zyrtare të KPK-së si dhe platformave tjera të mundshme.

6.7.6 Punëtori “Dialogu institucional në mes të KGJK-së, KPK-së, dhe ADK-së për çështje të interesit të përbashkët”

Akademia e Drejtësisë, Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës, kanë mbajtur një punëtori të përbashkët të organizuar me mbështetjen e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në Kosovë - UNDP.

Qëllimi kryesor i kësaj punëtorie ishte bashkëpunimi ndërmjet institucioneve të sistemit gjyqësor në Kosovë duke ndarë përvojat e adresimit dhe menaxhimit të proceseve kryesore nëpër të cilat janë duke kaluar, si dhe për trajnimet në ngritjen e kapaciteteve të gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit administrativ të gjykatave dhe prokurorive, për të kryer me sukses dhe efikasitet punën e tyre. Në këtë punëtori si temë e rëndësishme e diskutimit ishte edhe zbatimi i Ligjit për Akademinë e Drejtësisë, ndryshimet që ka sjell ky ligj, funksionet dhe kompetencat e Akademisë së Drejtësisë.

6.7.7 Punëtorja “Nga Instituti Gjyqësor në Akademinë e Drejtësisë – Planifikimi strategjik për arsimin ligjor të gjyqësorit të Kosovës”

Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me projektin e Binjakëzimit “Mbështetje e mëtutjeshme e reformës për arsimim ligjor” i financuar nga BE, ka realizuar një punëtorë me temë “Nga Instituti Gjyqësor në Akademinë e Drejtësisë – Planifikimi strategjik për arsimin ligjor të gjyqësorit të Kosovës”. Qëllimi i kësaj punëtorie ishte diskutimi i planifikimit strategjik për arsimim ligjor të gjyqësorit të Kosovës nga Akademia e Drejtësisë. Në punëtorë nga ekspertët e këtij projekti janë diskutuar elementet thelbësore të strategjisë për trajnimin dhe arsimin ligjor nga perspektiva e vendeve të BE-së e po ashtu është analizuar dhe diskutuar trajnimi gjyqësor në Kosovë. Në këtë drejtim u prezantua koncepti i planit strategjik për arsimimin ligjor në Kosovë me ç’ rast janë pasqyruar vlerat, parimet dhe objektivat mbi të cilat duhet të udhëhiqet Akademia.

6.7.8 Punëtorja “Përgatitja dhe transformimi didaktik i lëndëve reale”

Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me projektin e Binjakëzimit “Mbështetje e mëtutjeshme e reformës për arsimim ligjor” ka realizuar punëtorinë me temë “Përgatitja dhe transformimi didaktik i lëndëve reale”. Qëllimi i realizimit të punëtorisë ishte përgatitja e një grupi të trajnuesve që do të përdoren për realizimin e aktiviteteve për trajnuesit e ardhshëm rreth përdorimit të metodave dhe teknikave më bashkëkohore të trajnimit. Gjatë punëtorisë rëndësi ju kushtua trajnimit të bazuar në kompetencë, zbatimit të metodologjisë bashkëkohore dhe përdorimit të teknikave më të avancuara gjatë trajnimit, strukturës dhe dizajnit të programit për Trajnimin e Trajnuesve, trajnimeve për mentorë, si dhe përgatitjes së materialeve trajnuese.

6.7.9 Punëtorja për zhvillimin e botimeve ligjore

Akademia e Drejtësisë në mbështetje të GIZ-it ka realizuar punëtorinë me temë “Zhvillimi i botimeve ligjore”. Qëllimi i kësaj punëtorie ishte fuqizimi dhe zhvillimi i veprimtarisë botuese të Akademisë së Drejtësisë me qëllim të dokumentimit të zhvillimeve aktuale ligjore, si dhe trajtimit të funksionit të publikimeve ligjore, procesit të botimeve, grupit të synuar si dhe çështjet rreth përmbajtjes, përzgjedhjes dhe redaktimit nga perspektiva gjermane.

Gjatë punëtorisë nga grupi i pjesëmarrësve u vu në pah mungesa e publikimeve vendore në fushën ligjore veçanërisht e publikimit të vendimeve gjyqësore. Kjo problematikë siç u tha mbetet për tu adresuar duke pasur parasysh interesin e profesionistëve ligjor për të pasur më shumë burime juridike dhe publikime në këtë fushë.

6.7.10 Aktivitete tjera realizuara në bashkëpunim me Projektin e Binjakëzimit

Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me projektin e Binjakëzimit “Mbështetje e mëtutjeshme e reformës për arsimim ligjor” i financuar nga BE, gjatë viti 2017 ka realizuar pesë (5) tryeza diskutimesh me temën “Trajnimi fillestar i bazuar në lëndë - Elaborimi i Doracakut për trajnim të bazuar në lëndë”. Qëllimi i këtyre tryezave ishte të sqaroj në mënyrë të hollësishme modelin didaktik për elaborimin e moduleve për trajnim duke u bazuar në të mësuarin efektiv me punë grupore përmes lëndëve reale. Në fokus të këtyre tryezave ishte mënyra e përzgjedhjes së lëndës praktike/reale, strukturimi i lëndës në module të ndryshme mësimore, gjetja e pyetjeve të rëndësishme dhe didaktika për përzgjedhjen nga të trajnuarit në secilin nivel, si dhe krijimi i

mundësisë së pjesëmarrësve në trajnim që të prezantojnë rezultatet.

6.8 Bashkëpunimi me donatorë

Akademia e Drejtësisë ka krijuar partneritet shumë të mirë me donatorë dhe projekte të cilat i ka realizuar për ngritjen e cilësisë, funksionalitetit, efikasitetit dhe profesionalizmit të sistemit gjyqësor. Pra, kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e aktiviteteve të Akademisë kanë edhe donatorët të cilët ofrojnë mbështetje në forma të ndryshme. Në këtë drejtim përveç punëtorive dhe tryezave të shumta, kanë ofruar mbështetje edhe për pjesëmarrje në konferenca dhe forume të ndryshme ndërkombëtare.

Në listën më poshtë, janë paraqitur donatorët dhe aktivitetet të cilat i kanë mbështetur secili projekt.

Nr.	
1	<p style="text-align: center;">GIZ</p> <p>Hetimi financiar Etika Profesionale dhe Deontologjia Sfidat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve Pronësia dhe mbrojtja e saj Vizita e juristëve gjerman në Akademinë e Drejtësisë Forumi i Katërt Rajonal mbi Shtetin e së Drejtës në Evropën Juglindore Barazia gjinore në procedurë gjyqësore dhe nxjerrje të aktgjykimeve Barazia gjinore në procedurë gjyqësore - Analiza e Vendimeve Gjyqësore Punëtori me trajnuesit e Akademisë për hartimin programit të trajnimeve për vitin 2018 Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet civile dhe komerciale në BE Punëtori me trajnuesit e Akademisë për hartimin e programit trajnues për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial Punëtorja për zhvillimin e botimeve ligjore Menaxhimi i administratës së gjykatave dhe prokurorive Tryezë pune për hartimin e programit trajnues për stafin administrativ Menaxhimi i rrjedhës së rasteve Menaxhimi i kohës dhe stresit Mbështetje në infrastrukturën e Akademisë me tavolina në sallat e trajnimeve, dhe pajisje tjera të teknologjisë informative Programi orientues për gjyqtarët dhe prokurorët e integruar sipas Marrëveshjes për Drejtësi –Trajnimet në lëmine civile (Procedurat kontestimore, jokontestimore dhe përmbarimore) si dhe trajnimet interdisiplinare (Menaxhimi i gjykatës/prokurorisë dhe i rasteve si dhe Etika dhe Deontologjia)</p>

2	UNDP
	<p>Neni 6 i KEDNJ si dhe zbatimi i tij</p> <p>Veprat penale kundër detyrës zyrtare</p> <p>Shkëmbim i përvojave të Kosovës dhe Shqipërisë në zbatimin gjyqësor të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe garancionet ligjore për mbrojtjen kundër diskriminimit</p> <p>Dy Tryeza të punës me gjyqtarët e Gjykatës së Apelit</p> <p>Zbatimi i së drejtës evropiane nga ana e gjykatave të Republikës së Kosovës</p> <p>Zbatimi i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në sistemin kushtetues të Kosovës</p> <p>Referimi paragjykimor (incidental) dhe procedurat sipas nenit 113 par. 8 i Kushtetutës së Kosovës</p> <p>Dialogu institucional në mes të KGJK-së, KPK-së dhe ADK-së për çështje të interesit të përbashkët</p> <p>Seminar mbi zbatimin e KENDJ dhe garancionet ligjore për mbrojtjen kundër diskriminimit</p> <p>Mbështetje me Këshilltar lokal dhe aktivitete tjera nga Mekanizmi Koordinues për Drejtësi</p>
3	(OPDAT) - US-DOJ
	<p>Neni 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7 i KEDNJ</p> <p>Trafikimi me qenie njerëzore</p>
4	TWINNING/Projekti i Binjakëzimit
	<p>Korrupsioni, teknikat e hetimit</p> <p>Didaktika gjyqësore</p> <p>Avancimi i metodologjisë trajnuese</p> <p>Nga Instituti Gjyqësor në Akademinë e Drejtësisë-Planifikimi Strategjik për arsimimin ligjor të gjyqësorit të Kosovës</p> <p>Përgatitja dhe transformimi didaktik i lëndëve reale</p> <p>Menaxhimi i Gjykatave dhe Prokurorive-Sfidat praktike dhe Zhvillimi i Kurrikulës</p> <p>Pesë (5) Tryeza pune-Trajnimi Fillestar i bazuar në lëndë-Elaborimi i doracakut për trajnim të bazuar në lëndë</p> <p>Takimi me Drejtorin e Akademisë së Bradenburgut</p> <p>Vizita e studentëve nga Gjermania në Akademinë e Drejtësisë</p> <p>Punëtorja “Përgatitja dhe transformimi didaktik i lëndëve reale”</p>

5	Zyra e Këshillit të Evropës/JUFREX
	<p>Mbrojtja dhe promovimi i diversitetit, tolerancës dhe barazisë në kontekst të legjislacionit mbi mos diskriminimin</p> <p>Mbrojtja gjyqësore e të drejtës së pronësisë</p> <p>Trajnim i trajnuesve për KEDNJ</p> <p>Takimi i Komitetit Drejtues i projektit Përforcimi i Ekspertizës Gjyqësore mbi Lirinë e Shprehjes dhe medias në Evropën Juglindore – JUFREX</p> <p>Trajnim i Trajnuesve për Lirinë e shprehjes</p> <p>Takimi i Komitetit Drejtues i projektit “Përforcimi i Ekspertizës Gjyqësore mbi Lirinë e Shprehjes dhe medias në Evropën Juglindore</p> <p>Konferenca Rajonale “Liria e shprehjes dhe interneti”</p> <p>Punëtorja “Bashkëpunimi mbi krimin kibernetik me fokus të ardhurat nga krimi përmes internetit”</p>
6	WINPRO II (NI-CO)
	Mbrojtja e të dëmtuarve dhe dëshmitarëve
7	OSBE
	<p>Pesë (5) trajnime regjionale Trajtimi i Rasteve të Dhunës në Familje</p> <p>Krimet e Urrejtjes</p> <p>Trajtimi i rasteve të dhunës ndaj mediave</p>
8	UNICEF
	<p>Shqyrtimi gjyqësor në procedurën ndaj të miturve</p> <p>Dënimet që u shqiptohen të miturve</p> <p>Ekzekutimi i masave dhe dënimeve ndaj të miturve</p> <p>Masat edukative ndaj të miturve</p> <p>Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në rastet e ndryshimit të statusit të tyre</p>
9	EULEX
	<p>Krimet e luftës</p> <p>Tregjet e zeza në internet dhe krimi i organizuar</p> <p>Dëshmitë e mbledhura nga facebook dhe platformat tjera të mediave sociale</p> <p>Hartimi ligjor për zyrtarët ligjor dhe bashkëpunëtorët profesional.</p>
10	United Nations Office on Drugs and Crime - UNODC
	<p>Hetimi dhe Gjykimi i Rasteve ku Përfshihen Luftëtarët e Huaj Terrorist (LHT) në Evropën Juglindore</p> <p>Promovimi i modulit trajnues për luftëtarët e huaj terroristë</p>
11	UNHCR
	<p>Lëvizja dhe qëndrimi i të huajve si dhe procedurat ligjore ndaj tyre në Republikën e Kosovës</p> <p>Vizitë në institucionet shtetërore dhe ato të drejtësisë të Republikës së Kroacisë</p>

12	TAIEX
	Punëtorja Standardet e BE-së për Trajnimin Fillestar për Gjyqtarët dhe Prokurorët
13	Ambasada Amerikane
	Programi orientues për gjyqtarët dhe prokurorët e integruar sipas Marrëveshjes për drejtës - trajnimet në fushën penale – veçanërisht për Kodin e Procedurës Penale
14	AD & Shkolla Kombëtare e Magjistraturës së Francës -ENM
	Program internshipi i kandidatëve nga Shkolla Kombëtare e Magjistraturës së Francës –ENM Program internshipi - Trajtimi Gjyqësor i Terrorizmit Programi i internshipit në Gjykatën e Bres-it, Francë
15	Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal
	Takimi i dytë i Rrjetit të Institucioneve të Trajnimit Gjyqësor të Evropës Juglindore Takim i Institucioneve të Trajnimit Gjyqësor të vendeve të Ballkanit Perëndimor Takim i Përbashkët i Grupit Punues për Drejtësinë dhe Institucionet e Trajnimit Gjyqësor të Ballkanit Perëndimor
16	Akademia e Drejtësisë së Turqisë
	Kongresi Ndërkombëtarë për Arsimimin Ligjor

Tabela nr. 4. Programet e mbështetura nga donatorët

6.9 Bashkëpunimi ndërkombëtarë

Në sferën e bashkëpunimit ndërkombëtarë, Akademia gjatë vitit 2017 ka zhvilluar aktivitete të shumta qoftë në rolin e nikoqirit të delegacioneve të institucioneve të huaja të trajnimit gjyqësor, por jo vetëm, ashtu edhe në rolin e pjesëmarrjes në forume, konferenca dhe punëtori të ndryshme.

Në vijim janë të pasqyruara këto aktivitete.

6.9.1 Takimi i Komitetit Drejtues i projektit “Përforcimi i Ekspertizës Gjyqësore mbi Lirinë e Shprehjes dhe medias në Evropën Juglindore - JUFREX”

Akademia e Drejtësisë, ka marrë pjesë në takimin e Komitetit Drejtues i projektit “Përforcimi i Ekspertizës Gjyqësore mbi Lirinë e Shprehjes dhe medias në Evropën Juglindore – JUFREX”, pjesë e të cilit kanë qenë përfaqësuesit e Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës, stafi i projektit JUFREX nga rajoni si dhe përfaqësuesit e të gjitha institucioneve të trajnimit gjyqësor nga rajoni. Qëllimi i takimi të Komitetit Drejtues ishte diskutimi i aktiviteteve të realizuara gjatë vitit të parë të projektit, hartimi i plani të punës për vitin e ardhshëm në rrafshin lokal dhe rajonal, diskutimi i sfidave që projekti ka hasur gjatë zhvillimit dhe implementimit të aktiviteteve deri tani, sfidat që mund të paraqiten në të ardhmen si dhe shkëmbimi i ideve dhe propozimeve të reja.

Gjatë takimit janë prezantuar komponentët e projektit JUFREX që në fokus kanë lirinë e shprehjes. Komponenti i parë në fokus ka pasur programet e trajnimit me qëllim të zhvillimit të kapaciteteve për lirinë e shprehjes të gjyqtarëve, prokurorëve dhe avokatëve, si dhe dy komponentët tjera që lidhen me Autoritetet Rregullatorë dhe Akterët e Medias.

6.9.2 Takimi i dytë i Rrjetit të Institucioneve të Trajnimit Gjyqësor të Evropës Juglindore

Akademia e Drejtësisë ka marrë pjesë në Takimin e Dytë të Rrjetit të Institucioneve të Trajnimit Gjyqësor të Evropës Juglindore i organizuar nga Këshilli për Bashkëpunim Rajonal (RCC), i cili u mbajt në Stamboll. Qëllimi i këtij takimi ishte prezantimi dhe diskutimi i strukturës organizative të institucioneve të trajnimit gjyqësor, organet menaxhuese, pikat e forta dhe të dobëta të funksionimit si dhe praktikat më të mira në këtë drejtim. Gjithashtu u diskutua për nevojat e institucioneve trajnuese në fushën e trajnimeve gjyqësore dhe mbështetjen e pavarësisë së këtyre institucioneve, si dhe mundësinë që Këshilli për Bashkëpunim Rajonal të shërbej si një qendër për trajnime gjyqësore të qëndrueshme në vendet e Evropës Jug-lindore.

6.9.3 Takimi i Institucioneve të Trajnimit Gjyqësor të vendeve të Ballkanit Perëndimor

Akademia e Drejtësisë ka marrë pjesë në takimin e Institucioneve të Trajnimit Gjyqësor të Ballkanit Perëndimor, i organizuar nga Sekretariati i Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (RCC), që u mbajt në Bruksel. Në takim është diskutuar mundësia e bashkëpunimit të ardhshëm në mes të Institucioneve të Trajnimit Gjyqësor të vendeve të Ballkanit Perëndimor, shërbimeve relevante të Komisionit Evropian, Rrjetit Evropian të Trajnimeve Gjyqësore dhe Këshillit për Bashkëpunim Rajonal. Përfaqësuesit e institucioneve të trajnimit gjyqësor patën mundësinë që përmes debatit dhe diskutimeve të identifikojnë fushat e bashkëpunimit ndërinstitucional, si dhe identifikuan fushat konkrete ku ka nevojë për mbështetje për projekte të përbashkëta, nga e cila mund të përfitojnë institucionet trajnuese. Pjesëmarrësit u dakorduan për hapat e ardhshëm duke përcaktuar edhe objektivat afatshkurtra dhe afatgjata të projekteve rajonale.

6.9.4 Takim i Përbashkët i Grupit Punues për Drejtësinë dhe Institucionet e Trajnimit Gjyqësor të Ballkanit Perëndimor

Në kuadër të bashkëpunimit me Këshillin e Bashkëpunimit Rajonal (RCC), Akademia e Drejtësisë ka marrë pjesë në takimin e përbashkët të Grupit Punues për Drejtësinë dhe Institucionet e Trajnimit Gjyqësor të Ballkanit Perëndimor. Në këtë takim është prezantuar draft raporti me rekomandime për avancimin profesional dhe institucional i Institucioneve të Trajnimit Gjyqësor të Ballkanit Perëndimor, ngritjen e bashkëpunimit rajonal ndërmjet këtyre institucioneve, si dhe mundësitë për mbështetje nga Komisioni Evropian dhe Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal.

Takimi është përmbyll me konkluzionet që të vazhdoi bashkëpunimi i mëtejshëm i përbashkët ndërmjet Institucioneve të Trajnimit Gjyqësor të Ballkanit Perëndimor, lehtësuar dhe mbështetur nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal, si dhe identifikimi i aktiviteteve të ardhshme që do të realizohen si pjesë e këtij rrjeti.

6.9.5 Konferencë 20 Vjetori i Shkollës së Magjistraturës së Shqipërisë

Në kuadër të kremtimit të 20 vjetorit të fillimit të veprimtarisë akademike të saj, Shkolla e Magjistraturës e Shqipërisë, organizoi konferencën shkencore me titull “Magjistratura në Perspektivën Evropiane”, në të cilën mori pjesë u.d. Drejtori i Akademisë së Drejtësisë së Kosovës. Konferenca u realizua e ndarë në dy panele, paneli i parë trajtoi temën “Bashkëpunimi ndërkombëtar në rritjen e kapaciteteve dhe ngritjen institucionale të sistemit të drejtësisë. Roli i Shkollave të Magjistraturës në perspektivën evropiane”, ndërsa paneli i dytë, temën “Roli i magjistratit në rritjen

e cilësisë dhe efikasitetit të drejtësisë. Pozita para dhe pas ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore”.

Në panelin e dytë, përfaqësuesit e institucioneve të trajnimit gjyqësor prezantuan në tema të ndryshme, ndërsa u.d. Drejtori i Akademisë së Drejtësisë të Kosovës, referoi lidhur me temën “Trajnimi i vazhdueshëm i detyrueshëm – e drejtë dhe detyrë e magistratëve”.

Pjesëmarrja në panelin e parë e Institucioneve të Trajnimit Gjyqësor të rajonit synoi të përcjellë frymën e bashkëpunimit me të gjitha vendet në rajon në dhënien e përvojave individuale dhe ndarjen e të ardhmes së përbashkët Evropiane, parë edhe në kontekstin e secilit vend veç e veç.

6.9.6 Konferenca Rajonale “Liria e shprehjes dhe interneti”

Në kuadër të projektit “Përforcimi i Ekspertizës Gjyqësore mbi Lirinë e Shprehjes dhe medias në Evropën Juglindore – JUFREX” me mbështetje nga BE dhe Këshilli i Evropës, në Budvë është mbajtur konferenca e tretë rajonale me temë “Liria e shprehjes dhe interneti”.

Qëllimi i kësaj konference ishte rritja e ndërgjegjësimit dhe kapaciteteve të gjyqtarëve, prokurorëve dhe avokatëve pjesëmarrës që merren me çështjet e lirisë së shprehjes, si dhe përmirësimi i zbatimit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në fushën e lirisë së shprehjes, në punën e përditshme të gjyqësorit përmes interpretimit dhe zbatimit të legjislacionit vendor në linjë me standardet evropiane.

Punimet e kësaj konference dyditore janë zhvilluar me elaborimin e temave kryesore nga ana e ekspertëve me përvojë nga Gjykata e Strasburgut si: konceptet e jetës private dhe lirisë së shprehjes, kufiri i çmueshmërisë dhe vlerësimit të shteteve për nivelin e ndërhyrjes së lejuar në lirinë e mbrojtur të shprehjes, interneti-privatësia dhe liria e shprehjes, liria e shprehjes dhe fyerja, si dhe gjuha e urrejtjes. Ndërsa në ditën e dytë pjesëmarrësit janë ndarë në grupe punuese, duke trajtuar kështu raste të ndryshme, për të shkëmbyer praktikën e mira dhe për të siguruar mbështetje të ndërsjellë për zhvillimin e praktikës gjyqësore vendase në përputhje me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së për çështjet e mediave, gjegjësisht nenit 10. Delegacioni pjesëmarrës nga Kosova ishte i përbërë nga tre gjyqtarë, dy prokurorë, dy avokatë dhe një përfaqësues nga Akademia e Drejtësisë.

6.9.7 Forumi i Katërt Rajonal mbi Shtetin e së Drejtës në Evropën Juglindore

Akademia e Drejtësisë ka marrë pjesë në “Forumit e Katërt Rajonal mbi Shtetin e së Drejtës në Evropën Juglindore” të organizuar nga AIRE Centre dhe Civil Rights Defenders, me mbështetjen e Ministrisë së Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar, Qeverisë së Suedisë, Këshillit për Bashkëpunim Rajonal dhe GIZ-it.

Qëllimi i Forumit ishte promovimi i zbatimit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rajon, inkurajimi i bashkëpunimit në zhvillimin e vazhdueshëm të shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut, si edhe mbështetja në procesin e integritetit të rajonit në BE. Forumi i këtij viti u fokusua në të drejtën e lirisë së shprehjes në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe në veçanti marrëdhëniet e saj me të drejtën për respektimin e jetës private dhe të drejtën për gjykim të drejtë.

Punimet e këtij forumi i kanë ndjekur më shumë se 160 përfaqësues të shquar të gjykatave më të larta, Gjykata e Lartë dhe Kushtetuese, këshillat gjyqësorë, drejtorët e institucioneve të trajnimit gjyqësor, institucioneve dhe organizatave jo-qeveritare të vendeve të Ballkanit Perëndimor, si dhe përfaqësues të këtyre vendeve në Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut në Strasburg.

6.9.8 Kongresi Ndërkombëtarë për Arsimimin Ligjor

Në Stamboll është mbajtur Kongresi Ndërkombëtar i “Arsimimit Ligjor” i organizuar nga Akademia e Drejtësisë e Turqisë, në të cilin ka marrë pjesë edhe Akademia e Drejtësisë si institucion i cili merret me trajnime në fushën gjyqësore, krahas përfaqësuesve të institucioneve të trajnimit gjyqësor, gjyqtarëve dhe prokurorëve, dekanëve, akademikëve dhe studentëve nga vende të ndryshme të Evropës dhe Azisë.

Referuesit u ndalën veçanërisht në zhvillimin e arsimimit ligjor në periudha të ndryshme historike, situatën aktuale të arsimimit ligjor në sisteme të ndryshme në botë, ku u prezantuan arritjet dhe sfidat në fushën e arsimimit ligjor qoftë në pjesën akademike e cila realizohet nga institucionet e arsimit, apo edhe pjesën praktike e cila në pjesën më të madhe të vendeve realizohet nga institucionet që merren me trajnimin gjyqësor.

Pjesë e zhvillimeve në kongres ishte organizimi i tryezës së diskutimeve në të cilën kanë marrë pjesë institucionet e trajnimit gjyqësor ku janë prezantuar zhvillimet aktuale, sfidat si dhe janë dhënë rekomandime të ndryshme për avancimin e punës së institucioneve që organizojnë trajnimin gjyqësor.

6.9.9 Vizitë e delegacionit të Shkollës së Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë

Në kuadër të bashkëpunimit të rregullt, në Akademinë e Drejtësisë kanë qëndruar për një vizitë pune përfaqësuesit më të lartë nga Shkolla e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë si dhe ekspertë tjerë nga fusha gjyqësore. Qëllimi i vizitës ishte intensifikimi i bashkëpunimit në mes të dy institucioneve të trajnimit gjyqësor, si dhe ndarja e përvojave në tejkalimin e sfidave të cilat paraqiten veçanërisht në fazën e reformave gjyqësore që po kalojnë të dy institucionet. Në këtë aspekt drejtuesit e institucioneve respektive shprehen gatishmërinë dhe vullnetin e tyre për angazhim të mëtutjeshëm në hartim të programeve konkrete të shkëmbimit si të gjyqtarëve dhe prokurorëve, po ashtu edhe të trajnuesve të këtyre institucioneve. Delegacioni nga Shqipëria ka zhvilluar takime edhe me përfaqësues të institucioneve të gjyqësorit ku janë pritur nga Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Kryetar i Gjykatës së Apelit.

6.9.10 Vizitë e Delegacionit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë së Shqipërisë në Akademinë e Drejtësisë

Akademia e Drejtësisë ka pritur në vizitë një delegacion nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë së Shqipërisë. Qëllimi i vizitës ishte njohja për së afërmi me punën dhe aktivitetet e Akademisë së Drejtësisë, shkëmbimi i ideve dhe i përvojave për praktikën më të mira me qëllim të organizimit të trajnimeve gjyqësore, si dhe ngritja e nivelit të bashkëpunimit në mes të Akademisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe institucioneve tjera të sistemit gjyqësor të Shqipërisë.

Në këtë kuadër u diskutuan organizimi i sistemit të drejtësisë dhe sistemit gjyqësor në përgjithësi, roli, funksioni dhe struktura e Akademisë së Drejtësisë, të arriturat dhe sfidat, korniza ligjore, mandati, si dhe çështje tjera me interes të përbashkët.

6.9.11 Vizita e juristëve gjerman në Akademinë e Drejtësisë

Drejtori i Akademisë së Drejtësisë ka pritur në takim një delegacion të juristëve të rinj të Gjermanisë, i cili është organizuar me iniciativën dhe mbështetjen nga GIZ-i.

Në këtë takim është prezantuar puna e Akademisë, duke i njoftuar pjesëmarrësit në detaje për aktivitetet që zhvillon Akademia, rolin, strukturën, bazën ligjore, programet trajnuese dhe mandatin e Akademisë. Në fund të takimit, u diskutua për mundësitë e bashkëpunimit për shkëmbimin e përvojave dhe praktikës në fushën e trajnimeve gjyqësore dhe zhvillimit të kapaciteteve në fushën e gjyqësorit.

6.9.12 Vizita e studentëve nga Gjermania në Akademinë e Drejtësisë

Akademia e Drejtësisë ka pritur në takim një grup prej 16 studentëve nga Gjermania, duke i njoftuar ata nga afër me funksionimin dhe aktivitetet e Akademisë. Në këtë takim studentët u njoftuan për sistemin e drejtësisë në Kosovë, funksionimin dhe ndarjen e pushteteve, mandatin dhe funksionet kryesore të institucioneve të sistemit të drejtësisë, rolin dhe mandatin e Akademisë së Drejtësisë, si dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me funksionimin e shtetit ligjor dhe të së drejtës.

Nga ana tjetër studentët gjerman vlerësuan si shumë të rëndësishme vizitën e tyre në Kosovë e veçanërisht në Akademi të Drejtësisë, me ç ‘rast shprehën interesimin e tyre për të pasur më shumë njohuri për sistemin gjyqësor në Kosovë me theks të veçantë për punën e Akademisë së Drejtësisë.

6.9.13 Vizitë në institucionet shtetërore dhe ato të drejtësisë të Republikës së Kroacisë

Me mbështetjen e UNHCR-së dhe CRPK-së, është realizuar vizita studimore, për marrje përvojash në Akademinë Gjyqësore të Kroacisë, në Ministrinë e Punëve të Brendshme - Sektori për punët administrative dhe inspektuese në tematikën e „Njohjes së thelluar me procedurën e lejimit të mbrojtjes ndërkombëtare (lëmia e azilit) - legjislacionit si dhe praktikës gjyqësore dhe vendimmarrjes në gjykatat e Republikës së Kroacisë”.

Fillimisht është vizituar Ministria e Punëve të Brendshme e Kroacisë – Shërbimi për të huaj dhe azili, ku përfaqësuesit nga ky institucion kanë ofruar një paraqitje mbi legjislacionin në fuqi të Republikës së Kroacisë dhe implementimin e direktivave të BE-së me të cilat rregullohen çështjet e zhvillimit të procedurës së mbrojtjes ndërkombëtare dhe asaj të përkohshme në Republikën e Kroacisë. Pjesë e vizitës ishte edhe takimi në Akademinë e Drejtësisë, ku delegacioni nga Kosova është pritur nga Drejtoresha e Akademisë së Drejtësisë dhe udhëheqësja e Sektorit për bashkëpunim ndërkombëtar. Pjesëmarrësit patën rastin të marrin pjesë edhe në tryezën e rumbullakët me temë “Republika e Kroacisë – 20 vite pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut“, organizuar nga Akademia Gjyqësore dhe Zyra e Përfaqësuesit të Republikës së Kroacisë pranë GJEDNJ, ku patën rastin të njihen hollësisht me të arriturat, pengesat dhe sfidat e Republikës së Kroacisë në zbatimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ),

standardeve dhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ në Strasburg. Pjesëmarrës në këtë vizitë nga Kosova ishin 2 gjyqtarë nga Gjykata e Apelit, 2 gjyqtarë nga Gjykata Themelore, 2 përfaqësues nga Akademia e Drejtësisë dhe 1 përfaqësues nga UNHCR si dhe 1 përfaqësues nga CRPK.

6.9.14 Punëtorja “Bashkëpunimi mbi krimin kibernetik me fokus të ardhurat nga krimi përmes internetit”

Në Budva të Malit të Zi, gjyqtarë dhe prokurorë nga Kosova kanë marrë pjesë në punëtorinë për trajnimin e trajnuesve për shtetet e Ballkanit Perëndimor me temë “Bashkëpunimi mbi krimin Kibernetik, me fokus të ardhurat nga krimi përmes internetit” i organizuar nga Zyra e Programit për Krim Kibernetik të Këshillit të Evropës, njësia përgjegjëse e vendosur në Bukuresht. Qëllimi i kësaj punëtorie ishte ngritja e kapaciteteve profesionale në zbatimin e hetimeve dhe procedurave që duhet ndjekur për luftimin e krimit kibernetik.

Punëtorja ishte e fokusuar në dhënien e njohurive për krimin kibernetik dhe provat elektronike, hetimin financiar dhe procedura që duhet ndjekë për krimet kibernetike, veprimet e policisë, prokurorisë dhe gjykatës, procedurat ligjore dhe teknologjike që duhet ndërmarrë në këto raste, dhe ndërmarrja e veprimeve në raste urgjente lidhur me bashkëpunimin vendor dhe ndërkombëtar dhe efikasiteti.

6.9.15 Punëtorja “Standardet e BE-së për Trajnimin Fillestar për Gjyqtarë dhe Prokurorë”

Nën organizimin e TAIEX , është mbajtur punëtorja “Standardet e BE-së për Trajnimin Fillestar për gjyqtarë dhe prokurorë”, qëllimi i të cilës ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve me standardet e BE-së në lidhje me përzgjedhjen dhe trajnimin fillestar të gjyqtarëve dhe prokurorëve të ardhshëm, shkëmbimi i praktikave dhe eksperiencave më të mira rreth përzgjedhjes së kandidatëve në programin e trajnimit fillestar. Gjatë diskutimeve janë trajtuar standardet e BE-së për trajnimin fillestar, procesin e përzgjedhjes së kandidatëve, provimet hyrëse, hartimin e moduleve të trajnimit, si dhe vlerësimin dhe monitorimin e trajnimit fillestar. Kjo punëtori mundësoi shkëmbimin e praktikave më të mira midis përfaqësuesve të institucioneve të trajnimit gjyqësor, dhe ekspertëve të Institutit Belg të Trajnimit Gjyqësor, Rrjeti Evropian i Trajnimit Gjyqësor në Bruksel, gjyqësorit suedez, Qendrës Holandeze të Trajnimit dhe Studimit të Gjyqësorit, Shkollës Kombëtare Franceze të Magjistraturës dhe Shkollës Evropiane të Zbatimit të Bullgarisë.

Pjesëmarrës në punëtori ishin përfaqësues nga Institucionet e Trajnimit Gjyqësor nga vendet e Ballkanit Perëndimor.

6.9.16 Vizitë e Drejtorit të Akademisë së Drejtësisë së Branderburgut të Gjermanisë

Akademia e Drejtësisë ka pritur në një takim Drejtorin e Akademisë së Drejtësisë së Branderburgut të Gjermanisë. Ky takim është realizuar në mbështetje të Projektit të Binjakëzimit “Mbështetje e mëtejme e reformës për arsimim ligjor”. ku është prezantuar puna e Akademisë së Drejtësisë së Branderburgut, mënyra e funksionimit, veçanërisht programet trajnuese të cilat i ofron për përfituesit e saj. Nga Akademia e Drejtësisë është përcjell me interes prezantimi i Drejtorit të Akademisë së Drejtësisë së Branderburgut me qëllim që të përfitohet më shumë rreth kurrikulave dhe programeve të trajnimit, si dhe u diskutuan shumë çështje me interes në fushën e trajnimeve.

6.9.17 Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet civile dhe komerciale në BE

Në mbështetje të GIZ-it është organizuar trajnimi regional “Legjislacioni i BE-së”, përkatësisht me temë: “Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet civile dhe komerciale në BE”, i cili është mbajtur në Ohër të Maqedonisë në të cilin kanë marrë pjesë gjyqtarët nga shtetet e Evropës Juglindore. Gjatë këtij trajnimi janë diskutuar çështjet lidhur me aplikimin e të drejtës së BE-së në procedurat dhe vendimet e gjykatave të vendeve të Evropës Juglindore, e po ashtu edhe çështjet lidhur me bashkëpunimin juridik në lëminë civile dhe komerciale në këto vende. Pjesëmarrësit e këtij trajnimi kanë paraqitur punimet e tyre me këtë temë për të kontribuar në krijimin e praktikave më të mira në bashkëpunimin gjyqësor në çështje civile dhe komerciale në BE.

6.9.18 Seminar mbi zbatimin e KEDNJ dhe garancionet ligjore për mbrojtjen kundër diskriminimit

Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Shkollën Magjistraturës së Shqipërisë, mbështetur nga projekti i qasjes në drejtësi të UNDP-së ka realizua një ngjarje të përbashkët rajonale mbi zbatimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe garancionet ligjore për mbrojtjen kundër diskriminimit.

Qëllimi i organizimit të seminarit është shkëmbimi i përvojave në mes të gjyqësorit Kosovar dhe atij nga Shqipëria në fushën e zbatimit të vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut si dhe zbatimin e Ligjit Kundër Diskriminimit.

Seminari trajtoi kornizën ligjore dhe praktikën gjyqësore lidhur me barazinë dhe mosdiskriminimin, diskriminimi në fushën e marrëdhënieve të punës, zbatimin e KEDNJ-së në Kosovë dhe Shqipëri përfshirë metodologjinë e referimit të praktikës gjyqësore së GJEDNJ-së dhe zbatimin e vendimeve të GJEDNJ-së në Shqipëri. Po ashtu u elaborua roli i gjykatave dhe Avokatit të Popullit në ndalimin e diskriminimit përfshirë dhe standardet e OKB dhe ato evropiane lidhur me barazinë dhe mos diskriminimin – rëndësia e njohjes dhe zbatimit të tyre nga sistemi i drejtësisë.

Në këtë seminar u diskutuan praktikat e dy vendeve në zbatimin e KEDNJ-së dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së ku u prezantuan sfidat specifike të Kosovës dhe elaborimi i rasteve ku Shqipëria ishte palë në procedurën pranë GJEDNJ-së.

Pjesëmarrës në këtë seminar janë: gjyqtarë dhe prokurorë nga Kosova dhe Shqipëria, si dhe përfaqësues nga Institucioni i Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës.

6.9.19 Promovimi i modulit trajnues për luftëtarët e huaj terroristë

Akademia e Drejtësisë me ftesë të Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogë dhe Krime (UNODC), dega për Parandalimin e Terrorizmit (TPB), kanë marrë pjesë në përrurimin e Modulit Trajnues për Luftëtarët e Huaj Terroristë, e cila u mbajt në Vjenë. Qëllimi i kësaj ngjarje promovuese ishte që pjesëmarrësve të ju jep mundësi që të reflektojnë për projektin, diskutojnë integrimin e modulit trajnues për luftëtarët e huaj terroristë në kurrikulën e rregullt trajnuese të institucioneve të trajnimit gjyqësor, dhe të forcojnë bashkëpunimin e ardhshëm mes UNODC dhe institucioneve trajnuese gjyqësore. Pjesëmarrës në ngjarjen e përrurimit të modulit trajnues për luftëtarët e huaj

terroristë ishin: 2 prokuror nga Kosova dhe një përfaqësues nga Akademia e Drejtësisë.

6.10 Programet e shkëmbimit

6.10.1 Program intershipi i kandidatëve nga Shkolla e Magjistraturës së Francës

Bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit në mes Akademisë së Drejtësisë dhe Shkollës Kombëtare e Magjistraturës së Francës – ENM, deh në bashkëpunim të ngushtë me Ambasadën e Francës në Prishtinë, prej dt. 20 shkurt deri me 10 mars dy kandidatë të kësaj shkolle kanë qëndruar në Kosovë në një program praktik të trajnimit. Objektivat e këtij programi qëndrojnë në njoftimin e kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë të Francës, me sistemin gjyqësor në Kosovë, veçanërisht në ndjekjen, hetimin dhe gjykimin e veprave penale, si dhe zbatimin e dënimeve, çështjet gjyqësore familjare, kontrata dhe përgjegjësitë, të kuptuarit e dimensionit ndërkombëtar të drejtësisë dhe të kuptuarit e sistemeve të huaja të trajnimit të gjyqtarëve.

Akademia ka pasur rolin kyç në përgatitjen dhe zbatimin e këtij programi intershipi, që në përmbajtje ka trajnimin praktik që realizohet në gjykata dhe prokurori në mbështetje të gjyqtarëve/prokurorëve në cilësinë e mentorit, si dhe janë organizuar takime me institucione tjera vendore dhe ndërkombëtare në Kosovë.

6.10.2 Program intershipi në Gjykatën e Bres – Francë

Nën organizimin e Gjykatës së Qarkut në Bres të Francës është realizuar një program trajnimi praktik - intership në të cilën ka marrë pjesë një prokuror nga Prokuroria Themelore e Prishtinës. Qëllimi kryesor i këtij programi ka qenë marrja e përvojave të mira nga sistemi i drejtësisë së Republikës së Francës veçanërisht nga praktika gjyqësore.

Në këtë program janë realizuar edhe takime të shumta dhe janë shtjelluar tema sa i përket strukturës organizative të sistemit gjyqësor dhe prokurorial në Francë, pastaj për organizimin e administratës së kësaj gjykate duke filluar nga pranimi i lëndës, ndarja e tyre, menaxhimi i lëndës deri te përmbyllja e lëndës, bashkëbisedim me gjyqtarë rreth lendeve, pjesëmarrje në seanca gjyqësore me palë të ndryshme dhe me natyrë të ndryshme të veprave penale duke filluar nga lëndët me narkotikë, grabitje etj. Po ashtu takime edhe me gjyqtarë, prokurorë dhe bashkëpunëtorë profesional tjerë të kësaj gjykate.

6.10.3 Trajtimi Gjyqësor i Terrorizmit

Bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit në mes Akademisë së Drejtësisë dhe Shkollës Kombëtare të Magjistraturës së Francës (ENM) dhe mbështetje nga Ambasada e Francës në Prishtinë, një prokurorë i Prokurorisë Speciale të Kosovës, ka qëndruar në Francë në një program praktik të trajnimit me temë “Trajtimi Gjyqësor i Terrorizmit”. Fokusi i këtij programi trajnues ishte i drejtuar në aspektin praktik dhe sfidat e drejtpërdrejta të autoriteteve franceze në parandalimin, luftimin e terrorizmit si dhe rehabilitimin e të dënuarve për vepra të ndryshme të cilat ndërlidheshin me terrorizmin. Vëmendje të veçantë i është kushtuar edhe rolit të gruas në indoktrinim, radikalizëm, përkrahje materiale e ndihmë konkrete në kryerjen e veprave penale të cilat ndërlidhen me terrorizmin, e gjithashtu edhe përfshirjes së fëmijëve drejtpërsëdrejti në kryerjen e veprave të ndryshme të terrorizmit.

Pjesëmarrës të këtij aktiviteti trajnues ishin gjyqtar dhe prokuror të vendeve të ndryshme nga Evropa, Afrika dhe Amerika Latine, të cilët po ballafaqohen me sfida të reja në fushën e terrorizmit.

6.11 Programi për praktikantë – studentë

Në kuadër të bashkëpunimit mes Akademisë së Drejtësisë dhe institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë, gjatë vitit 2017 kanë ndjekur dhe përfunduar me sukses programin e praktikës, 2 student nga institucione të arsimit të lartë.

Gjatë periudhës së praktikës studentët patën mundësi të mësojnë për së afërmi rreth aktiviteteve që i realizon Akademia, të njihen me funksionimin e sistemit gjyqësor dhe prokurorial, të përfitojnë nga pjesëmarrja në trajnimet e Akademisë si dhe të asistojnë në hartimin e raporteve, përgatitjen e trajnimeve dhe aktiviteteve të ndryshme të organizuara nga Akademia.

7. Administrata dhe Financat

Zhvillimi i aktiviteteve të Akademisë mbështetet nga Departamenti për Administratë dhe Financa (më tej DAF). Në kuadër të DAF-it përfshihen burimet njerëzore financat, prokurimi, teknologjia informative, dhe logjistika. Përgjegjësitë e DAF janë të përcaktuara në detaje me Rregulloren për Organizim të Brendshëm.

Përgjegjësitë kryesore të DAF janë: hartimi dhe zbatimi i politikave zhvillimore në fushën e administratës, zhvillimi i një administrate profesionale, efikase, funksionale si dhe ofrimi i shërbimeve të shpejta administrative, në përputhje me nevojat dhe specifikat e Akademisë, planifikimi, hartimi, raportimi, mbikëqyrja dhe menaxhimi i buxhetit dhe financave përfshirë edhe donacionet, si dhe mbikëqyrja dhe kontrolli i shpenzimeve të parasë së imët, planifikimi, koordinimi dhe menaxhimi i aktiviteteve të prokurimit, në pajtueshmëri të plotë me dispozitat ligjore dhe aktet tjera nënligjore të prokurimit publik, planifikimi, mbikëqyrja dhe administrimi me pajisjet e teknologjisë informative, programet softuerike dhe sistemet e rrjetit telekomunikues, që janë nën menaxhimin dhe administrimin e Akademisë, planifikimi, mbikëqyrja dhe menaxhimi me pasurinë e Akademisë, ofrimi i shërbimeve logjistike, ku përfshihet furnizimi me mallra, shërbimet e transportit, mirëmbajtja e objektit dhe arkivi.

7.1 Buxheti dhe financat

Në kuadër të aktiviteteve të buxhetit dhe financave të Akademisë, përfshihen aktivitete të ndryshme që kanë të bëjnë me planifikimin, menaxhimin, kontrollin dhe zbatimin e buxhetit për vitin 2017.

Në kuadër të buxhetit dhe financave aktivitetet kryesore të realizuara gjatë periudhës raportuese janë:

- Përgatitja e pasqyrave vjetore financiare për vitin 2016;
- Prezantimi i Raportit vjetor të punës për vitin 2016 në Komisionin për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit të Kuvendit, ndërsa gjatë vitit 2017, Akademia nuk është ftuar për raportim në Komisionin për Buxhet dhe Financa të Kuvendit;
- Plotësimi i pyetësorit për vetëvlerësim për vitin 2016;

- Përgatitja e rrjedhës së parasë së gatshme për vitin 2017;
- Përgatitja e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve dhe buxhetit për periudhën 2018-2020;
- Barazimi periodik i shpenzimeve me thesar;
- Hartimi i raporteve të ndryshme periodike financiare;
- Të gjitha shpenzimet e proceduara për këtë periudhë janë regjistrua në bazën e brendshme të financave dhe në SIMFK;

7.1.1 Buxheti i Republikës së Kosovës

Shpenzimet e krijuara gjatë kësaj periudhe janë mbuluar nga Buxheti i Republikës së Kosovës si burim kryesor financiar si dhe nga mbështetja e granteve të donatorëve.

Shpenzimet e buxhetit përfshihen në këto kategori kryesore ekonomike: pagat dhe mëditjet, mallrat dhe shërbimet, shpenzimet komunale dhe shpenzime kapitale. Tabela në vijim pasqyron buxhetin fillestar dhe buxhetin përfundimtar për vitin 2017, duke përfshirë kategoritë ekonomike.

Buxheti 2017			
Përshkrimi	Buxheti Fillestar	Reduktimet Buxhetore	Buxheti Përfundimtar
Pagat dhe Mëditjet	204,383.99	-	204,383.99
Mallrat dhe Shërbimet	430,000.00	(55,428.05)	374,571.95
Shpenzimet Komunale	16,500.00	(2,000.00)	14,500.00
Kapitale	13,000.00	(3,259.00)	9,741.00
Donacionet	-	-	16,127.00
Totali	663,883.99	(60,687.05)	619,323.94

Tabela nr. 5. Raporti i Buxheti për vitin 2017

Me Ligjin Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016, buxheti fillestar i Akademisë për këtë vit ka qenë 663,884.00 euro për të gjitha kategoritë ekonomike përfshirë këtu pagat dhe mëditje, mallrat dhe shërbimet dhe shpenzimet komunale.

Në fund të vitit 2017 janë realizuar 16,127.00 euro të hyra nga donacionet 14,400.00 euro janë donacion nga Këshilli i Evropës dhe 1,727.00 euro janë donacion nga GIZ.


Në procesin e rishikimit buxhetor me ligj janë deklaruar kursime në vlerë prej 24,859.00 prej të cilave 19,600.00 euro në mallra dhe shërbime, 2,000.00 euro në shpenzime komunale dhe 3,259.00 euro në shpenzime kapitale.

Në fund të vitit, buxheti është zvogëluar edhe për 35,828.05 euro, prej të cilave janë 28,700.00 euro janë deklaruar kursime, si dhe me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës janë reduktuar 7,128.05 euro.

Buxheti përfundimtarë për vitin 2017 në paga dhe mëditje është 204,383.99 euro, në mallra dhe shërbime 390,668.95 euro përfshirë donacionet, prej të cilave 374,571.95 euro nga buxheti dhe 16,127.00 euro donacionet, shpenzime kapitale 9,741.00 euro dhe në shpenzime komunale 14,500.00 euro.

Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet	Përqindja
Pagat dhe Mëditjet	204,383.99	185,825.07	90.92
Mallrat dhe Shërbimet	374,571.95	309,848.08	82.72
Shpenzimet Komunale	14,500.00	10,258.42	70.75
Kapitale	9,741.00	9,740.77	100.00
Totali	603,196.94	515,672.34	85.49


Tabela nr. 6. Ekzekutimi i Buxhetit për vitin 2017



Grafikoni nr. 29 Ekzekutimi i Buxhetit për vitin 2017


Nga buxheti përfundimtar janë shpenzuar 515,672.34 euro apo 85.49 % e buxhetit që do të thotë se ekzekutimi i buxhetit është bërë sipas planifikimeve të bëra për këtë vit. Pjesa e mjeteve të reduktuara nuk ka rrezikuar aktivitetet e Akademisë meqë programi i trajnimit fillestar i planifikuar për gjyqtarët e sapoemëruar ka filluar në muajin shtator, e jo siç ishte planifikimi që nga fillimi i vitit.

Mallrat dhe shërbimet në buxhetin e Akademisë përfshijnë shumën më të madhe të buxhetit si në alokim ashtu edhe në shpenzim për arsye se shpenzimet për shërbimet e trajnimit janë pjesë e kësaj kategorie ekonomike dhe gjithashtu janë shpenzimet kryesore të AD-së.



Grafikoni nr. 30 Shpërndarja e buxhetit

Sipas këtij grafikoni shihet se 62 % e buxhetit është ndarë për mallra dhe shërbime, 34 % për paga dhe mëditje, rreth 2% për shpenzimet komunale dhe rreth 2% në shpenzime kapitale.



Grafikoni nr. 31. Shpenzimi i buxhetit

Në raport me shumën totale të buxhetit të shpenzuar, mallrat dhe shërbimet përfshihen me 60.09%, pagat dhe mëditjet me 36.04 %, komunalitë me 1.99 % dhe shpenzimet kapitale me 1.89 %.

Në tabelën në vazhdim përveç kategorive ekonomike shpenzimet prezantohen edhe për nënkategoritë ekonomike duke krahasuar me buxhetin e vitit për secilën nënkategori.

Shpenzimet për kategori dhe nën kategori ekonomike paraqiten si në vijim:

Shpenzimet sipas nën kategorive					
Shpenzimet janar - dhjetor 2017					
Numri i Llogarisë	Emri i Llogarisë	Shpenzimet	Buxheti	Ndryshimi	Përqindja
Paga					
11110	Pagat neto përmes listës	157,976.01	176,534.93	18,558.92	89.49
11500	Tatimi i ndalur në të ardhura	10,151.04	10,151.04	-	100.00
11600	Kontributi i punëtorit	8,849.01	8,849.01	-	100.00
11700	Kontributi i punëdhënësit	8,849.01	8,849.01	-	100.00
Shuma		185,825.07	204,383.99	18,558.92	90.92
Mallra dhe Sherbime					
13142	Akomodimi udhëtime zyrtre brenda vendit	-	-	-	-
13141	Meditjet për udhëtime zyrtre jashtë vendit	12,591.80	15,000.00	2,408.20	83.95
13142	Akomodimi udhëtime zyrtre jashtë vendit	2,085.00	4,200.00	2,115.00	49.64
13143	Shpenzime tjera udhëtime zyrtre jashtë vendit	806.50	1,000.00	193.50	80.65
13320	Shpenzimet e telefonisë mobile	2,431.63	3,360.00	928.37	72.37
13330	Shpenzimet postare	5.60	600.00	594.40	0.93
13410	Shërbimet e arsimit trajnimit	162,563.20	181,344.87	18,781.67	89.64
13430	Shërbime të ndryshme shëndetsore	-	480.00	480.00	-
13440	Shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshilldhënës	3,089.70	4,812.00	1,722.30	64.21
13450	Sherbime shtypje-jo marketing	642.50	840.00	197.50	76.49
13460	Sherbime kontraktuese tjera	3,259.65	6,000.00	2,740.35	54.33
13501	Mobilje (me pak se 1000 euro)	-	2,000.00	2,000.00	-
13509	Pajisje tjera	2,998.79	3,000.00	1.21	99.96
13610	Furnizime per zyre	4,889.98	13,000.00	8,110.02	37.62
13620	Furnizim me ushqim, pije (jo dreka zyrtare)	3,631.71	6,000.00	2,368.29	60.53
13720	Nafte per ngrohje qendrore	8,913.95	9,600.00	686.05	92.85
13770	Derivate per gjenerator	-	1,500.00	1,500.00	-
13780	Karburant per vetura	1,873.85	3,000.00	1,126.15	62.46
13951	Sigurimi i automjeteve	863.50	950.00	86.50	90.89
13952	Taksat Komunale e Regjistrimi te automjeteve	-	50.00	50.00	-
13953	Sigurim i ndertesave dhe tjera	7,468.87	9,800.00	2,331.13	76.21
13950	Regjistrim i automjeteve	618.08	1,000.00	381.92	-
14010	Mirembajtje dhe riparim I automjeteve	1,250.20	2,400.00	1,149.80	52.09
14020	Mirembajtje e ndertesave	6,061.61	7,800.00	1,738.39	77.71
14040	Mirembajtje e teknologjise informative	-	1,200.00	1,200.00	-
14050	Mirembajtje e mobiljeve dhe pajisjeve	2,769.49	3,720.00	950.51	74.45
14110	Qiraja e ndertesave	75,115.08	75,115.08	-	100.00
14210	Reklammat dhe konkurset	1,636.00	3,000.00	1,364.00	54.53
14220	Botimet e publikimeve	3,601.69	10,800.00	7,198.31	33.35
14310	Dreka zyrtare	679.70	3,000.00	2,320.30	22.66
Shuma		309,848.08	374,571.95	64,723.87	82.72
Komunali					
13210	Rryma	6,647.38	8,000.00	1,352.62	83.09
13220	Uji	566.38	1,500.00	933.62	37.76
13230	Mbeturinat	641.72	1,800.00	1,158.28	35.65
13250	Shpenzimet e telefonit	2,402.94	3,200.00	797.06	75.09
Shuma		10,258.42	14,500.00	4,241.58	70.75
Kapitale					
31690		9,740.77	9,741.00	0.23	100.00
Shuma		9,740.77	9,741.00		
Totali		515,672.34	603,196.94	87,524.60	85.49

Tabela nr. 7. Shpenzimet për kategori dhe nën kategori ekonomike

7.1.2 Mbështetja financiare nga donatorët

Shpenzimet e prezantuara në kuadër të këtij shënimi janë shpenzimet e krijuara me rastin e zbatimit të projektit me Këshillin e Evropës dhe GIZ-it.

Buxheti total i donacioneve gjatë vitit 2017 ka qenë 16,127.00 euro, 14,400.00 euro janë mjete nga Këshilli i Evropës, ndërsa 1,727.00 euro janë donacion i realizuar nga GIZ në fund të vitit 2017. Nga totali i përgjithshëm i donacioneve janë shpenzuar 1,097.10 euro.

Donacionet e menaxhuara nga Akademia janë si më poshtë:

Viti	Emri i Donatorit	Shpenzimet	Alokimi	Mbetja
2017	Këshilli i Evropës	1,097.10	14,400.00	13,302.90
2017	GIZ	-	1,727.00	-
Shuma		1,097.10	16,127.00	13,302.90

Tabela 8. Donacionet e menaxhuara nga Akademia

Donacionet e menaxhuara nga donatorët

			2017
Emri donatorit	Nr.i projektit	Emëri i projektit	€ 0.000
EULEX			17,723
GIZ			116,883
UNDP			15,508
U.S. Department of Justice/OPDAT			15,772
TAIEX			124
Totali i Granteve në euro			166,009

Tabela nr. 9. Donacionet e menaxhuara nga donatorët

Në tabelën 9 shpalosen donacionet e menaxhuara nga vet donatorët që do të thotë se këto mjete nuk kanë rrjedhë përmes llogarisë së Thesarit.

Sipas informatave të ofruar nga përfaqësuesit e projekteve me donatorë, në këtë tabelë bëhet shpalosja e mbështetjes financiare nga donatorët vetëm në totalin e shpenzimeve ashtu siç janë pranuar, pa pasur mundësi të shpalosen në detaje. Mirëpo ka edhe nga donatorët që kanë dërguar raporte për aktivitetet e zhvilluara me Akademinë, por jo me vlera financiare.

Prezantimi dhe shpalosja e donacioneve në këtë rast tregon qartë se, Akademia edhe në këtë vit ka realizuar aktivitete trajnuese në mbështetje të donatorëve të ndryshëm. Edhe pse nuk janë të specifikuar dhe të detajuara, shpenzimet e mbuluara kanë qenë kryesisht shpenzimet për shërbimet e trajnimit, shpenzimet e botimeve dhe publikimeve, shpenzimet për vizita studimore.

7.2 Shërbimet e përgjithshme

Në kuadër të shërbimeve të përgjithshme Akademia gjatë vitit 2017 ka realizuar aktivitetet si në vijim:

- Në aspektin administrativ, teknik dhe të logjistikes janë mbështetur të gjitha aktivitetet e organizuar nga Akademia;
- Është përfunduar auditimi nga ZKA për vitin 2016 dhe është publikuar raporti i auditimit;
- Është realizuar auditimi i brendshëm nga MF për vitin 2016;
- Është përgatitur plani për zbatimin e rekomandimeve të dala nga raporti i auditimit të pasqyrave financiare 2016;
- Është bërë arkivimi i materialit trajnuese për qëllime studimi, si dhe i dokumentacionit tjetër relevant;

Burimet njerëzore:

- Për vitin 2017 janë 25 pozita të aprovuara;
- Mirëmbajtja e dosjeve fizike dhe elektronike të personelit;
- Hartimi dokumenteve dhe raporteve të ndryshme për burimet njerëzore;
- Është përgatitur plani për personel dhe plani i trajnimeve të stafit për vitin 2017;
- Janë zhvilluar disa procedura të rekrutimit për plotësimin e pozitave të lira;
- Është plotësuar pozita e Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë;
- Janë organizuar trajnime, tryeza dhe punëtori për stafin, brenda dhe jashtë Akademisë;
- Është bërë plani i trajnimeve për vitin 2017;
- Është bërë vlerësimi i punës së stafit sipas legjislacionit në fuqi;

Teknologjia informative:

- Është zhvilluar në aspektin teknik moduli Ndërmjetësimi në Aspektin Civil dhe Penal i përshtatshëm për platformën e mësimit në distancë;
- Është zhvilluar pyetësi online “Vlerësim të Nevojave për Trajnime të Vazhdueshme për gjyqtarë dhe prokurorë”.
- Është bërë instalimi i kamerave të sigurisë brenda dhe jashtë objektit të Akademisë;
- Është bërë instalimi i versionit të fundit për platformën e mësimit në distancë ILIAS;
- Janë blerë 50 resiver me kufje të cilat do të shërbejnë për pajisjet simultane të përkthimit;
- Janë bërë ndërhyrjet për ndryshimet e nevojshme në databaza dhe platformat online që lidhe me transformimin e IGJK-së në Akademi të Drejtësisë;
- Mirëmbajtja e rregullt e pajisjeve të teknologjisë informative si: kompjuterë, laptop, server dhe pajisje tjera;
- Është mbështetur vazhdimisht stafi në procese të punës me çështjet që kanë të bëjnë me teknologji informative;

Prokurimi:

- Është hartuar plani final i prokurimit janar-dhjetor 2017;
- Janë dërguar kërkesat sipas planit të prokurimit në AQP për zhvillimin e procedurave të prokurimit;
- Sipas ndryshimeve ligjore në fushën e prokurimit, Akademia si institucion me më pak se 50 nëpunës nuk ka të drejtë të zhvilloj procedura të prokurimit kompetencë kjo që është bartur tek AQP. Bazuar në këto ndryshime Akademia nuk ka zhvilluar asnjë procedurë të prokurimit;
- Gjatë kësaj periudhe janë ekzekutuar urdhër blerje për shërbime dhe furnizime të ndryshme;

7.3 Auditimi nga Zyra Kombëtare e Auditimit

Gjatë vitit 2017 nga auditorët e Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) dhe nga auditorët e Ministrisë së Financave është zhvilluar auditimi i pasqyrave vjetore 2016. Raporti Final i Auditimit të pasqyrave financiare të IGJK-së për vitin 2016 është pozitiv, dhe pasqyrat vjetore financiare në të gjitha aspektet prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë (SNISAI 200/1700 Opinion i Pamodifikuar).

Megjithatë ky raport përmban disa rekomandime për Akademinë. Me qëllim të zbatimit të rekomandimeve të dalta nga ky raport është përgatitur dhe zbatuar plani për rekomandimin e dhënë në lidhje me çështjet e gjetura gjatë vitit 2016.

Rekomandimet e ZAP dhe plani i zbatimit të rekomandimeve

Nr.	Rekomandimi ose gjetja	Veprimi i ndërmarrë ose propozuar	Afati i zbatimit	Efekti
1	Pyetësori i vlerësimit – Prioritet i lartë	Pas transformimit të Institutit Gjyqësor të Kosovës në Akademi të Drejtësisë është hapur rruga për hartimin e strategjisë zhvillimore të Akademisë së Drejtësisë. Akademia ka formuar një grup punues të brendshëm dhe në bashkëpunim e mbështetje edhe të Projektit të Binjakëzimit i financuar nga BE dhe me përfshirjen edhe të përfaqësuesve të KGJK, KPK, gjyqtarëve dhe prokurorëve ka zhvilluar disa takime dhe punëtori për të identifikuar objektivat kryesore strategjike në të cilat duhet fokusuar Akademia në vitet e ardhshme. Synimet janë që brenda vitit 2017 Strategjia dhe plani i monitorimit të strategjisë të përfundoj dhe miratohet nga Këshilli Drejtues.	Qershor - Dhjetor 2017	Në proces
2	Mbulimi i pozitave me Ushtrues Detyre – Prioritet i lartë	Akademia e Drejtësisë ka përfunduar procesin e rekrutimit për pozitën e Udhëheqësit të Programit të Vazhdueshëm e cila ka qenë e mbuluar me ushtrues detyre. Ndërkohë ka përfunduar edhe procesi rekrutimit për pozitën e Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë, procedurë kjo e cila ka përfunduar jo brenda periudhës raportuese, por më vonë.	Qershor - Dhjetor 2017	Përfunduar
3	Menaxhim i Pasurisë – Prioritet i lartë	Akademia e Drejtësisë ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e pasurive të blera gjatë vitit 2016 dhe plotësimin e regjistrave të pasurisë, prandaj të gjitha pasuritë nga viti 2016 janë regjistruar. Pasuritë e blera në vitin 2017 janë të regjistruara me përjashtim të disa prej tyre që janë blerë në kohën e hartimit të këtij plani të cilat janë në proces regjistrimi. Pasuria e transferuar që ka qenë në listën e pasurisë, është larguar nga lista. Po ashtu Zyrtari Kryesor Administrativ do të formoj komisionin për inventarizimin e pasurisë jo financiare të Akademisë. Kalkulimi i zhvlerësimit të vlerës së pasurisë nga programi i e-pasurisë nuk është çështje e Akademisë, përkundër kësaj Akademia ka kërkuar dhe do të kërkoj në vazhdimësi që ky program të jetë funksional me qëllim të zhvlerësimit të vlerës së pasurisë.	Qershor - Dhjetor 2017	Përfunduar
4	Mospërputhje e titullit të punës në mes akt emërimeve dhe listës së pagave – Prioritet i mesëm	Kjo çështje është vlerësuar nga Auditori si rekomandim i pazbatuar nga viti i kaluar edhe pse në këtë vit nuk është ngritur si çështje më vete. Megjithatë Akademia e Drejtësisë do të vazhdoj me bashkëpunimin dhe koordinimit mes institucioneve kompetente që administrojnë dhe menaxhojnë sistemin e pagave me qëllim të harmonizimit të emërtimeve të pozitave të Akademisë, që janë pjesë e listës së pagave, me aktin e emërimit duke u mbështetur në klasifikimin e aprovuar të vendeve të punës	Gusht - Tetor 2017	Në proces

Tabela nr.10. Plan i zbatimit të rekomandimeve

8. Sfidat dhe rekomandimet

Ndër sfidat më të mëdha me të cilat është përballur IGJK⁷ gjatë vitit 2017 janë:

- Reforma për edukimin ligjor dhe transformimi i IGJK-së në Akademi të Drejtësisë;
- Sigurimi i buxhetit sipas planifikimeve të përcaktuara në programet trajnuese;
- Hartimi dhe zbatimi i programeve trajnuese në mbështetje të reformave të sistemit gjyqësor e prokurorial;
- Mungesa e ndërtesës së Akademisë;
- Koordinimi i pjesëmarrjes së gjyqtarëve dhe prokurorëve në trajnimin e vazhdueshëm;
- Koordinimi i programeve të ndryshme me donatorë;
- Organizimi i programeve të shkëmbimit;
- Avancimi i metodologjisë trajnuese;
- Zhvillimi i kurseve trajnuese përmes platformës së mësimin në distancë (e-learning);
- Pasurimi i koleksioneve të bibliotekës Akademisë;
- Numri jo i mjaftueshëm i stafit sipas numrit të miratuar profesional dhe largimi i stafit;

Për tejkalimin e sfidave të lartpërmendura, Akademi e drejtësisë jep këto rekomandime:

- Ndarja e tokës dhe buxhetit për ndërtimin e ndërtesës së Akademisë;
- Ndarja e buxhetit sipas kërkesës buxhetore të dorëzuar në Ministrinë e Financave;
- Rritja e numrit të punësuarve, dhe pranimi i statusit të ngjashëm të punësuarve në Akademi me ata të punësuar në sistemin gjyqësor, përkatësisht KGJK dhe KPK në mënyrë që të ndalet trendi i largimit të stafit nga Akademia që kalojnë në sistemin gjyqësor;

Raporti Vjetor i Punës së Akademisë për vitin 2017 është miratuar nga Këshilli Drejtues i Akademisë me datën 23 mars 2018.

⁷ Me datë 24 shkurt 2017, ka hyrë në fuqi Ligji Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, me të cilin themelohet Akademia e Drejtësisë si pasardhëse juridike e Institutit Gjyqësor i Kosovës.

9. Aneksset

Si pjesë e Raportit Vjetor të Punës së IGJK-së për vitin 2017, janë bashkëngjitur edhe anekset si më poshtë:

- Aneksi 1 – Trajnimet e realizuara në PTV
- Aneksi 2 - Trajnimet e realizuara në PTF
- Aneksi 3 – Aktivitetet e realizuara në PHP
- Aneksi 2 – Plani Vjetor i Trajnimit të stafit të Akademisë për periudhën janar–dhjetor 2017

9.1. Aneksi 1 – Trajnimet e realizuara në PTV

Muaji	Nr.	Tema e trajnimit	Ditët	Lëmia	Financuesi
Janar	1	Shqyrtimi fillestar, shqyrtimi i dytë dhe shqyrtimi gjyqësor	1	Penale	Akademia
	2	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut	4	KEDNJ	US DOJ OPDAT
	3	Seanca përgatitore, shqyrtimi kryesor dhe marrja e provës	1	civile	Akademia
	4	Mundësia hetuese e veçante	1	penale	Akademia
	5	Kundërvajtjet dhe sanksionet kundërvajtëse sipas ligjit të ri për kundërvajtje	1	Kundërvajtje	Akademia
	6	Krimi i organizuar	1	Penale	Akademia
Shkurt	7	Mbrojtja dhe promovimi i diversitetit, tolerancës dhe barazisë në kontekst të legjislacionit mbi mos diskriminimin	1	Civile	Akademia
	8	Mbrojtja gjyqësore e të drejtës së pronësisë	1	Civile	Këshilli i Evropës
	9	Risitë e Ligjit për falimentimin	3	ekonomike	USAID/CLE
	10	Program i Specializuar Trajnimi për Prokurimin Publik të Kosovës - Sesioni I	2	Penale	Akademia
	11	Procedurat alternative	1	penale	Akademia
	12	Mbrojtja gjyqësore në rastet e dhunës në familje	1	civile	Akademia
	13	Hetimi i krimeve financiare	1	Penale	Akademia
	14	Mbrojtja e të Drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror	2	civile	Akademia

Mars	15	Kompetencat e Posaçme të Gjykatës Supreme	1	civile	Akademia
	16	Veprat penale kundër integritetit seksual të fëmijëve	1	Drejtësia për fëmijë-Aspekti Penal	Akademia
	17	Bashkëndërgjyqësia dhe ndërhyrësit në procedurë	1	Civile	Akademia
	18	Trafikimi me qenie njerëzore	2	Penale	US-DOJ
	19	Zbatimi i së drejtës evropiane nga ana e gjykatave të Republikës së Kosovës	1	E Drejta ndër-kombëtare	UNDP
	20	Parashkrimi	1	penale	Akademia
	21	Procedura në Këshillin e Pavarur Mbikqyrës dhe mbrojtja gjyqësore në kontestet e punës në shërbimin civil të Republikës së Kosovës	1	administrative	Akademia
	22	Mbrojtja gjyqësore në rastet e shpifjes dhe fyerjes	1	civile	Akademia
	23	Cilësia dhe vlerësimi i provave në procedurë penale	1	Penale	Akademia
	24	Shoqëritë tregtare	1	ekonomike	Akademia
25	Zbatimi i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në sistemin kushtetues të Kosovës	1	KEDNJ	UNDP	
26	Program i Specializuar Trajnimi për Zhvillimin e Kapaciteteve në Luftën Kundër Korrupsionit - Sesioni 1	2	Penale	Akademia	
Prill	27	Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga sendi dhe veprimtaria e rrezikshme	1	Civile	Akademia
	28	Mbrojtja e të dëmtuarve dhe dëshmitarëve	1	Penale	WINPRO II (NI-CO)
	29	Të drejtat e të pandehurit nga ndalimi i parë deri në përfundim të procedurës penale	1	Penale	Akademia
	30	Ndryshimet dhe risitë e Kodit të Etikës Profesionale dhe Rregullorja për sjellje të pahijshme të gjyqtarëve	1	Interdisciplinare	Akademia
	31	Bashkëpunimi juridik ndërkombëtarë në çështjet penale	1	Penale	Akademia
	32	Trajtimi i rasteve të dhunës në familje	1	civile	OSBE
	33	Pjesa e domosdoshme e trashëgimisë dhe cenimi i saj	1	Civile	Akademia
	34	Trajtimi i Rasteve të Dhunës në Familje	1	Civile	OSBE
	35	Shqyrtimi gjyqësor në procedurën ndaj të miturve	1	Civile	UNICEF
	36	Trajtimi i Rasteve të Dhunës në Familje	1	Civile	OSBE
	37	Regjistrat e gjendjes civile, regjistrimi i mëvonshëm dhe ri-regjistrimi sipas Ligjit për regjistrimin civil	1	Administrative	Akademia

Maj	38	Krimet e luftës	2	Penale	EULEX
	39	Renta, llojet dhe caktimi i saj	1	Civile	Akademia
	40	Grupet e përbashkëta të hetimit	3	Penale	Akademia
	41	Masat e Diversitetit	1	Drejtësia për fëmijë –aspekti penal	Akademia
	42	Program i specializuar trajnimi në forcimin e kapaciteteve profesionale në luftimin e krimit kibernetikë-Sesioni I	2	penale	Akademia
	43	Menaxhimi i stresit	2	Interdisciplinare	Akademia
	44	Hetimi dhe Gjykimi i Rasteve ku Përfshihen Luftëtarët e Huaj Terrorist (LHT) në Evropën Juglindore	2	Penale	United Nations Office on Drugs and Crime - UN-ODC
	45	Trajtimi i Rasteve të Dhunës në Familje	1	Civile	OSBE
	46	Trajtimi i Rasteve të Dhunës në Familje	1	Civile	OSBE
	47	Administrimi i provave - parimet udhëheqëse	1	Kundërvajtje	Akademia
	48	Konfiskimi ndërkuftar i pasurive	3	Penale	GIZ
	49	Aktakuza	1	Penale	Akademia
	50	Referimi paragjykimor (incidental) dhe procedurat sipas nenit 113 par. 8 i Kushtetutës së Kosovës	1	E drejta kushtetuese	UNDP
	Qershor	51	Kontrata për ndërtim dhe përgjegjësia e kontraktuesve	1	Civile
52		Veprat penale sipas Kodit Doganor	1	Penale	Akademia
53		Barazia gjinore në procedurë gjyqësore	1	Civile	Akademia
54		Pranueshmëri e kërkesës-ankesën në Dhomën e Posaqme	1	civile	Akademia
55		Aktgjykimi dhe llojet e tij sipas LPK-së	1	Civile	Akademia
55		Program i specializuar trajnimi në forcimin e kapaciteteve profesionale në luftimin e shpëlarjes së parave-Sesioni	2	Penale	Akademia
56		Ngrirja e përkohshme asetëve, sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë	1	Penale	Akademia
57		Procedura për privatizimin e subjekteve nga AKP	1	Civile	Akademia
58		Arsyetimi i vendimeve gjyqësore në fushën civile	1	Interdisciplinare	Akademia
59		Hetimi financiar	2	Penale	GIZ
60		Gjykimi i të miturve dhe madhorëve në një proces gjyqësor	1	Drejtësia për fëmijë-aspekti penal	Akademia

Korrik	61	Palët dhe përfaqësimi i tyre në procedurë	1	Civile	Akademia
	62	Trafikimi me njerëz dhe kontrabandimi me migrantë	2	Penale	Akademia
	63	Krimi i organizuar, trafikimi i drogës dhe rastet trans nacionale, ngritja e aktakuzave	2	Penale	Akademia
Shtator	64	Zbatimi i masave të fshehta hetimore	1	Penale	Akademia
	65	Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve dhe pjesëtimi i saj	1	Civile	Akademia
	66	Nenit 6 i KEDNJ si dhe zbatimi i tij	1	KEDNJ	UNDP
	67	Menaxhimi i rasteve	1	Interdisciplinare	Akademia
	68	Veprat penale kundër detyrës zyrtare	1	Penale	UNDP
	69	Program i Specializuar Trajnimi për Prokurimin Publik të Kosovës - Sesioni II	2	Penale	Akademia
	70	Krimet e Urrejtjes	1	Penale	OSBE
	71	Kompensimi i dëmit jomaterial	1	Civile	Akademia
	72	Kontratat në ekonomi	1	Ekonomike	Akademia
	73	Dënimet që u shqiptohen të miturve	1	Drejtësia për fëmijë-aspekti penal	UNICEF
	74	Ekzekutimi i masave dhe dënimeve ndaj të miturve	1	Drejtësia për fëmijë-aspekti penal	UNICEF
	75	Lëvizja dhe qëndrimi i të huajve si dhe procedurat ligjore ndaj tyre në Republikën e Kosovës	1	Administrative	UNHCR
	76	Program i specializuar trajnimi në forcimin e kapaciteteve profesionale në luftimin e shpëlarjes së parave Sesioni II	2	Penale	Akademia
	77	Kundërvajtjet nga lëmi i rendit dhe qetësisë publike, (neni 4, 5 dhe 16 të Ligjit për Rendin dhe Qetësinë Publike	1	Kundërvajtje	Akademia

Tetor	78	Matja e dënimit	1	Penale	Akademia
	79	Shpronësimi dhe kompensimi i pronës së shpronësuar	1	Civile	Akademia
	80	Hetimi financiar	3	Penale	Akademia
	81	Program i Specializuar Trajnimi për Zhvillimin e Kapaciteteve në Luftën Kundër Korrupsionit Sesioni II	2	Penale	Akademia
	82	Bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale dhe bashkimi kriminal	1	Penale	Akademia
	83	Neni 10 i Konventës Evropiane	2	KEDNJ	Akademia
	84	Shqyrtimi paraprak i padisë dhe përgatitja e shqyrtimit kryesor	1	Civile	Akademia
		Barazia gjinore në procedurë gjyqësore	1	Civile	GIZ
	85	Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në kontestet martesore – familjare	2	Drejtësia për fëmijë-aspekti civil	Akademia
	86	Trajtimi i rasteve të dhunës ndaj mediave	1	civile	OSBE
	87	Aktvendimi dhe arsyetimi ligjor (kundërvajtje)	1	Kundërvajtje	Akademia
	88	Veprat penale kundër jetës dhe trupit	1	Penale	Akademia
	89	Zgjidhja Alternative e Kontesteve	1	Ekonomike	Akademia
	90	Markat tregtare	1	Ekonomike	Akademia
	91	Procedura gjyqësore në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme	1	Civile	Akademia
	92	Shqyrtimi i kërkesave kreditore dhe pronësore në procesin e likuidimit	1	Civile	Akademia
	93	Zbatimi Gjyqësor i Konventës së Arhusit (e drejta në informacion, pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje dhe qasja në drejtësi mjedisore)	1	E Drejta Ndërkombëtare	Akademia
	94	Udhëzuesi i Këshillit të Evropës për Drejtësinë Miqësore për Fëmijë	2	Drejtësia për fëmijë	Akademia
	96	Program i specializuar trajnimi në forcimin e kapaciteteve profesionale në luftimin e krimit kibernetikë Sesioni II	2	Penale	Akademia
	97	Dëshmitaret në procedurën penale	1	Penale	Akademia

Nëntor	98	Lejimi i përmbartimit dhe vendosja sipas prapësimit	1	Civile	Akademia
	99	Program i specializuar trajnimi në forcimin e kapaciteteve profesionale në luftimin e shpëlarjes së parave	2	Programet e specializuara	Akademia
	100	Procedura e vendosjes sipas mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme	1	Civile	Akademia
	101	Masat edukative ndaj të miturve	1	Drejtësia për fëmijë-Aspekti Penal	UNICEF
	102	Masat për sigurimin e pranisë së të miturit në procedurë	1	Drejtësia për fëmijë	Akademia
	103	Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurën penale	1	Penale	Akademia
	104	Të drejtat e pronësisë intelektuale – të drejtat e autorit	1	Civile	Akademia
	105	Korrupsionin, teknikat e hetimit	2	Penale	Twinning IRZ
	106	Tryezë e rrumbullakët “Trajtimi i dilemave aktuale në Ligjin për Konfliktet Administrative”	2	Administrative	Akademia
	107	Personat juridik dhe procedura kundërvajtëse	1	Kundërvajtje	Akademia
	108	Fillimi i hetimit dhe procedura penale	1	Penale	Akademia
	109	Hartimi dhe arsyetimi i vendimeve gjyqësore në fushën penale	1	Penale	Akademia
	110	Tregjet e zeza në internet dhe Krimi i organizuar	2	Penale	EULEX
	111	Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në rastet e ndryshimit të statusit të tyre	2	Drejtësia për fëmijë -Aspekti civil	UNICEF
	112	Veprat penale kundër ekonomisë	1	Penale	Akademia
113	Sigurimi i kërkesëpadisë	1	Civile	Akademia	

Dhjetor	114	Program i Specializuar Trajnimi për Zhvillimin e Kapaciteteve në Luftën Kundër Korrupsionit	2	Programet e specializuara	Akademia
	115	Procedura gjyqësore për zgjidhjen e martesës	1	Civile	Akademia
	116	Kodi Procedurës Penale	4	Penale	Ambasada Amerikane
	117	Kodi Penal	1	Penale	Akademia
	118	Procedura gjyqësore për zgjidhjen e martesës	1	Penale	Akademia
	119	Urdhër kontrolli	1	Penale	Akademia
	120	Dëshmitë e mbledhura nga facebook dhe platformat tjera te mediave sociale	2	Penale	EULEX
	121	Etika Profesionale dhe Deontologjia	1	Etikë	GIZ
	122	Procedura penale ku përfshihen kryerësit me çrregullime mendore	1	Penale	Akademia
	123	Sfidat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve	1	Civile	GIZ
	124	Anulimi i kontratave	1	Civile	Akademia
	125	Pronësia dhe mbrojtja e saj	1	Civile	GIZ
	126	Procedurat (kontestimore, jokontestimore dhe përmbarimore)	1	Civile	GIZ
	127	Program i specializuar trajnimi në forcimin e kapaciteteve profesionale në luftimin e krimit kibernetik - sesioni III	2	Penale	Akademia
	128	Marrëdhëniet juridiko-familjare, trashëgimore, dhuna në familje	1	Civile	Akademia
	129	Menaxhimi i gjykatës/prokurorisë dhe i rasteve	1		GIZ
	130	Mjetet e rregullta juridike dhe bazat e ankesës	1	Penale	Akademia
	131	Përgjegjësia penale e personave juridik	1	Penale	Akademia

9.2 Aneksi 2 – Aktivitetet e realizuara në PTF

Muaji	Nr.	Aktiviteti	Numri i sesioneve dhe ditë	Financimi
Janar	1.	Kodi Penal – pjesa e përgjithshme	7	Akademia
	2.	Kodi Penal – pjesa e veçantë	7	Akademia
	3.	Trajnim me Qendrën për Punë Sociale	1	Akademia + QPS
	4.	Trajnim praktikë në prokurori	11	Akademia
Shkurt	5.	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut	8	Akademia
	6.	Fillimi i hetimit formal dhe procedura penale	8	Akademia
	7.	Trajnim praktik në Gjykatën Kushtetuese	1	Akademia + GJK
	8.	Trajnim praktik në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës	1	Akademia + KPMSHCK
	9.	Trajnim praktik në Agjencionin kundër Korrupsion	1	Akademia + Agjencionin kundër Korrupsion
	10.	Trajnim praktik në prokurori	7	Akademia
Mars	11.	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut	2	Akademia
	12.	Aktakuza – Procedura e shqyrtimit	6	Akademia
	13.	Kallëzimi Penal	6	Akademia
	14.	Trajnim praktik në Agjencinë Kadastrale të Kosovës	1	Akademia + AGJK
	15.	Trajnim praktik në Doganën e Kosovës	1	Akademia + DK
	16.	Trajnim praktik në Komisioni e Ndërmjetësimit	1	Akademia+ KM
	17.	Zhvillimi i komponentës hulumtuese dhe mësimi në distancë	1	Akademia
	18.	Trajnimi praktik në prokurori	11	Akademia
Prill	19.	Aktakuza – Procedura e shqyrtimit	2	Akademia
	20.	Masat e fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit	6	Akademia
	21.	Krimet e rënda	1	Akademia
	22.	Procesverbalet	3	Akademia
	22.	Trajnim praktik në Zyrën Kombëtare të Auditimit	1	Akademia + ZKA
	23.	Trajnim praktik në Administratën Tatimore të Kosovës	1	Akademia + ATK
	24.	Trajnim praktik në Institutin e Mjekësisë Ligjore	1	Akademia + IML
	25.	Trajnimi praktik në prokurori	9	Akademia

Maj	26.	Vendi i ngjarjes dhe forenzika	3	Akademia
	27.	Kontrolli dhe konfiskimi	5	Akademia
	28.	Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedure	5	Akademia
	29.	Provat në procedurën penale	2	Akademia
	30.	Zhvillimi i shkathtësive gjyqësore	1	Akademia
	31.	Trajnimi praktik në Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale	1	Akademia + AG-JSHMDHP
	32.	Trajnim praktik në Odën e Avokatëve të Kosovës	1	Akademia + OAK
	33.	Trajnim praktik në Institutin e Avokatit të Popullit	1	Akademia + IAP
	34.	Trajnimi praktik në prokurori	1	Akademia
Qershor	35.	Provat në procedurën penale	4	Akademia
	36.	I pandehuri në procedurën penale	5	Akademia
	37.	Dëshmitarët dhe të dëmtuarit në procedurën penale	2	Akademia
	38.	E drejta e Bashkimi Evropian	2	Akademia
	39.	Ngritja e shkathtësive sociale të prokurorëve	1	Akademia
	40.	Zhvillimi i shkathtësive gjyqësore	5	Akademia
	41.	Simulim gjykimi	1	Akademia
	42.	Trajnim praktik në Shërbimin Korrektues	1	Akademia + SHK
	43.	Trajnim praktik në Policinë e Kosovës	1	Akademia + PK
	44.	Trajnimi praktik në prokurori	6	Akademia
Korrik	45.	Ngritja e shkathtësive sociale të prokurorëve	2	Akademia
	46.	E drejta e Bashkimi Evropian	2	Akademia
	47.	Trajnimi praktikë në prokurori	3	Akademi
Gusht	48.	Parashkrimi	3	Akademia
	49.	E drejta e Bashkimi Evropian	2	Akademia
	50.	Ushtrimi i mjeteve juridike nga ana e prokurorit	3	Akademia
	51.	Dëshmitarët dhe të dëmtuarit në procedurën penale	3	Akademia
	52.	Procedurat e veçanta sipas KPPK-së	2	Akademia
	53.	Trajnimi praktik në prokurori	12	Akademia
Shtator	54.	Marrja dhe komunikimi i vendimeve dhe dërgimi i shkresave	1	Akademia
	55.	Shqyrtimi fillestar, i dytë dhe shqyrtimi gjyqësor	4	Akademia
	56.	Etikë profesionale	7	Akademia
	57.	Hetimi i krimeve ndërkufitare	2	Akademia
	58.	Trajnim praktikë Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik	1	Akademia + KRPP
	59.	Trajnim praktik në prokurori	12	Akademia

Tetor	60.	Hetimi i krimeve ndërkufitare	1	Akademia
	61.	Etikë profesionale	3	Akademia
	62.	Rregullat e komunikimit	2	Akademia
	63.	Menaxhimi i stresit	2	Akademia
	64.	Administrimi i procedurës penale	2	Akademia
	65.	Ekspertiza dhe analizat	4	Akademia
	66.	Negocimi i marrëveshjes per pranimin e fajësisë	3	Akademia
	67.	Veprat penale të korrupsionit dhe kundër detyrës zyrtare	2	Akademia
	68.	Shmangia nga ndjekja penale	1	Akademi
	69.	Kodi Penal – pjesa e përgjithshme	8	Akademia
	70.	Kodi i Procedurës Penale – pjesa e veçantë	8	Akademia
	71.	Trajnim praktik në prokurori	12	Akademia
	72.	Trajnim praktik në gjykata	14	Akademia
	Nëntor	73.	Shmangia nga ndjekja penale	1
74.		Ndërmjetësimi	2	Akademia
75.		Vija ndarëse në mes veprave penale dhe kundërvajtjeve	1	Akademia
76.		Roli i prokurorit në procedurën penale	6	Akademia
77.		Arsyetimi i vendimeve (ankesave/akteve akuzuese)	6	Akademia
78.		Kodi Penal – pjesa e përgjithshme	2	Akademia
79.		Kodi i Procedurës Penale – pjesa e veçantë	2	Akademia
80.		Veprat penale të korrupsionit dhe kundër detyrës zyrtare	2	Akademia
81.		Negocimi i marrëveshjes per pranimin e fajësisë	3	Akademia
82.		I pandehuri në procedurën penale	5	Akademia
83.		Dëshmitarët dhe të dëmtuarit në procedurën penale	4	Akademia
84.		Krimet e rënda	1	Akademia
85.		E Drejta Kushtetuese	1	Akademia
86.		Trajnim praktik në Policin e Kosovës	1	Akademia + PK
87.		Trajnim praktik në Doganën e Kosovës	1	Akademia + DK
88.		Trajnim praktik në prokurori	14	Akademia
89.		Trajnim praktik në gjykata	10	Akademia

Dhjetor	90.	Kodi i drejtës për të mitur	1	Akademia
	91.	Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështje penale	1	Akademia
	92.	Organizimi i sistemit gjyqësor dhe prokurorial	2	Akademia
	93.	Menaxhimi i rasteve	2	Akademia
	94.	Shpenzimet e procedurës dhe kërkesa pasurore juridike	1	Akademia
	95.	Ndërmjetësimi	1	Akademia
	96.	Arsyetimi i vendimeve	1	Akademia
	97.	Zhvillimi i shkathësive gjyqësore	4	Akademia
	98.	Organizimi i testit përfundimtar për prokurorët e sapo emëruar	3	Akademia
	99.	Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedure	5	Akademia
	100.	Masat e fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit	4	Akademia
	101.	Ekspertiza dhe analizat	4	Akademia
	102.	Kontrolli dhe konfiskimi	4	Akademia
	103.	Trajnim praktik në Institucionin e Avokatit të Popullit	1	Akademia + IAP
	104.	Trajnim praktik në Gjykatën Kushtetuese	1	Akademia + GJK
	105.	Trajnim praktik në prokurori	8	Akademia
106.	Trajnim praktik në gjykata	9	Akademia	

9.3 Aneksi 3 – Aktivitetet e realizuara në PHP

Periudha Kohore	Nr	Aktivitetet	Përfituesit	Financimi
Mars	1	Punësoria për zhvillimin e botimeve ligjore	Kategoritë përfituese të AD-së	GIZ
Maj-Tetor	2	Tryeza me gjyqtarët e gjykatës së Apelit	Kategoritë përfituese të AD-së	UNDP
	1	Ceremonia e promovimit të Përmbledhjes së Formave dhe Shkresave në Procedurën Penale. Marrëveshjeve dhe Instrumenteve ligjore ndërkombëtare si dhe Revisitës nr. 2 të Opinio Juris	Kategoritë përfituese të Akademisë	GIZ
Mars-Dhjetor		Hulumtime dhe analiza për vlerësimin e nevojave të gjyqtarëve dhe prokurorëve për trajnime si dhe për zhvillimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve trajnuese për vitin 2018	Kategoritë përfituese të Akademisë	Akademia e Drejtësisë
Gusht	1	Ceremonia e promovimit të Doracakut për Shkrimin dhe Arsyetimin Ligjor	Kategoritë përfituese të Akademisë	USAID
Dhjetor	1	Takimi i Këshillit të Redaksisë	Kategoritë përfituese të Akademisë	Akademia e Drejtësisë
Janar-Dhjetor	2	Përditësimi i koleksioneve të bibliotekës	Kategoritë përfituese të Akademisë	Akademia e Drejtësisë

Peridha kohore	Publikimet	Përfituesit	Financimi
Qershor	Format e Shkresave në Procedurën penale		GIZ
Qershor	Ribotimi i Marrëveshjeve dhe instrumenteve ligjore ndërkombëtare	AD	GIZ
Gusht	Doracaku për shkrimin dhe arsyetimin ligjor		USAID
Jana-Dhjetor	Buletini	Kategoritë përfituese të AD-së	Akademia
Tetor	Programi i PTF-së për gjyqtarët e sapoemëruar	Prokurorët e sapoemëruar	Akademia
Nëntor	Kodi Penal	Prokurorët e sapoemëruar	Akademia
Dhjetor	Rendi Juridik Kombëtar dhe Ndërkombëtar	Prokurorët e sapoemëruar	Akademia
Dhjetor	Legjislacioni dhe shkathtësitë Plotësuese	Prokurorët e sapoemëruar	Akademia
Dhjetor	Shkathtësitë personale dhe ndërpersonale	Prokurorët e sapoemëruar	Akademia
Dhjetor	Kodi i Procedurës Penale	Prokurorët e sapoemëruar	Akademia
Dhjetor	E Drejta civile administrative dhe ekonomike	Kategoritë përfituese të AD-së	Akademia

9.4 Aneksi 4 – Aktivitetet e realizuara për menaxhmentin e administratës dhe stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive

Muaji	Nr.	Tema e trajnimit	Ditët	Financuesi
Mars	1	Menaxhimi i gjykatave dhe prokurorive - Sfidat praktike dhe zhvillimi i kurrikulës	1	IPA 2014 Projekti i Binjakëzimit“ Vazhdim i Mbështetjes së Reformës së Arsimit Ligjor”
Mars	2	Zhvillimi i kapaciteteve të stafit të sistemit prokurorial të Kosovës, shkrimi dhe arsyetimi ligjor	2	Akademia
Maj	3	Shkrimi dhe arsyetimi ligjor	1	Akademia
	4	Avancimi i performancës në administrimin e sistemit prokurorial	2	Akademia
Qershor	5	Kursi hyrës – moduli 1	5	Akademia
Korrik	6	Kursi hyrës – moduli 2	3	Akademia
Shator	7	Menaxhimi i administratës së gjykatave dhe prokurorive	1	GIZ
	8	Tryezë pune për hartimin e programit trajnues për stafin administrativ	2	GIZ
Tetor	9	Menaxhimi i rrjedhës së rasteve	1	GIZ
Nëntor	10	Menaxhimi i kohës dhe stresit	1	GIZ
	11	Etika dhe sjellja profesionale	1	GIZ
Nëntor	12	Hartim ligjor për zyrtarët ligjor dhe bashkëpunëtorët profesional.	2	EULEX

9.5 Aneksi 5 – Trajnimet e realizuara për trajnues

Muaji	Nr.	Tema e trajnimit	Ditët	Financuesi
Shkurt	1	Didaktika gjyqësore;	1	Projekti i Binjakzimit
Mars	2	Neni 10 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.	4	Projekti i Binjakzimit
Prill	3	Trajnimi i trajnuesve për lirinë e shprehjes	2	JUFREX
Nëntor	4	Avancimi i metodologjisë trajnuese	2	Projekti i Binjakzimit

9.6 Aneksi 6 Trajnimet e realizuara për gjyqtarët porotë

Muaji	Nr.	Tema e trajnimit	Ditët	Financuesi
Nëntor	1	Roli dhe detyrat e gjyqtarit porotë në procedurë gjyqësore	1	Akademia

9.7 Aneksi 7 – Kurset trajnuese përmes platformës së mësimin në distancë

Muaji	Nr.	Tema e trajnimit	Muaj	Financuesi
Gusht	1	Drejtësia për fëmijë (aspekti civil dhe penal) për gjyqtarë dhe prokurorë;	2	Akademia
Tetor	2	Ndërmjetësimi aspekti civil dhe penal	2	Akademia
Mars	3	Anglishtja ligjore për prokurorët e sapoemëruar	2	Akademia
Tetor	4	Teknologjia Informative për prokurorët e sapoemëruar	2	Akademia
Prill	5	Teknologjia Informative për personelin administrativ gjyqësor dhe prokurorial	2	Akademia

9.8 Aneksi 7 – Plani Vjetor i Trajnimit të Stafit të IGJK-së për periudhën janar – dhjetor 2017

Nevojat për trajnim	Numri i nëpunësëve civil që duhen trajnuar	Për-shtatja * me prioritetet e trajnimit	Titulli i programit/ kursit të trajnimit dhe kuhëzgjatja e tij (nëse dihet)	Ofruesi i trajnimit (nëse dihet)	Afati i parapëlqyer
Komunikim qeveritar me publikun	1	2	Menaxhim i përgjithshëm		Shkurt - Dhjetor
Hartim, zbatimi, koordinimi dhe monitorimi i politikave	1	2	Menaxhim i përgjithshëm		Shkurt - Dhjetor
Planifikimi dhe vendmarrja	1	2	Menaxhim i përgjithshëm		Shkurt - Dhjetor
Sjellje Organizative	1	2	Menaxhim i përgjithshëm		Shkurt - Dhjetor
Etika, integriteti dhe transparenca ne administraten publike	1	2	Administratë dhe legjislacion		Shkurt - Dhjetor
Kushtetuta dhe hierarkia e akteve normative	1	2	Administratë dhe legjislacion		Shkurt - Dhjetor
Vlerësimin e ndikimit rregullativ dhe hartimi i koncept dokumenteve	1	2	Administratë dhe legjislacion		Shkurt - Dhjetor
Oganizimi dhe funksionim i Adm. Pub.	1	2	Administratë dhe legjislacion		Shkurt - Dhjetor
E drejta për mbrojtjen e të dhënave personale dhe qasjes në dokumente publike	1	2	Administratë dhe legjislacion		Shkurt - Dhjetor
Procedura Administrative	1	2	Administratë dhe legjislacion		Shkurt - Dhjetor
Hartimi i legjislacionit	2	2	Administratë dhe legjislacion		Shkurt - Dhjetor
Komunikimi dhe hartimi i shkresaave ne Administratën Publike	2	2	Administratë dhe legjislacion		Shkurt - Dhjetor
Menaxhimi me dokumentet arkivore	1	2	Administratë dhe legjislacion		Shkurt - Dhjetor
Planifikimi rekrutimi dhe përzgjedhja	3	2	Burime njerëzore		Shkurt - Dhjetor
Vendosja e objektivave dhe vlerësimi i rezultateve ne pune	2	2	Burime njerëzore		Shkurt - Dhjetor
Kodi etik, të drejtat dhe përgjegjësitë në SH.C.	3	2	Burime njerëzore		Shkurt - Dhjetor

Transferimi dhe promovimi në SH.C.	1	2	Burime njerëzore		Shkurt - Dhjetor
Ankimimi dhe çështjet e disiplinës	3	2	Burime njerëzore		Shkurt - Dhjetor
Vlerësimi i nevojave për trajnim dhe ndërtimi i planeve të trajnimit	1	2	Burime njerëzore		Shkurt - Dhjetor
Prokurimi publik (10 module)	1	2	Burime njerëzore		Shkurt - Dhjetor
Menaxhimi i financave publike	1	2	Buxhet dhe financa		Shkurt - Dhjetor
Partneriteti publiko privat	1	2	Buxhet dhe financa		Shkurt - Dhjetor
Menaxhimi financiar, kontrolli dhe auditimi i brendshëm	1	2	Buxhet dhe financa		Shkurt - Dhjetor
Windows server	2	2	Teknologji Informative		Shkurt - Dhjetor
SQL server	2	2	Teknologji Informative		Shkurt - Dhjetor
Debian OS	2	2	Teknologji Informative		Shkurt - Dhjetor
eLearning	2	2	Teknologji Informative		Shkurt - Dhjetor
SharePoint Server	2	2	Teknologji Informative		Shkurt - Dhjetor
Përafrimi i legjisllacionit vendor me legj. e BE-së	1	2	Trajnime për BE		Shkurt - Dhjetor
Zbatimi i politikave të MSA-së, monitorimi dhe raporti i zbatimit	1	2	Trajnime për BE		Shkurt - Dhjetor
Asistenca e jashtme, monitorimi dhe vlerësimi i projekteve	1	2	Trajnime për BE		Shkurt - Dhjetor
Trajnimi fillestar për BE	1	2	Trajnime për BE		Shkurt - Dhjetor
Aspektet juridike dhe legjisllative të MSA	1	2	Trajnime për BE		Shkurt - Dhjetor
Fondet Strukturore të BE	1	2	Trajnime për BE		Shkurt - Dhjetor

* 1) Nëse lidhet me prioritetet e trajnimit nga këndvështrimi i qeverisë, 2) nëse lidhet me prioritetet e trajnimit nga këndvështrimi i institucionit, 3) nëse lidhet me nevojat individuale.

